


Liahona




Pleqtë Gong dhe Soares:
"Dëshmitarë të Emrit
të Krishtit në të Gjithë
Botën", f. 12, 18

8 Gjëra që Duhet të Kuptoni për
Peshkopin Tuaj, f. 24

Jozef Smithi: "Të Frymëzuar për ta
Çuar Përpara Kauzën e Sionit", f. 28

Historia e Ditëve të Mëvonshme për
Besëlidhjet Tona me Perëndinë, f. 34



“DIJENIA SE
**PRINDËRIT TANË QIELLORË
BËNË PLANE PËR LUMTURINË
DHE EKZALTIMIN**

TONË PËRFUNDIMTAR NA SIGURON
PERSPEKTIVË, NA JEP IDENTITET SI
FËMIJË TË DASHUR TË PRINDËRVE
HYJNORË DHE NA E SHTON SIGURINË
QË KEMI TE ZOTI, MADJE EDHE NË
KOHË FATKEQËSISH.”

PLAKUN KUENTIN L. KUK


Nga "Sa i Mëshirshëm Ka Qenë Zoti", faqe 34.



ARTIKUJT KRYESORË

6 Parimet e Dhënies së Shërbesës: Të Marrim Ndhimë për t'i Ndihmuar Të Tjerët

*Nga ta dimë se kur dhe si t'i
përfshijmë të tjerët në dhënien e
shërbesës nga ana jonë?*



NË KOPERTINË

Atë që Kam po Ta Jap, nga Walter Rane.

12 Plaku Gerit W. Gong: Duajeni Zotin dhe Mirëbesojini Atij

Nga Plaku D. Tod Kristoferson

18 Plaku Ulises Soares: Një Burrë pa Mashtrim

Nga Plaku Nil L. Andersen

24 Ato që Çdo Peshkop Dëshiron që t'i Dinë Anëtarët e Lagjes së Tij

Nga Majkëll Majërs

*Ndonjëherë ne harrojmë se pesh-
kopët janë njerëz si ne, duke bërë
maksimumin e tyre për të shërby-
er mirë në thirrjen e tyre.*

28 Shenjtorët: Historia e Kishës – Kapitulli 8: Ngritja e Kishës së Krishtit

*Ndërkohë që Libri i Mormonit po
shtypet, disa njerëz i drejtohen
Kishës së vërtetë. Pas botimit,
Jozefi organizon Kishën.*

34 Sa i Mëshirshëm Ka Qenë Zoti

Nga Plaku Kuentin L. Kuk

*Anëtarët do të frymëzohen kur të
lexojnë për shenjtorët besnikë të
ditëve të mëvonshme në historinë
e re me shumë vëllime të Kishës.*

LEXIME TË SHPEJTA

4 Portrete Besimi: Mikael Isak – Bajgosh, Poloni

10 Çfarë Besojmë Ne: Ku Shkojnë Paratë e të Dhjetave

40 Zëra të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme

80 Kur Prapë të Takohemi: Përkrahja Jonë Mbështetëse

Nga Presidenti Xhejms E. Faust



48

44 Shtysa Jonë për ta Jetuar Ungjillin

Nga Minda Selu

Arsyeja jonë për të jetuar drejtësisht varet me të vërtetë nga një gjë.

48 Hapi i Parë Drejt Pendimit

Nga Aurilas Peterson

Vajtja te peshkopi im kërkoi shumë guxim nga ana ime, por ajo bëri gjithë ndryshimin.



Shih nëse mund ta gesh Liahonën e fshehur në këtë botim. E dhënë: Si e shndrit dritën tënde?



50

50 Të Mësojmë Sipas Mënyrës së Zotit

Nga Plaku Dejvid A. Bednar

Kur e lejojmë Shpirtin që të jetë mësuesi, aftësia jonë për të mësuar do të rritet.

54 5 Mënyra për të Mësuar nga Konferenca e Përgjithshme

Zbulojini këto ide për të marrë më shumë njohuri nga mesazhet e konferencës.

56 Të Mësuar nga Fryma e Shenjtë

Këta adoleshentë tregojnë atë që mësuan nga konferenca e përgjithshme.

58 Afishe: Nëse Mbani Vesh

59 Fakte rreth Konferencës së Përgjithshme

60 Pyetje e Përgjigje

Si mund ta ftoj Shpirtin në shtëpinë tëme kur njerëzit janë duke u grindur apo debatuar?

62 Shtigje Që Ju Përgatitin për të Ardhmen Tuaj

Këto përvoja nga katër të rinj në moshë madhore mund të tregojnë se si të gjeni sukses në të ardhmen.



72

66 Përcilleni Dashurinë e Perëndisë

Nga Elli B.

Kur u shpërngulëm, unë vura re se nuk kishte shumë njerëz në degën tonë. Ndaj vendosa të bëja diçka për këtë.

67 Lutje në Kanion

Nga Karsen K.

Kisha frikë se nuk do ta gjenim ndonjëherë rrugën për t'u kthyer në ma kinë.

68 Le të Shndritë Drita Juaj: Të Shndritësh Fort në Republikën Çeke

70 Apostujt Dëshmojnë për Krishtin

Nga Plaku Xhefri R. Holland

71 Faqja Jonë

72 Besim, Shpresë dhe Dashuri – Pjesa 3: Shpresë në Holandë

Nga Megan Armkneht

74 Klubi i Leximit të Librit të Mormonit

75 Heronjtë e Dhiatës së Vjetër: Esteri ishte Guximtare

76 Histori nga Shkrimet e Shenjta: Mbretëresha Ester

Nga Kim Ueb Ridi

79 Faqe për Ngjyrosje: Unë Mund t'i Ndhim të Tjerët të Ndiejnë se Njerëz të Tjerë i Duan

TETOR 2018 VËLLIMI 20 NR. 5
LIAHONA 14754 101

Revista ndërkombëtare zyrtare e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme

Presidenca e Parë: Rasëll M. Nelson, Dallin H. Ouks, Henri B. Ajring

Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve: M. Rasëll Ballard, Xhefri R. Holland, Diter F. Uhtdorf, Dejvid A. Bednar, Kuentin L. Kuk, D. Tod Kristoferson, Nil L. Andersen, Ronald A. Rasband, Geri E. Stivenson, Dejll G. Renland, Gerit W. Gong, Ulises Soares

Kryeredaktor: Hugo E. Martinez

Ndihmësredaktorë: Randall K. Bennett, Becky Craven

Këshilltarë: Brian K. Ashton, LeGrand R. Curtis Jr., Edward Dube, Sharon Eubank, Cristina B. Franco, Donald L. Hallstrom, Douglas D. Holmes

Drejtor Përgjegjës: Richard I. Heaton

Drejtor i Revistave të Kishës: Allan R. Loyborg

Përgjegjës i Punëve: Garff Cannon

Redaktor Përgjegjës: Adam C. Olson

Ndihmësredaktor Përgjegjës: Ryan Carr

Ndihmëse e Botimit: Francisca Olson

Grupi i Shkrimit dhe i Redaktimit: Maryssa Dennis, David Dickson, David A. Edwards, Matthew D. Flitton, Lori Fuller, Garrett H. Garff, LaRene Porter Gaunt, Jon Ryan Jensen, Charlotte Larcabal, Michael R. Morris, Eric B. Murdock, Sally Johnson Odekirk, Joshua J. Perkey, Jan Pinborough, Richard M. Romney, Mindy Selu, Chakell Wardleigh, Marissa Widdison

Drejtor Përgjegjës i Artit: J. Scott Knudsen

Drejtor Arti: Tadd R. Peterson

Grupi i Faqesjes: Jeanette Andrews, Fay P. Andrus, Mandie Bentley, C. Kimball Bott, Thomas Child, David Green, Colleen Hincley, Eric P. Johnsen, Susan Lofgren, Scott M. Mooy, Emily Chieko Remington, Mark W. Robison, Brad Teare, K. Nicole Walkenhorst

Bashkërenduese për Pronësinë Intelektuale:

Collette Nebeker Aune

Përgjegjëse e Prodhimit: Jane Ann Peters

Grupi i Prodhimit: Ira Glen Adair, Julie Burdett, Thomas G. Cronin, Bryan W. Gygi, Ginny J. Nilson, Derek Richardson

Përgatitja për Shtyp: Joshua Dennis, Ammon Harris

Drejtor Shtypi: Steven T. Lewis

Drejtor i Shpërndarjes: Troy R. Barker

Mbikëqyrës i Përkthimit Shqip: Sparti Kashari

Për pajtimet dhe për çmimet jashtë Shteteve të Bashkuara dhe Kanadasë, shkoni në store.lds.org ose kontaktoni me qendrën tuaj vendore të Kishës për shpërndarjen ose me udhëheqësin e lagjes apo degës

Paraqitimi dorëshkrimet dhe pyetjet në internet në liahona.lds.org; nëpërmjet postës elektronike liahona@ldschurch.org; ose nëpërmjet postës në *Liahona*, Rm. 2420, 50 E. North Temple St., Salt Lake City, UT 84150-0024, USA.

Liahona (një term nga Libri i Mormonit, që do të thotë "busull" apo "drejtues") botohet në anglisht, armenisht, bislamisht, bullgarisht, çekisht, danisht, estonisht, fixhisht, finlandisht, frëngjisht, greqisht, gjermanisht, holandisht, hungarisht, indonezisht, islandisht, italisht, japonisht, kambozishisht, kinezisht, kiribatishisht, koreanisht, kroatisht, letonisht, lituanisht, malagasishisht, marshallisht, mongolisht, norvegjisht, polonisht, portugalisht, rumanisht, rusisht, samoaisht, sebuanisht, sllovenisht, spanjisht, suahilisht, suedisht, shqip, tagalogisht, tahitisht, taisht, tongaisht, ukrainisht, urduisht dhe vietnamsisht. (Periodiciteti ndryshon sipas gjuhës.)

© 2018 nga Intellectual Reserve, Inc. I rezervohen të gjitha të drejtat. Shtypur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Informacion për të drejtën e autorit: Përveç nëse sugjerohet ndryshe, individët mund të kopjojnë material nga *Liahona* për përdorimin e tyre vetjak, jo për tregti (përfshirë për thirrjet në Kishë). Kjo e drejtë mund të anulohet në çdo kohë. Lënda figurative nuk lejohet të kopjohet nëse ajo shoqërohet me kufizime të shënimi i meritave për punën artistike. Çështjet e së drejtës së autorit duhet të drejtohen tek Intellectual Property Office, 50 E. North Temple St., FL 13, Salt Lake City, UT 84150, USA; adresa elektronike: cor-intellectualproperty@ldschurch.org.

For Readers in the United States and Canada:

October 2018 Vol. 20 No. 5. LIAHONA (USPS 311-480) Albanian (ISSN 1521-4753), is published six times a year (January, April, May, July, October, and November) by The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints, 50 E. North Temple St., Salt Lake City, UT 84150. USA subscription price is \$3.00 per year; Canada, \$3.60 plus applicable taxes. Periodicals Postage Paid at Salt Lake City, Utah. Sixty days' notice required for change of address. Include address label from a recent issue; old and new address must be included. Send USA and Canadian subscriptions to Salt Lake Distribution Center at address below. Subscription help line: 1-800-537-5971. Credit card orders (Visa, MasterCard, American Express) may be taken by phone or at store.lds.org. (Canada Poste Information: Publication Agreement #40017431)

POSTMASTER: Send all UAA to CFS (see DMM 507.1.5.2). NONPOSTAL AND MILITARY FACILITIES: Send address changes to Distribution Services, Church Magazines, P.O. Box 26368, Salt Lake City, UT 84126-0368, USA.


Më Shumë Gjenden në Internet



Lexoni artikuj dhe dorëzoheni artikullin tuaj në liahona.lds.org



Gjeni mesazhe frymëzuese për t'u shpërndarë (në anglisht, portugalisht dhe spanjisht) në facebook.com/liahona



Dërgojini përshtypjet te liahona@ldschurch.org



Abonohuni në store.lds.org
Ose vizitoni një qendër shpërndarjeje, pyetni udhëheqësit e lagjes apo telefononi në 1-800-537-5971 (SHBA dhe Kanada)

IKONAT NGA GETTY IMAGES

TEMAT NË KËTË BOTIM

Numrat përfaqësojnë faqen e parë të artikullit.

Ati Qiellor, 34, 43

Besimi, 4, 40, 42, 44

Dashuria, 66, 79

Dëshmia, 56, 68, 71

Dhënia e Shërbesës, 6, 24

Dhiata e Vjetër, 75, 76

E dhjeta, 10

Falja, 48, 72

Fatkeqësia, 4

Fryma e Shenjtë, 50, 56, 60

Guximi, 75, 76

Historia e Kishës, 28, 34

Jezu Krishti, 44, 70

Jozef Smithi, 28, 34

Konferenca e përgjithshme, 54, 56, 58, 59

Libri i Mormonit, 28, 74

Lutja, 4, 40, 41, 67, 68

Mbështetja te vetja,

40, 62

Pendimi, 48

Peshkopët, 24, 48

Profetët, 42, 71, 80

Puna misionare, 43, 66

Punësimi, 62

Shembulli, 68

Tempujt, 42, 71

Të Nxënit, 50

Udhëheqësit e Kishës,

12, 18

Uniteti, 24, 43, 60

Zbulesa, 41, 50





PORTRETE BESIMI

“Sëmundja mund të bëjë plot gjëra të mira”, thotë Mikaeli, që po vuan nga mofunksionimi i veshkave. Ngaqë sëmundja e tij i ka shtuar mirënjohjen për ungjillin, ai thotë: “Është një sprovë e mirë”.

LESLIE NILSSON, FOTOGRAF

Mikael Isak

Bajgosh, Poloni

Në fillim u zemërova.

“Përse mua?”, u luta. “Të kam shërbyer ty, Zot.” Pas njëfarë kohe, e kuptova. Shkrimet e shenjta thotë: “Ai që ka besim në mua për t’u shëruar dhe nuk caktohet për vdekjen, do të shërohet” (DeB 42:48).

Anëtarët e Kishës vijnë të lutën për mua, por shëndeti im po përkeqësohet. Ata mendojnë se lutjet e tyre nuk dëgjohen, por ato dëgjohen sepse ata bëhen njerëz më të mirë dhe ngaqë unë e ndiej se ata tregojnë dashuri për mua.

Edhe sikur të isha i shëndetshëm, sa kohë do t’i mbetej një njeriu në moshën time? Prapëseprapë, ka shumë gjëra që më presin.

Unë e kam Kishën. E kam mënyrën për t’u vënë në kontakt me Perëndinë nëpërmjet lutjes, nëpërmjet agjërimit, nëpërmjet të gjitha gjërave që bëjmë. Çfarë tjetër më duhet?

Ndonjëherë i them vetes: “Ndoshta kjo është arsyeja përse jam sëmurë – që të mund të kuptoj se në çfarë gjëje të madhe gjendem, sa e madhe është kjo kauzë.”

GJENI MË SHUMË

Mësoni më shumë rreth përballjes së sfidave të jetës me fuqinë e shpresës nga Presidenti Rasëll M. Nelson te lds.org/go/10185.

Gjeni më shumë Portrete Besimi te lds.org/go/18.

Parimet e Dhënies së Shërbesës TË MARRIM NDIHMË PËR T'I NDIHMUAR TË TJERËT

Si i përfshijmë të tjerët kur na nevojitet ndihmë në përpjekjet tona për të dhënë shërbesë? Merrni pjesë në intervistat për dhënien e shërbesës dhe mbledhjet e këshillit të dielën e parë.

Kur skleroza e shumëfishtë e la Ketin në një karrige me rrota, ajo zbuloi se kishte nevojë për ndihmë çdo natë që të ngrihej nga karrigia për të shkuar në shtrat. Kjo punë ishte tepër e madhe vetëm për një anëtar, cilido të ishte ai. Ndaj kuorumi i pleqve u këshillua rreth situatës së saj dhe vendosi të bënte një program për ta ndihmuar çdo mbrëmje.¹

Kur arrijmë t'i njohim nevojat dhe pikat e forta të atyre të cilëve u shërbejmë, mund të zbulojmë se na duhet ndihmë për të ndihmuar që nevojat e tyre të plotësohen. Intervistat për dhënien e shërbesës dhe mbledhjet e këshillit të dielën e parë janë dy mundësi për të diskutuar si t'i përfshijmë të tjerët siç duhet.

Intervistat për Dhënien e Shërbesës

Këto intervista tremujore midis motrave shërbestare dhe presidencës së Shoqatës së Ndihmës ose midis vëllezërve shërbestarë dhe presidencës së kuorunit të pleqve janë

i vetmi raportim *formal* që ne bëjmë lidhur me ata të cilëve u japim shërbesë. Intervista është një mundësi të paktën çdo tre muaj: 1) për t'u këshilluar lidhur me anët e forta, nevojat dhe sfidat e familjeve dhe individëve të caktuar, 2) për të përcaktuar se për cilat nevoja mund të ndihmojë kuorumi, Shoqata e Ndihmës ose këshilli i lagjes, dhe 3) për të mësuar nga udhëheqësit e për të dhënë nxitje për përpjekjet në dhënien e shërbesës.

Presidenti i kuorunit të pleqve dhe presidentja e Shoqatës së Ndihmës ia komunikojnë drejtpërdrejt peshkopit nevojat e rëndësishme dhe do të marrin këshilla dhe udhëzim prej tij.

Mund të gjeni më tepër informacion rreth intervistave për dhënien e shërbesës në ministering.lds.org.

T'i Bëjmë Kuptimplota Intervistat për Dhënien e Shërbesës

Në përkrahje të pohimit të Presidentit Rasëll M. Nelson që programi i dhënies së

Artikujt e titulluar "Parimet e Dhënies së Shërbesës" kanë për qëllim të na ndihmojnë që të mësojmë të kujdesemi për njëri-tjetrin – jo që të shpërndahen si mesazhe gjatë vizitave. Kur arrijmë t'i njohim ata të cilëve u shërbejmë, Fryma e Shenjtë do të na nxitë të dimë se çfarë mesazhi mund t'u nevojitet përveç kujdesit dhe dhembshurisë sonë.



JEZUSI I PËRFSHIU TË TJERËT

Jezusi ushqeu një turmë prej 5000 njerëzish me pesë bukë elbi dhe dy peshq të vegjël. Lexoni te Gjoni 6:5–14 për të përcaktuar sa herë i përfshiu Shpëtimtari të tjerët në këtë vepër të dhënies së shërbesës.



shërbesës do të jetë faktori përcaktues nga i cili do të varet rrjedha e Kishës, Plaku Geri E. Stivenson, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dha mësim: “Realizimi i këtij vizioni, . . . mund të bazohet te [fakti se] sa mirë mësohen dhe përfshihen vëllezërit dhe motrat shërbestare në intervistën për dhënien e shërbesës”.²

Katër porosi për vëllezërit e motrat tona shërbestare:

- Shkoni në intervistë duke kërkuar këshillë. Jini gati për të mësuar.
- Jini të përgatitur për t’i diskutuar nevojat për të cilat mund t’ju nevojitet ndihmë që t’i plotësoni.
- Përqendrohuni te pikat e forta dhe aftësitë e individit, jo vetëm te nevojat.
- Vihuni në kontakt me presidencën për t’u këshilluar midis intervistave tremujore sipas nevojës.

Pesë porosi për udhëheqësit:

- Intervistat nuk ka pse të jenë të gjata, por planifikoni kohë të mjaftueshme për të biseduar në një vend që lejon të zhvillohet një bisedë kuptimplote.
- Shfrytëzoheni mundësinë që t’i jepni shërbesë vëllait ose motrës shërbestare.
- Mos bëni pyetje që japin përshtypjen që thjesht po i numëroni vizitat ose po hiqni nga lista një kontakt (“A e kreve dhënien e shërbesës?”). Bëni pyetje që e përforcojnë sjelljen e dëshiruar

(“Çfarë nxitjeje keni ndier kur jeni lutur për familjen? Çfarë ndodhi kur vepruat sipas atyre nxitjeve?”).

- Dëgjoni sinqerisht dhe mbani shënime.
- Këshillohuni së bashku. Dyshet shërbestare kanë të drejtën të marrin zbuluesë për ata që janë caktuar t’u japin shërbesë.³

Pyetje dhe Përgjigje rreth Intervistave për Dhënien e Shërbesës

Çfarë është një intervistë për dhënien e shërbesës?

Është një diskutim mes vëllezërve shërbestare dhe anëtari të presidencës së kuorumit të pleqve ose mes motrave shërbestare dhe një anëtareje të presidencës së Shoqatës së Ndihmës në një mjedis që u lejon atyre të kërkojnë dhe marrim frymëzim nga Fryma e Shenjtë. Si rrjedhim, vëllezërit dhe motrat shërbestare mund të frymëzohen për të vëzhguar, për të dashur, për të dhënë mësim dhe për të ngushëlluar sipas mënyrës së Shpëtimtarit.

A duhet të jenë ballë për ballë këto intervista tremujore?

Zakonisht ato kryhen ballë për ballë, por mund të zhvillohen në telefon ose me anë të internetit kur takimi ballë për ballë nuk është i mundur. Përgjithësisht të dy anëtarët e dyshe duhet të marrin pjesë në intervistë kur është e përshatshme.

Cili është qëllimi i një interviste për dhënien e shërbesës?

Intervistat për dhënien e shërbesës janë një mundësi që vëllezërit dhe motrat shërbestare t’i shqyrtojnë situatat e tanishme, të bëjnë plane për të ardhmen dhe të marrin ndihmën që u nevojitet për individët ose familjet të cilave u japin shërbesë. Është një rast për të folur rreth burimeve që mund të sigurojnë kuorumi dhe Shoqata e Ndihmës.

Si t’ia bëj me çështjet e fshehta ose delikate?

Vëllezërit dhe motrat shërbestare ia japin informacionin e fshehtë vetëm presidentit të kuorumit të pleqve ose presidentes së Shoqatës së Ndihmës – ose drejtpërsëdrejti peshkopit. Në mbledhjet e këshillit të dielën e parë nuk duhet të jepet informacion i fshehtë ose delikat.

Mund të shihni materiale filmike trajnuese që shfaqin intervista për dhënien e shërbesës në ministering.lds.org.

Këshillimi rreth nevojave të tjerëve është në qendër të intervistave për dhënien e shërbesës. Shih edhe artikullin nga rubrika “Parimet e Dhënies së Shërbesës” me titull “Counsel about Their Needs”, në numrin e shtatorit 2018.



Mbledhjet e Këshillit të Dielën e Parë

Përveç intervistave për dhënien e shërbesës, mbledhjet e këshillit të dielën e parë janë një mënyrë tjetër për t'i përfshirë të tjerët në dhënien e shërbesës. Në mbledhjet e Shoqatës së Ndihmës dhe të kuorumit të pleqve, frymëzimi mund t'u vijë të pranishmëve nëpërmjet Shpirtit dhe nga të tjerët që janë në grup.

Qëllimi i një mbledhjeje këshilli është që [anëtarët/et]:

- “Të këshillohen së bashku rreth përgjegjësisë, mundësive dhe sfidave vendore;
- “Të mësojnë nga idetë dhe përvojat e njëri-tjetrit; dhe
- “Të planifikojnë mënyra për të vepruar sipas mbresave të marra nga Shpirti.”⁴

Mbledhjet e këshillit janë më tepër sesa diskutime: mbledhjet na shtojnë të veprojmë si individë ose si grup sipas frymëzimit nga Shpirti. Anëtarët mund të ndiejnë dëshirë për ta përbushur punën e Zotit si rrjedhojë e këtyre mbledhjeve.

Ftesë për të Vepruar

“Lutja jonë sot”, tha Plakun Xhefri R. Holland, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, “është që çdo burrë e çdo grua – dhe të rinjtë e të rejat tona më të rritura – do të [jenë] të zotuar më thellësisht për një përkujdesje të përzemërt ndaj njëri-tjetrit, të shtyrë vetëm nga dashuria e pastër e Krishtit për ta bërë këtë gjë.”⁵ ■

SHËNIME

1. Shih *Mormon Messages* video “Lift”, [lds.org/media-library](https://www.lds.org/media-library).
2. Geri E. Stivenson, në “Intervistat për Dhënien e Shërbesës” (material filmik), [ministering.lds.org](https://www.lds.org/ministering).
3. Shih Rasëll M. Nelson, “Dhënia e Shërbesës”, *Liahona*, maj 2018, f. 100.
4. *Eja, Më Ndiq – Për Përfundimin e Melkizedekek dhe Shoqatën e Ndihmës* në *Liahona*, nëntor 2017, f. 140; në dispozicion edhe në [comefollowme.lds.org](https://www.comefollowme.lds.org).
5. Xhefri R. Holland, “Jini me Ta e Forcojini Ata”, *Liahona*, maj 2018, f. 103.

KU SHKOJNË PARATË E TË DHJETAVE

Çfarë ndodh me paratë që paguani për të dhjetën?



Ju fitoni para.



Ju dhuroni 10 për qind të të ardhurave tuaja për të dhjetën (shih DeB 119).



Ju ia jepni të dhjetën tuaj një anëtar të peshkopatës apo presidencës së degës suaj ose e dërgoni me internet te [donations.lds.org](https://www.donations.lds.org).



Në zyrat qendrore të Kishës, Presidenca e Parë, Kuorumi i Të Dymbëdhjetë Apostujve dhe Peshkopata Kryesuese janë Këshilli mbi Planifikimin e të Dhjetave (shih DeB 120). Siç drejtohen nga Zoti, ata marrin vendime të frymëzuara mbi mënyrën si do të përdoren këto fonde të shenjta të dhjetash

TË DHJETAT MUND TË PËRDOREN PËR:



Ndërtimin dhe mirëmbajtjen e tempujve, kishave dhe ndërtesave të tjera në pronësi të Kishës



Zbatimin e programeve arsimore të Kishës



Shtypjen e shkrimeve të shenjta dhe të materialeve të tjera



Bërjen e kërkimeve për historinë familjare



Bërjen e përpjekjeve për mirëqenie dhe ndihma humanitare



Bërjen e punës misionare



Sigurimin e veprimtarive të Kishës për shoqërimin midis anëtarëve të lagjes apo degës

MËSO MË SHUMË

- Plaku Dejvid A. Bednar, "Pragjet e Qiellit", konferenca e përgjithshme e tetorit 2013
- Malakia 3:7-18
- "E dhjetë", Të Vërtetë Ndaj Besimit (2005), f. 39-41



Nga Plaku D. Tod Kristoferson,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

PLAKU GERIT W. GONG: **Duajeni Zotin dhe Mirëbesojini Atij**

Kur ishte student për diplomim dhe i sapomartuar në Universitetin e Oksfordit në Angli, Gerit W. Gongu e mësoi nga përvoja vetjake se, kur e duam Zotin dhe i mirëbesojmë Atij, Ai do të na ndihmojë, do të na udhërrëfjë dhe do të na forcojë.

Geriti ishte student me bursën Rouds që po punonte për të përfunduar dy gradë shkencore, njëra prej të cilave doktoratë. Në të njëjtën kohë, ai po shërbente në peshkopatën e Lagjes së Oksfordit. Atij dhe bashkëshortes së tij, Suzanës, iu kujtua këshilla që iu dha Plaku Dejvid B. Heit (1906-2004), i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, kur kreu ceremoninë e tyre martesore në Tempullin e Solt-Lejkut. “Ai na tha që të kemi gjithmonë një thirrje”, thotë Plaku Gong. “E dinim që, nëse do t’i mirëbesonim Perëndisë dhe do të bënim më të mirën tonë, Ai do të na ndihmonte.”

Geriti dhe Suzana me të vërtetë morën “ndihmë hyjnore dhe mëshira të dhembshura”, thotë ai. Teksa vazhdonte në peshkopatë, Geriti i përmbushi të gjitha kërkesat akademike për një gradë doktorate, përveç disertacionit të tij. Ai i kërkoi një bekim priftërie peshkopit të Lagjes së Oksfordit, Alen Uebsterit. Në bekim, Geriti mori këtë premtim: “Vazhdo të bësh gjithçka mundesh dhe Zoti do të të bekojë”.

Dy anëtarë të lagjes, që ishin sekretarë me përvojë në fushën ligjore, dolën vullnetarë që të ndihmonin për ta shtypur dorëshkrimin e tij dhe Geriti që në gjendje ta përfundonte disertacionin brenda disa muajsh. Në fakt, ai përfundoi si një diplomë pasuniversitare, ashtu edhe një gradë

doktorate në vetëm tre vjet. Pas diplomimit, ai gjithashtu pranoi një pozicion si kërkues [shkencor] i fakultetit në universitet. Përvoja e tij në Oksford e përforcoi mirëbesimin e tij te Zoti, mirëbesim që vazhdon deri në këtë ditë dhe do të vazhdojë ta bekojë Gerit W. Gongun teksa shërben tani në Kuorumin e Dymbëdhjetë Apostujve.

Bukët dhe Peshqit

“Zoti është i dashur e dashamirës dhe kërkon të na bekojë”, thotë Plaku Gong. “Nëse bëjmë më të mirën tonë, Ai do të na aftësojë për të bërë më shumë nga sa do të mund të bënim përndryshe. Është njësoj si shumëfishimi i bukëve dhe peshqve. Zoti e merr atë që është në dispozicion, dhe e zmadhon shumë përtej asaj që do të mund të bënim ne vetë.”





thotë ai. “Në Oksford, Suzana dhe unë e çmuam përvojën tonë në lagjen e Kishës po aq sa dhe përvojën tonë akademike. Shumë prej miqve tanë më të dashur deri në këtë ditë janë njerëz nga Lagjja e Oksfordit.”

Mes këtyre miqve janë Timi dhe Katerina Viti, që kujtojnë kohën kur shkolin në tempull me çiftin Gong. “Më kujtohet qartë se Vëllai Gong e hiqte orën e tij nga dora që të mos mund të shpërqendrohej ose të shtrëngohej nga koha kur mendonte për çështjet e përjetësisë”, thotë Motra Vit. “Ai veprim i vogël më ka ndihmuar të jem më e zellshme në vetë adhurimin tim në tempull.”

Çifti Gong takon shpesh miq që i njohin për shkak të ungjillit.

“Njerëzit do të thonë: ‘Kemi punuar me ju kur ishit në këshillin e lartë’, gjëra të tilla”, thotë Plaku Gong, “dhe është e njëjta gjë dhe për mua. Jam mirënjohës për një president kunji dhe një këshill lagjeje që më ndihmuar kur isha peshkop i ri. Ne të gjithë u jemi borxhlinj prindërve, vjehërrve e kunetërve e kunatave, fqinjëve, presidentëve të misioneve, motrave dhe udhëheqësve të priftërisë që janë të dashur me ne, që na udhërrëfejnë dhe na nxitin që të vijmë te Krishti.”

Trashëgimia Familjare

Historia e familjes së Plakut Gong shkon pas 34 breza deri te Dragoi i Parë Gong, lindur në

Parimi i bukëve dhe peshqve është i vërtetë edhe për të mësuarin, thotë ai. “Edhe kur nuk ka në dispozicion arsimim zyrtar, shpirti i të nxënësve është ai që ka rëndësi, sepse të nxënësve zgjat në përjetësi. Ne të gjithë mund ta kërkojmë dritën dhe të vërtetën pavarësisht nga rrethanat tona. Kur ta bëjmë atë, Zoti do të na ndihmojë ta gjejmë.”

Përkatësia në Besëlidhje

Ndërkohë që ishte në Oksford, Plaku Gong mësoi një tjetër parim të ungjillit, një parim që ai e quan “përkatësia në besëlidhje”.

“Teksa i afrohem më shumë Zotit, ne gjithashtu afrohem më shumë me njëri-tjetrin”,

Plaku Gong ia jep meritën për shumicën e lumturisë së tij prindërve të tij, Xhinit dhe Uolterit, dhe bashkëshortes së tij, Suzanës. Shtëpia e prindërve të tij “ishte e mbushur me nderim të thellë për dashurinë e Perëndisë për secilin prej fëmijëve të Tij”, thotë ai. Kur Plaku Gong u takua për herë të parë me bashkëshorten e tij, ndjeu sikur Suzana ishte dikush që ai e kishte njohur ngaherë.

vitin 837 ps.K. Gjyshërit e Plakut Gong emigruan nga Kina për në Shtetet e Bashkuara. Nëna e tij, Xhina, u bashkua me Kishën kur ishte adoleshente në Havai të SHBA-së dhe më vonë ndoqi Universitetin “Brigam Jang” në Provo të Jutës në SHBA, ku qëndroi te familja e Gerit de Jongut, dekanit të parë të Kolegjit të Arteve të Bukura. “Familja de Jong më ndihmoi ta kuptoja se si është një familje në ungjill”, thotë ajo.

Pas UBJ-së, Xhini ndoqi Universitetin e Stenfordit në Palo-Alto në Kaliforni të SHBA-së, ku takoi Uolter A. Gongun. “Ai ishte tashmë i krishterë dhe shpejt e kuptoi se çfarë ofron ungjilli i rivendosur”, thotë Xhini. Ai u bashkua me Kishën dhe një vit më vonë ata u martuan në Tempullin e Solt-Lejkut. Që të dy u bënë arsimtarë profesionistë dhe së bashku shpenzuan më shumë se 70 vite në mësimdhënie.

“Babi u bë edhe patriark”, thotë Plaku Gong, “dhe për shkak se bekimet patriarkale jepeshin në shtëpinë tonë, shtëpia jonë u mbush me nderim të thellë për dashurinë e Perëndisë për secilin prej fëmijëve të Tij.”

Më 23 dhjetor 1953, në Redud-Siti në Kaliforni, lindi i pari nga tre fëmijët e Xhinit dhe Uolterit. “Emri i tij i parë, Gerit, është holandez, në nderim të Gerit de Jongut”, shpjegon Xhini. “Emri i tij i mesit është Uolter, për të nderuar babanë e tij. Dhe mbiemri ynë është kinez, gjë që nderon trashëgiminë e tij.”

Xhini thotë se Geriti ishte i vëmendshëm ndaj vëllait dhe motrës më të vogël, Brajënit dhe Margaritës. “Atij i pëlqente t’i ndihmonte ata”, thotë ajo, “qoftë dhe me gjëra të vogla të tilla si t’u mësonte atyre se si të lidhnin këpuçët.” Asaj i kujtohet kur u kthyen nga kisha në shtëpi një ditë dhe i dëgjoi pa dashur Geritin dhe Brajënin që po thoshin se ata mendonin që një bisedë në mbledhjen e sakramentit ishte e mërzitshme. “Kështu që unë i sfidova ata: ‘Atëherë bëni ju një bisedë më të mirë’. Ata e pranuan sfidën dhe filluan t’u kushtonin më shumë vëmendje të gjitha bisedave”, thotë ajo.

Nga e majta: Merxhori dhe Gordon B. Hinkli që përshëndetën Geritin dhe Suzanën në festën për martesën e çiftit Gong. Kur ishte misionar në Tajvan, Plaku Gong i dha mësim një familjeje dhe vite më vonë, si Autoritet i Përgjithshëm, u takua me nipin e njërës prej bijave të familjes. Në Vietnam, Plaku dhe Motra Gong pikturuan një afresk si një mënyrë për t’u sjellë gëzim fëmijëve që po hasnin sfida. Pjesëtarë të familjes Gong u takuan me ata që ndihmuan për pikturimin e afreskut në Vietnam.

Kur ishte adoleshent, Geriti i pëlqente shumë të shkonte në marshime me çanta shpine me të rinj të tjerë të lagjes së tij. Uolli Salbaka, një mik gjatë tërë jetës, kujton në veçanti një udhëtim me kamping. “Isha atje me Geritin dhe vëllanë e tij, Brajënin, dhe një mik që nuk ishte anëtar i Kishës sonë. Nuk e di pse, ne filluam të këndonim himne. Geriti këndoi melodinë, Brajëni këndoi si tenor dhe unë këndova si bas. Mendoj se kënduam 10 a 20 himne, thjesht nga gëzimi për të kënduar. Ishte një përvojë e mirë. Mikut tonë joanëtar i bëri përshtypje.”



Vëllai Salbaka kujton gjithashtu që në shkollë të mesme, Geriti iu kërkoi nxitësve të tifozëve që të brohoritnin në heshtje për ekipin e shahut. “Ai i bindi se përkrahja morale është e mirë për cilindo”, thotë ai, “dhe ata vërtet erdhën në një ndeshje.”

Pas shkollës së mesme, Plaku Gong ndoqi Universitetin “Brigam Jang”. Nga viti 1973 deri në 1975-ën, ai shërbeu në Misionin e Tajpeit në Tajvan, pastaj u kthye në UBJ ku në vitin 1977 mori një diplomë universitare të nivelit të parë në degën e studimeve aziatike dhe studimeve universitare.

Njohja dhe Martesa

Pas misionit, Plaku Gong doli vullnetar për të bërë mbrëmje rreth vatrës të dielave te

Qendra e Trajnimit të Misionarëve në Provo. Mbrëmjet rreth vatrës ndihmonin për njohjen e misionarëve që po shkonin drejt Tajvanit, me njerëzit, zakonet dhe kulturën e atjeshme. Një nga misionaret ishte Motra Suzan Lindsi nga Tejlorsvili në Jutë, e bija e Riçard P. dhe Merian B. Lindsit. Vëllai Lindsi ishte anëtar i Kuorunit të Dytë të Të Shtatëdhjetëve. “E ndjeva se Suzana ishte dikush që e kisha njohur ngaherë”, thotë Plaku Gong.

Dy vjet më vonë, disa muaj pasi Suzana ishte kthyer në UBJ pas misionit të saj, Geriti ishte në Provo me familjen e tij. Babai i tij po jepte mësim në universitet dhe Geriti kishte planifikuar një vizitë dyjavore. Vizita u zgjat në katër javë, teksa ai dhe Suzana dilnin në takime çdo ditë. Pastaj Geriti u largua për një stazh në Havai përpara se të kthehej në Oksford.

“Ne u shoqëruam nga dy hemisfera të ndryshme”, kujton Plaku Gong. “Po përpiqesha të studioja në Angli teksa mësoja gjithçka mundesha për të që përtej oqeanit Atlantik.”



“U fejuam me telefon”, thotë Motra Gong. “Ai erdhi sërisht në shtëpi për Festën e Falënderimeve dhe ne u martuam ditën e parë të hapjes së tempullit në vitin pasardhës.” Dy javë më vonë, ata fluturuan për në Angli që të fillonin një jetë të re së bashku.

“Kur njerëzit martohen, ata flasin për dy familje që bëhen një”, thotë Plaku Gong. “Dhe kjo është vërtet ajo që më ndodhi mua. Ndihem pjesë e familjes Lindsi po aq sa jam pjesë e familjes Gong.”

Një Karrierë e Jashtëzakonshme

Pasi kaloi një kohë të shkurtër në fakultet në Oksford, karriera e Geriti u zhvendos në shërbimin qeveritar në Uashington D.K., në SHBA. Në vitin 1984, ai shërbeu në personelin e fushatës prej së cilës u rizgjodhën Regani dhe Bushi, ku punoi në të njëjtën zyrë me Majk Levitin, që më vonë u bë guvernator i Jutës. “Geriti ishte vëzhgues dhe i vëmendshëm”, thotë Vëllai Leviti, “por ai u shqua për mirësinë e tij e pareshtur.”

Në vitin 1985, Geriti shërbeu si ndihmës i posaçëm i nënsekretarit të shtetit në Departamentin e Shtetit. Në vitin 1987 u bë ndihmës i posaçëm i ambasadorit të SHBA-së në Pekin të Kinës. Dhe që nga viti 1989 deri në 2001-shin, shërbeu në pozicione të ndryshme në Qendrën për Studimet Strategjike dhe Ndërkombëtare në Uashington D.K. Ai pastaj u kthye në botën akademike kur pranoi një post si ndihmës i presidentit për planifikimin strategjik në UBJ. Kaloi nëntë vjet në atë rol.

Kerri Xhenkinsi, ndihmësja e presidentit për komunikimet në universitet në UBJ, punonte në zyrën ngjitur. Ajo kujton aftësinë e Gerit Gongut për t'i nxitur njerëzit rreth tij. “Nëse nuk do ta kishe besimin në vetvete se mund ta merrje përsipër një detyrë të vështirë, ai do ta kishte atë besim në vetvete për ty”, thotë ajo. “Ai bënte gjithçka kishte fuqi për të të dhënë këshillë, për të të dhënë shpresë dhe për të





të lejuar të shkoje përpara e ta vërtetoje se kush ishte.”

Gjykatësi federal, Tomas B. Grifiti, që u njoh me Plaku Gong si në Uashington ashtu edhe në UBJ, e përshkruan në këtë mënyrë ndërveprimin me të: “Në fund të një bashkëbisedimi, do ta kuptoj se përqendrimi kishte qenë tek ti. Ai është një dëgjues i shkëlqyer. Dhe ai bën pyetje që të bëjnë të mendosh.”

Sesil O. Samuelsoni, Autoritet nderi i Përgjithshëm I Shtatëdhjetë dhe ish-president i UBJ-së, thotë se Plaku Gong është “në përgjithësi i heshtur, por mendjen e ka gjithmonë duke punuar”.

Jeta Familjare

Geriti dhe Suzana Gongu u bënë prindërit e katër bijve – Abrahamit, Samuelit, Kristoferit dhe Methjus – të cilët u rritën në rrethana të larmishme.

“Kur ishim në Pekin, fëmijët tanë patën bekimin që të bëheshin miqtë më të mirë të njëri-tjetrit”, thotë Plaku Gong.

“Nga njëra anë, ata patën mundësinë që të shihnin një pamje të gjerë të botës”, shton Motra Gong. “Nga ana tjetër, na ndihmoi të lidhemi fort si familje. Djemtë tanë ende thonë se gjëja më e mirë që kemi bërë si prindër, është që u dhamë vëllezër.”

“Një herë, ne përdorëm pikët e mbledhura nga kilometrat e fluturimeve”, thotë Plaku Gong. “E lejuam çdonjërin të zgjidhte një vendmbërritje. E filluam nga Uashington D.K.-ja ku po jetonim, pastaj shkuam në Angli, Republikën Çeke, Greqi, Turqi, Indi, Kinë dhe Japoni.

Kishim një rregull të palëkundur gjatë atij udhëtimit”, thotë Suzana. “Kudo ku shkonim, hanim atë që hanin vendasit.” Së fundi, në Japoni, në fund të udhëtimit, Plaku Gong u tha të bijve se do t’i çonte në një restorant të famshëm në të gjithë botën për [gatime me] mish lope. Në një

restorant Mek-Donaldi, katër bij të uritur dhe dy prindër konsumuan 17 hamburgera!

“Si Mami ashtu edhe Babi e vlerësojnë shumë të nxënin nga përvoja”, thotë Abrahami. “Babi mendon thellësisht mbi mënyrën se si përvoja ndikon te njerëzit, përfshirë kultura të tëra.” Abrahami vë re gjithashtu se babai i tij “flet me kujdes sepse do t’i japë kuptim tërësisht dhe ta besojë plotësisht atë që po thotë”.

Samueli kujton që “megjithëse shumë i zënë me punë në Departamentin e Shtetit, Babi kalonte kohë çdo natë për të më mësuar dhe trajnuar për një konkurs matematike në klasën e tretë ku dëshiroja të merrja pjesë, që quhej ‘Sfida 24’. Më tha që po të fitoja, do të bënim një festë me akullore me 24 lloje gjërash shoqëruese përsipër.” Samueli arriti deri në finalet kombëtare por nuk fitoi. Familja Gong hëngri akullore gjithsesi. Por nuk ishte e lehtë të gjeje 24 lloje gjërash shoqëruese – njëra ishte pastërma lope.

Kristoferi dhe Methju komentojnë për faktin se sa shumë ata “e vlerësojnë mirëbesimin, dashurinë dhe përkushtimin që kanë babai dhe mamaja [e tyre]”. Është një dashuri që Plaku dhe Motra Gong e kanë për njëri-tjetrin, për secilin bir, si dhe për familjen më të gjerë.



“Përveçse një atë i përkushtuar, Geriti është një bir dhe vëlla i përkushtuar”, thotë Suzana. “Ato role janë të rëndësishme për të. Ai na ndihmon ta kuptojmë se marrëdhëniet familjare janë më të rëndësishmet nga gjithçka.”

Përvoja në Kishë

Edhe pse i ngarkuar me karrierën dhe familjen, Plaku Gong vazhdoi të shërbente me gatishmëri në Kishë, duke përmbushur thirrje si këshilltar i lartë, udhëheqës i grupit të priftërinjve të lartë, president i Shkollës të së Dielës për kunjin, mësues seminari, peshkop, president i misionit të kunjit, president i kunjit dhe si I Shtatëdhjetë Zonal.



Nga e majta: Në Tajlandë, Plaku Gong takoi Hirësinë e Tij, Kardinalin Francis Javier Kringsak Kovitavaniti, kryepeshkopin katolik të Bangkokut. Plaku Gong kënaqet me udhëtime vetëm për vetëm me bijtë e tij, të tillë si ky udhëtim në Kanada me të birin, Samuelin. Plaku Gong u shprehu mendimet e tij mbi Bukën e Jetës mësuesve të seminarit dhe institutit në vitin 2017. Motra Gong shkëmben përshëndetje në shtëpinë e një anëtareje kamboxhiane.

Çfarëdo që është thirrur të bëjë, dhe po ashtu në jetën familjare, ai vazhdimisht shfaq disa karakteristika. “Ai e sheh cilindo si një bir apo bijë të Atit Qiellor”, thotë Motra Gong. “Por mbi të gjitha, ai e do Zotin. Ai vërtet dëshiron me gjithë zemër që ta ndërtojë mbretërinë dhe t’i bekojë fëmijët e Atit Qiellor.”

Dhe ai e admiron bashkëshorten e tij. “Çfarëdo që më kërkohet të bëj”, thotë ai, “Suzana është krah meje. Ajo ndihet rehat me cilindo dhe është e prirur të ndërveprojë me njerëzit e tjerë. Ajo ka qenë gjithmonë e gatshme të shkonte në vende të reja dhe të

provonte gjëra të reja, gjë për të cilën jam mirënjohës.”

Shërbimi me Të Shtatëdhjetët

Më 3 prill 2010, Plaku Gerit W. Gong u mbështet si një Autoritet i Përgjithshëm I Shtatëdhjetë. Ai u caktua në Presidencën e Zonës së Azisë, me zyra qendrore në Hong-Kong. Më vonë u bë President i Zonës së Azisë. Më 6 tetor 2015, Plaku Gong u mbështet në Presidencën e Të Shtatëdhjetëve, ku vazhdoi përvoja e tij ndërkombëtare, përfshirë shqyrtime zonale në pjesë të ndryshme të botës të tilla si Afrika dhe Amerika Qendrore.

“Ti i takon dhe arrin t’i duash shenjtoret në të gjitha këto vende”, thotë ai. “Ti ndihesh i bekuar që njerëzit të tregojnë ty për besimin e tyre, sepse përvoja e tyre për Perëndinë që vepron në jetën e tyre, bëhet pjesë e kuptueshmërisë se kush është Perëndia dhe se sa e do Ai secilin prej nesh.”

“Kur e dërgojmë Plakun Gong në çfarëdo situatë, njerëzit e përfshirë aty e ndiejnë se kanë gjetur një mik”, thotë Presidenti Rasëll M. Nelson. “Ai ka nivel të lartë njohurie, por është i përlur. Ai përshtatet me njerëzit e të gjitha niveleve dhe është gjithmonë i përgatitur mirë dhe bindës.”

Thirrja si një Apostull

Kur Presidenti Nelson i dha Plakut Gong thirrjen që të shërbente si anëtar i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, profeti “me dashuri i mori duart e mia në duart e tij, me Suzanën time të dashur në krahun tim, dhe më drejtoi këtë thirrje të shenjtë nga Zoti, e cila më la pa frymë” (“Zoti Krisht Është Ngritur Sot”, *Liahona*, maj 2018, f. 97). I përlur, por i sigurt për dashurinë e tij për Zotin dhe mirëbesimin e tij në Të, Plaku Gong e pranoi thirrjen. Ai u mbështet më 31 mars 2018. I përgatitur me kujdes nga Zoti, ai tani do të japë shërbesë si një “dëshmitar [i] veçantë [i] emrit të Krishtit në gjithë botën” (DeB 107:23). ■



Nga Plaku Nil L. Andersen,

i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

PLAKU ULISES SOARES:

Një Burrë pa Mashtrim

Në ditët e hershme të shërbesës së Tij, teksa Jezusi po përzgjidhte Apostujt e Tij, Ai pa Natanaelin që po vinte drejt Tij. Ai menjëherë e dalloj mirësinë e Natanaelit duke shpallur: “Ja një Izraelit i vërtetë, tek i cili s’ka mashtrim”¹.

Jezusi e dinte se Natanaeli ishte një njeri me zemër të dëlirë, me qëllime të ndershme dhe pa hipokrizi apo dredhi. Zoti e do këtë cilësi të integritetit të drejtë moral dhe Ai e thirri Natanaelin që të ishte Apostull.²

Ulises Soaresi është si Natanaeli i lashtësisë dhe Shpëtimtari e ka thirrur edhe atë.

“Drita e Prindërve të Mi”


Ulisesi, më i vogli nga katër vëllezër, u lind në San-Paolo të Brazilit më 2 tetor 1958. Ai erdhi nga fillime të përulura, por prindërit e tij, Aparesido dhe Mercedes Kareço Soares, ishin njerëz të ndershëm e që punonin shumë, të cilët i dëgjuan me çiltërsi misionarët. Ata u bashkuan me Kishën në vitin 1965 kur Ulisesi ishte gjashtë vjeç.

“Nuk e pashë kurrë Vëllanë Aparesido të mungonte në një mbledhje”, thotë Osiris Kabrali, i cili shërbeu si president kunji kur Ulisesi ishte i ri. “Mercedesi gjithashtu ishte shumë besnike. Ulisesi e trashëgoi përkushtimin e prindërve të tij.”

Zemra e Ulisesit, e mirë nga natyra, lulëzoi teksa ai mësoi rrugët e Zotit. “Unë u rrita në Kishë duke ndjekur dritën e prindërve të mi”, thotë Plaku Soares. Teksa e ndoqi atë dritë, dëshmia e tij u bë më e fortë, pavarësisht kundërshtisë.

“Unë isha i vetmi anëtar i Kishës në shkollën time dhe djemtë e tjerë gjithmonë përpiqeshin të më tërhiqnin në veprime jo të mira dhe të më nxitnin të bëja gjëra që ishin të gabuara”, thotë ai. “Më duhej të mësoja ta mbroja veten në këto sfida, por gjithmonë mirëbesova me gjithë zemër te Zoti që do të më ndihmonte të kisha sukses. Kur isha i ri mësova që, nëse ti e bën pjesën tënde, Zoti do ta bëjë pjesën e Tij. Por ti duhet të mbahesh fort te dora e Tij dhe te ungjilli i Tij.”

Kur Ulisesi ishte 15 vjeç, peshkopi i tij i kërkoi t’i jepet mësim një klase të rinjsh në Shkollën e së Dielës. Një mësim që zhvilloi ai, përqendrohej te marrja e një dëshmie





Një mësim i tillë erdhi teksa u përgatit për një mision. Gjatë intervistave me Ulisesin, peshkopi i tij e theksoi rëndësinë e bindjes ndaj urdhërimeve dhe të jetuarit denjësisht. Ai theksoi gjithashtu përgatitjen financiare.

Sot të gjithë misionarët nga Brazili kontribuojnë për kostot e misionit të tyre dhe shumë familje e mbulojnë të gjithë koston. Teksa Ulisesi iu afrua moshës së misionit, ai vendosi se do t'i fitonte të gjitha paratë që i nevojiteshin për misionin e tij. Duke përdorur etikën e fuqishme të punës që kishte mësuar duke punuar në biznesin e vogël të të atit dhe i pajisur me aftësinë për të shtypur shpejt, Ulisesi gjeti një punë ku ndihmonte një

për ungjillin. Ulisesi e kishte studiuar Librin e Mormonit, e kishte ndier gjithmonë se Kisha ishte e vërtetë dhe kishte besuar te Shpëtimtari Jezu Krisht.

Teksa përgatiti mësimin, dëshironte t'i dëshmonte fuqimisht klasës së tij për vërtetësinë e ungjillit. “Studiova dhe u luta me zjarr”, kujton Plaku Soares. “Pasi u gjuhëzova, më erdhi në zemër një ndjenjë shumë e ëmbël, një zë i ulët që më konfirmoi mua se isha në shtegun e drejtë. Ishte kaq e fortë sa nuk mundesha kurrë të thosha se nuk e dija.”

Teksa Ulisesi u bë më i pjekur, ai mësoi që, nëse do të bënte më shumë nga sa pritej apo i kërkohej, Zoti do ta bekonte atë me bollëk.

Ulises Soaresi “u rrit në Kishë duke ndjekur dritën” e prindërve të vet, Aparésido dhe Mercedes Soaresit (në të majtë). Teksa Ulisesi i mirëbesoi Zotit pavarësisht nga kundërshtia, ai mësoi kur ishte djalosh që të mbahej fort te Shpëtimtari dhe tek ungjilli i Tij.

kompani që të përgatiste listëpagesat e saj.

Pasi kaloi një provim të vështirë pranimit, ai filloi të studionte kontabilitet mbrëmjeve në një shkollë të mesme teknike. Çdo muaj, pasi e paguante të dhjetën, ai do të kursente para për misionin e tij. Pas një viti, e transferuan në sektorin e kontabilitetit të kompanisë së tij.

“Ajo është mënyra se si kurseva para për të paguar për misionin tim”, thotë Plaku Soares. “Dhe çdo muaj gjatë tri viteve përpara se të nisesh, do të blija diçka që më duhej – një këmbë, një palë pantallona, një palë çorape, një kravatë, një valixhe.” Atij gjithashtu i nevojiteshin, dhe i mori, dashuri dhe përkrahje e fortë nga prindërit e tij dhe udhëheqësit vendorë.

Ulisesi u thirr në Misionin e Brazilit në Rio-de-Zhaneiro. Ai shërbeu në pjesën e parë të misionit të tij nën Presidentin Helio da Roça Kamargo, që do të bëhej më vonë Autoriteti i parë i Përgjithshëm i thirrur nga Brazili. Ulisesi e filloi misionin nga fillimi i vitit 1978. Tempulli i parë në Amerikën Latine u përkushtua më vonë gjatë atij viti në San-Paolo nga Presidenti Spenser W. Kimball (1895–1985).

Në janar të vitit 1980, Ulisesi dhe shoku i tij [i misionit], që gjithashtu nuk e kishte marrë dhurimin [indaumentin] e tij, hipën në një autobus në Rio-de-Zhaneiro për një udhëtim prej tetë orësh për në Tempullin e San-Paolos në Brazil. Prindërit dhe motrat e vëllezërit e Ulisesit u takuan me të atje dhe familja Soares u vulos për kohën dhe përjetësinë. Ulisesi nuk i ka harruar kurrë ato pesë orë së bashku në Tempullin e San-Paolos. Më vonë atë ditë, ai dhe shoku i tij [i misionit] u kthyen në terrenin e misionit.


Vendosja e Perëndisë të Parin

Ulisesi gëzoi një mision të suksesshëm, që e forcoi më tej dëshminë e tij. Kur u kthye në shtëpi, ai gjeti një punë dhe filloi të studioje kontaktet dhe ekonomi në një universitet vendor.

Kishte rreth shtatë muaj që ishte në shtëpi, kur hasi “Motrën Morgado” në një vallëzim shumëkunjësh. Ulisesi kishte shërbyer si udhëheqësi i zonës së saj për njëfarë kohe dhe ata të dy e kaluan mbrëmjen duke biseduar për lajmet e reja dhe duke treguar histori nga misioni. Tri javë më vonë, ata filluan të dalin në takime.

Rozana Fernandes Morgado ishte tetë vjeçe kur motra e saj më e madhe, Margareta, filloi ta merrte në kishë. Përfundimisht, dy kërkueset e vogla dhe besnike morën leje nga babai i tyre që të pagëzoheshin, por secila do të duhej të priste derisa të mbushte 17 vjeçe. Rozana e frekuentoi kishën për nëntë vjet përpara se të merrte leje që të pagëzohej.

Plaku Soares ia jep meritën bashkëshortes së tij, Rozanës, për “të gjitha gjërat e mira në jetën [e tij]”. Çifti u martua në vitin 1982 (djathtas larg), dy vjet pas një takimi të rastësishëm pas shërbimit të tyre në Misionin e Brazilit, Rio-de-Zhaneiro.



Plaku Soares me Rozanën në vitin 2000 (sipër); me familjen e tij (djathtas poshtë); dhe si misionar kohëplotë në vitin 1979 (djathtas sipër), me anëtarin e ri Elizer Vagner de Suza Santos dhe të fejuarën e atëhershme të tij (tani bashkëshorte), Rexhinën. Vëllai Santos aktualisht shërben si president i Kunjtit Vila Velja, Brazil, në shtetin Espirito Santo. Kim Piketi, shoku misionar i Plakut Soares, duket në sfond.

Ulisesi jetonte në pjesën veriore të San-Paolos dhe Rozana jetonte me prindërit e saj në sektorin jugor të qytetit. Udhëtimi përmes qytetit të stërmadh kërkonte dy deri në tre orë me autobus dhe metro. Për fat të mirë, Margareta dhe bashkëshorti i saj, Klaudioja, jetonin pranë shtëpisë së prindërve të saj.

“Kur Ulisesi vinte fundjavave që të dilte në takime me Rozanën, ishte e vështirë për të që të kthehej në shtëpi aq vonë natën”, kujton Plaku Klaudio R. M. Kosta, Autoritet i Përgjithshëm I Shtatëdhjetë, për baxhanakun e tij të ardhshëm. Kështu, ai dhe Margareta e ftonin



Ulisesin ta kalonte natën në shtëpinë e tyre pas takimeve. “E birësua atë për njëfarë kohe”, shton Plaku Kosta.

“Ai do të flinte në divanin e dhomës sonë të ndenjjes”, thotë Motra Kosta. “Sapo ishim martuar, kështu që nuk kishim kuverta të tepërta. Por ai do të mbulohej me një perde të vjetër që kishim. Ai ishte i lumtur sepse do të mund ta shihte sërish Rozanën ditën tjetër. Ai ishte i mirë me motrën time dhe prindërit e mi e pëlqenin shumë.”

Ulisesi dhe Rozana u martuan në Tempullin e San-Paolos në Brazil, më 30 tetor 1982.

Nëse kaloni disa minuta me Plakun dhe Motrën Soares, dashuria, admirimi dhe respekti i tyre për njëri-tjetrin bëhet shpejt i dukshëm. Për Plakun Soares, Rozana “ka qenë për mua dhe

familjen time shembull i mirësisë, dashurisë dhe përkushtimit tërësor ndaj Zotit”³. Për Motrën Soares, Ulisesi është “një dhuratë nga qielli”.

Motra Soares shton: “Ai ka qenë gjithmonë jashtëzakonisht i përgjegjshëm dhe i drejtë, është kujdesur gjithmonë mirë për familjen tonë dhe gjithmonë më ka trajtuar shumë mirë. Në të gjitha thirrjet e tij në Kishë, ai ka bërë më të mirën. Ai shkon dhe bën. Ai gjithmonë i vendos të parat gjërat e Perëndisë në jetën e tij. Unë bie pa pushim në dashuri me të sepse e di që, nëse ai i vë gjërat e Perëndisë të parat, ai gjithashtu do të më vendosë mua të parën.”



Për bashkëshorten e tij, Plaku Soares thotë: “Ajo është heroina dhe frymëzimi i vërtetë në familjen tonë. Ajo është e dashur, e sjellshme dhe e duruar me gjithkënd. Ajo e bashkon familjen tonë dhe sheh të mirën te cilido. Ajo ka dhënë ndihmesë të jashtëzakonshme për atë që ka ndodhur në jetën time. Për thirrjen time në Kuorumin e Dymbëdhjetë Apostujve, me shaka i thashë asaj: “Ta vë fajin ty për këtë sepse ti e ke zmadhuar kaq shumë fuqinë e ungjillit në jetën time.”

Një Zemër e Madhe

Gustavoja, djali më i madh i familjes Soares, e kujton natën kur ishte djalosh e kur ai nuk iu bind prindërve të tij dhe doli pa leje për të parë një kremtim vjetor në lagjen e tyre në San-Paolo, të njohur si Festa Junina [Festa e Qershorit].

“Isha në mes të një turme të madhe duke u zbatimur kur dëgjova një njoftues që më thirri të dilja përpara”, thotë ai. “Pikërisht atëherë pashë babin.”

Prindërit e tij ishin shqetësuar së tepërmi, por në vend që ta qortonte Gustavon, Ulisesi e përqafoi fort.

“Patëm një bashkëbisedim me seriozitet mbi faktin që humba, por prindërit e mi më trajtuan me respekt”, kujton Gustavoja. “U ndjeva i mbrojtur dhe e dija se ata më donin me të vërtetë.”

Ulisesi është i përkushtuar ndaj familjes së tij. Me gjithë programin e tij të ngarkuar të punës dhe udhëtimeve gjatë viteve, ai ka lënë kohë për të ndërtuar marrëdhënie me fëmijët e tij.

Kur Plaku Soares u mbështet në Kuorumin e Dymbëdhjetë Apostujve më 31 mars 2018, ndoshta askush nuk ishte më i çuditur sesa Gustavoja dhe dy motrat e tij, Leticia Karavelo dhe Natalia Soares Avila. Por nëse dashuria, puna e palodhur, dhembshuria për të tjerët dhe përulesia e kualifikojnë një njeri për apostullimin, thonë ata, mund ta kuptojnë se përse Zoti e thirri babanë e tyre.

“Kur Jezusi i thirri Apostujt e Tij, Ai nuk zgjodhi farisenjtë më të ditur, Ai zgjodhi peshkatarë”, thotë Leticia. “Babai dhe nëna ime janë të tillë. Ata i mirëbesojnë plotësisht Zotit dhe Ai i përdor ata për t'i përmbushur punët e Tij sepse Ai e di që ata janë bujarë, të gatshëm të punojnë pa u lodhur dhe mjaftueshëm të përuar sa ta pranojnë korrigjimin.”



“Zemra e madhe” e babait të tyre do ta ndihmojë atë teksa shkon përpara si një nga dëshmitarët e veçantë të Shpëtimtarit, shton Natalia. “Ai është mjaft i dhembshur sa ta bëjë atë”, thotë ajo. “Ai ndien ndikimin e qiellit dhe ai e do gjithkënd e dëshiron të bëjë atë që është e drejtë.”

“Gjithçka do të Shkojë Mirë”

Kur Plaku Soares shërbeu si president i Misionit të Portugalisë në Porto nga viti 2000 deri në 2003, ai u bë i mirënjohur për përdorimin e frazës në portugalisht “Tudo vai dar certo” – gjithçka do të shkojë mirë.

“Ai na e mësoi neve atë”, kujton Taj Benet, një nga misionarët e tij. “Ai e jeton jetën me besim dhe optimizëm që, nëse bëjmë atë që Zoti dëshiron që ne të bëjmë, gjithçka do të shkojë mirë.”

Ai gjithashtu u dha mësim misionarëve të tij që të mos t’i përdorin fjalët *e vështirë* ose *e pamundur*, thotë Riçard Shilds, një tjetër prej misionarëve të tij. “Ne u referohemi gjërave si ‘sfida’. Ajo këshillë më ka ndihmuar t’i jap formë jetës sime teksa i kam parë gjërat si ‘sfida’ për t’u kapërcyer dhe jo si ‘të vështira’ ose ‘të pamundura’.”

Një besim dhe optimizëm i tillë nuk ka ardhur nga një jetë e lehtë. Plaku dhe Motra Soares e njohin mirë zhgënjimin që vjen nga të jetuarit me mungesa, lodhja e ditëve të gjata me punë dhe studim, sfidat e shëndetit të lig dhe pikëllimin nga dështimi i shtatzënisë, lindja e fëmijës së vdekur dhe humbja e motrave e vëllezërve si dhe e prindërve.

Por përgjatë udhëtimit të jetës, ata e kanë vendosur besimin e tyre te fjalët e shkrimit të shenjtë të parapëlqyer të Plakut Soares: “Ji i përlurur; dhe Zoti, Perëndia yt, do të të udhëheqë përdore dhe do t’u japë përgjigje lutjeve të tua”⁴.

“Sfidat janë pjesë e përparimit tonë”, thotë Plaku Soares. “Por kur kemi durim në vuajtje, kur mësojmë t’u mbijetojmë

sfidave të jetës, kur qëndrojmë besnikë, Zoti na vlerëson shumë dhe na bekon me bekimet që Ai ka premtuar.”

Dhe kur mbahemi fort te shufra e hekurt, shton ai, Zoti nuk do të na lërë vetëm.

“Vazhdueshmëria e mbajtjes fort tek urdhërimet, tek ungjilli, te shkrimet e shenjta dhe te Zoti Jezu Krisht na ndihmon t’i kapërcejmë sfidat e jetës”, dëshmon Plaku Soares. “Kur gjunjëzohemi në lutje, Ai do të jetë me ne dhe do të na udhërrëfjë. Ai do të na frymëzojë se ku të shkojmë dhe çfarë të bëjmë. Kur jemi të bindur dhe e përuhim veten, Zoti u përgjigjet lutjeve tona.”

Dishepull i Përkushtuar

Ulises Soaresi është një burrë me aftësi dhe përgatitje. Arsimiti i tij, përfshirë një diplomë pasuniversitare për administrim biznesi, e përgatiti atë që të punonte si financiar dhe kontrollor financiar për korporata ndërkombëtare në Brazil. Ajo përvojë e përgatiti që të punonte në sektorin financiar të Kishës, punë që e përgatiti atë që në moshën 31-vjeçare të bëhej një nga drejtorët më të rinj në moshë të Kishës për çështjet materiale. Ajo përgatitje i shërbeu mirë atij si president misioni dhe në thirrjen e tij si Autoritet i Përgjithshëm I Shtatëdhjetë më 2 prill 2005.

Përpara se të thirrej në Presidencën e Të Shtatëdhjetëve më 6 janar 2013, Plaku Soares shërbeu si këshilltar dhe më pas si President i Presidencës së Zonës të Brazilit dhe si këshilltar në Zonën e Afrikës Juglindore. Atje, ai shërbeu si këshilltar për



Plakun Dejll G. Renland, atëherë Autoritet i Përgjithshëm i Shtatëdhjetë. Plaku Renland, tani anëtar i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, e kujton me kënaqësi kohën e tyre së bashku.

“Plaku Soares është një dishepull plot gaz, i zotuar dhe i përkushtuar i Jezu Krishtit”, thotë Plaku Renland. “Nuk njoh ndonjë që ta ndiejë më me mprehtësi që ai është në punën e Zotit. Nëse i kërkohet të bëjë diçka, ai e bën atë me të gjithë fuqinë e tij.”

Ai tha se Plaku Soares shpejt “ra në dashuri” me shenjtorët në Afrikë. Një nga detyrat e tij të para në zonë ishte që të kryesonte një konfe-

Qoftë mes shenjtorëve të Perusë (majtas), Ganës (poshtë), ose kombeve të tjera ku ka shërbyer dhe ka dhënë shërbesë, Plaku Soares “me lehtësi i do njerëzit”, thotë Plaku Klaudio R. M. Kosta.



rencë kunji në Kananga në Republikën Demokratike të Kongos. “Kur u kthye, ai nuk mund të pushonte së foluri mbi mirësinë dhe përkushtimin e njerëzve që takoi”, thotë Plaku Renland.

Plaku L. Uitni Klejton, që shërbeu me Plakun Soares për pesë vjet e gjysmë në Presidencën e Të Shtatëdhjetëve, e quan Plakun Soares një ndërtues marrëveshjes. “Ai dëgjon dhe i mat mendimet e tij. Ai është i kujdesshëm në mënyrën se si sillet në mbledhje që zërat tanë të formojnë një kor dhe jo një konkurrim solistësh.”

Plaku Soares tregon thjeshtësi për aftësinë e tij që të komunikojë në portugalisht, anglisht,

Me gjithë programin e tij të ngarkuar të punës dhe udhëtimeve gjatë viteve, Plaku Soares gjithmonë i ka vënë të parët në jetën e tij bashkëshorten, fëmijët dhe nipërit e mbesat e tij (majtas poshtë). Ai gjithashtu ka gjetur kohë, bashkë me bashkëshorten e tij, që të bëhet një kuzhinier i zoti (majtas larg).

spanjisht dhe frëngjisht. Por ajo dhunti, që kërkon vëmendje të vazhdueshme, është një bekim për Kishën, thotë Plaku Klejton. Plaku Soares mund t’u flasë pjesës më të madhe të anëtarëve të Kishës në vetë gjuhën e tyre.

“Ulisesi ka qenë udhëheqës që kur ishte djalosh”, vëren Plaku Klaudio Kosta për bashkëshortin e tij. “Ai është shumë inteligjent e shumë i aftë dhe e ndien përgjegjësinë që të japë gjithmonë më të mirën e tij. Ai i do me lehtësi njerëzit rreth tij. Ai ka zemrën e një dishepulli të vërtetë të Shpëtimtarit dhe ka dëshminë e sigurt se Jezusi është Krishti. Unë e dua atë dhe jam mirënjohës që e mbështet si një Apostull të Zotit.”


Dhe Plaku Dejvid A. Bednar, duke folur për Kuorumin e Dymbëdhjetë Apostujve, shton: “Plaku Soares është një dishepull i dëlirë, pa mashtrim dhe i pafajshëm i Shpëtimtarit. Njëpërmjet dritës në pamjen e tij, buzëqeshjes së tij të ngrohtë dhe mënyrës së tij të hirshme, individë dhe familje të panumërta kanë qenë frymëzuar, frymëzohen dhe do të frymëzohen me një dëshirë më të madhe për ta ndjekur Shpëtimtarin dhe për të jetuar normat e ungjillit të Tij.”

Në periudhën tonë ungjillore, Zoti tha për Eduard Partrixhin: “Zemra e tij është e pastër para meje, sepse ai është si Natanaeli i lashtësisë, në të cilin s’ka mashtrim”⁵. Për Hajrëm Smithin, Zoti tha: “Unë, Zoti, e dua atë për shkak të integritetit të zemrës së tij dhe ngaqë ai e do atë që është e drejtë përpara meje”⁶.

Për Ulises Soaresin, Zoti do të thoshte të njëjtën gjë. ■

SHËNIME

1. Gjoni 1:47.
2. Shih James E. Talmage, *Jesus the Christ* (1916), f. 217–218, 222.
3. “Profetët Flasin nëpërmjet Fuqisë së Shpirtit të Shenjtë”, *Liahona*, maj 2018, f. 98.
4. Doktrina e Besëlidhje 112:10.
5. Doktrina e Besëlidhje 41:11.
6. Doktrina e Besëlidhje 124:15.



Ajo që

Çdo Peshkop

Dëshiron që t'i Dinë
Anëtarët e Lagjes së Tij

*Ja tek janë tetë të vërteta që
mësova gjatë shërbimit
tim si peshkop.*

Nga Majkëll Majërs

Pata mundësinë e mrekullueshme që të shërbeja si peshkop. Gjatë atyre viteve, mora më shumë mësimë nga sa mund të numërohen. Por mësova tetë të vërteta që besoj se janë të përbotshme. Ndërkohë që kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse, ajo është orvatja ime për të treguar atë që çdo peshkop shpreson që lagjja e tij t'i dijë.

1. Peshkopi e do çdo anëtar të lagjes së tij me të vërtetë.


Dashuria që peshkopi ka për lagjen e tij është e lidhur me dashurinë që Ati Qjellor dhe Jezu Krishti kanë për secilin prej nesh. Kur një peshkop e hedh vështrimin tek anëtarët e tij në një mbledhje sakramenti, mbi të vjen dhembshuria dhe mirëkuptimi në një mënyrë të pangjashme me ndonjë gjë që ai ka përjetuar. Kur një peshkop ngrihet dhe shpreh sa shumë i do anëtarët e lagjes së tij, ndjenjat e tij janë nga zemra dhe të vërteta. Dijeni se peshkopi ju do, shqetësohet për ju dhe interesohet për ju më shumë nga sa e dini.



2. Peshkopi mbështetet fizikisht, emocionalisht dhe shpirtërisht nga besimi dhe lutjet e anëtarëve.

Një peshkop shpenzon orë të panumërta duke shërbyer. Ai shpesh do të shpenzojë shumë orë në kishë të dielën dhe net të tjera pas pune duke biseduar, duke i intervistuar dhe duke u kujdesur për anëtarët e lagjes së tij.


Peshkopi është në gjendje ta bëjë këtë javë pas javë për shkak të besimit dhe lutjeve të anëtarëve të lagjes. Si peshkop i sapothirrur, më rridhnin lot padashur sa herë që e dëgjoja një anëtar/e të lutej që “të bekohej peshkopi”. Lutjet tuaja me besim marrin vërtet përgjigje dhe peshkopi e merr dhe e ndien ndikimin mbështetës të atyre lutjeve. Zoti u përgjigjet atyre lutjeve të mbushura me besim mbi kokat e peshkopëve të Kishës.



3. Peshkopi shpesh ndihet jashtëzakonisht i papërshtatshëm për thirrjen (edhe pas tre apo katër vjetëve).

Kam njohur shumë pak peshkopë që ndienin se ishin vërtet “të përgatitur” për thirrjen. Sidoqoftë, unë njëmend e di se “atë që Zoti e thërret, atë Zoti e kualifikon”¹. Ndërkohë që një peshkop e di se po kualifikohet, ai gjithashtu lufton me ndjenjën se nuk do ta bëjë kurrë thirrjen mirë.

Ai do të bëjë më të mirën për të dhënë këshilla të urta kur nevojitet, për të mos i fyer njerëzit dhe për të qenë në harmoni me Shpirtin, por nganjëherë ai ende do ta vrasë mendjen a po e përmbush thirrjen e tij në një mënyrë të pranueshme.



4. Shpirti i Perëndisë mund të veprojë nëpërmjet peshkopit kur ai po këshillohet me anëtarët e lagjes.

Kur më pyetën se për çfarë më merr më shumë malli nga shërbimi si peshkop, u them njerëzve se më merr malli për ndikimin e fortë të Shpirtit që e shoqëron mantelin e një peshkopi. Qoftë nëse po ngushëllon ata që kanë humbur njerëz të dashur, po flet me ata/ato që mundohen nga bashkëshortë/e jobesnikë/e ose u bën thirrje njerëzve për pendim, Shpirti që është në dispozicion të një peshkopi besnik është Shpirti i Perëndisë dhe shpirti i zbulësës.

Kohët e fundit pata një ish-anëtare të lagjes që më kërkoi ndihmë për trajtimin e disa problemeve vetjake. Ajo kishte lëvizur në një lagje të re dhe nuk ishte e sigurt a donte të shkonte te peshkopi i saj i ri për udhërrëfim. I tregova asaj atë që kam treguar shumë herë që prej lirimimit nga thirrja, që ishte se ndërkohë që unë isha i lumtur t'i vija në ndihmë, nuk i kisha më çelësat që mban një peshkop dhe se ata çelësa mund të ishin vendimtarë për dhënien e përkrahjes që i nevojitej asaj. I sugjerova që të fliste me peshkopin e vet. Bisedova me të dy javë më vonë dhe më tha se ishte takuar me peshkopin dhe kishte qenë sikur ai ta dinte që përpara cilat ishin problemet e saj dhe mënyrën se si ta ndihmonte më së miri. Ndërkohë që peshkopi është me siguri i gabueshëm, Zoti e frymëzon, e udhërrëfen dhe ua bekon jetën të tjerëve nëpërmjet fjalëve të tij.



5. Peshkopi është njeri; ndonjëherë bën gabime dhe ndonjëherë i bën gjërat në mënyrë të gabuar.

Në fund të fundit, peshkopët janë burra të vdekshëm. Ata kanë papërsosuri, dobësi, paragjykime dhe problemet e tyre vetjake. Shpirti e kualifikon njeriun që mban detyrën e peshkopit, por peshkopi është prapëseprapë njeri që u nënshtrohet të njëjtave probleme e dobësi me të cilat përballemi të gjithë.

Ky përfundim nuk duhet të na e ulë nderimin që shfaqim ndaj thirrjes së tij ose të na bëjë që të mos ua vëmë veshin këshillave të tij. Një peshkop është në dijeni të plotë për dobësitë e tij dhe mundohet t'i mposhtë ose së paku t'i mbajë jashtë shërbimit të tij si peshkop. Sado fort të përpiqet, ai gjithnjë do të jetë i papërsosur.

6. Peshkopi ndien se nuk mund t'i takojë kurrë anëtarët e lagjes aq sa duhet ose të bëjë mirë sa duhet.

Çdo ditë një peshkop pyet veten se kë tjetër mund ose duhej të kishte ndihmuar atë ditë. Do të më kishte pëlqyer të bisedoja rregullisht me çdo anëtar, por kisha një punë me kohë të plotë, familjen time, programin e rinisë dhe disa anëtarë të caktuar të lagjes me nevoja të mëdha. Thjesht nuk kishte kohë të mjaftueshme për t'u takuar rregullisht me çdo anëtar.

Megjithatë, kur isha peshkop, Shpirti ndonjëherë më nxiste t'i shkoja për vizitë një anëtar të caktuar që kishte vështirësi. Shumë herë, ato vizita fillonin me ata që thoshin: "E dija se do të vije". Shpirti që ndienim që shpesh trondites kur të dy e kuptonim se vizita ishte prova që Perëndia u përgjigjet lutjeve.

Më gëzonte gjithnjë edhe pritja që merrja në dyert e atyre anëtarëve që ishin aktivë "pa vështirësi". Këta njerëz të mirë shkojnë në kishë çdo javë, shërbejnë me besnikëri në thirrje, nuk kanë asnjë sfidë të jashtëzakonshme nga të tjerët dhe përgjithësisht nuk vizitohen rregullisht nga udhëheqësit e priftërisë. Ata qenë mirënjohës që mund të kalonin pak kohë vetëm për vetëm me peshkopin e tyre. Më lejoni që t'ju them të gjithëve ju: "Faleminderit! Vazhdoni kështu! Dijeni se peshkopi ju do dhe do t'ju vinte më shpesh për vizitë po të mundej."

7. Peshkopi juaj vërtet, njëmend, e sinqerisht ka nevojë që ju t'i jepni shërbesë njëri-tjetrit.

Si peshkop, sa herë që më thoshin se një anëtar i lagjes kishte vësh-tirësi, unë e kisha zakon të pyesja: “Kush janë mësuesit e shtëpisë dhe mësueset vizitore?” Kjo ishte një mënyrë për ta vlerësuar që nevojat e anëtarit/es do të plotësoheshin edhe në periudhë afatshkurtër, edhe në atë afatgjatë. Peshkopi që vepron pa ndihmë nga anëtarët e tjerë të lagjes dhe kunjtit, i ka të kufizuara burimet. Ai me siguri që mundet – dhe do t'u – shkojë për vizitë njerëzve në krizë. Por nëse ka në dispozicion burimet e priftërisë dhe të Shoqatës së Ndhimës, shtrirja e tij mund të zgjerohet.

Ky është qëllimi i dhënies së shërbesës. Ka raste kur disa prej nesh harrojmë pse i japim shërbesë njëri-tjetrit: Zoti na ka urdhëruar që ta “d[uam] njëri-tjetrin” (Gjoni 13:34). Dijeni se peshkopi juaj e përdor dhënien e shërbesës si një mënyrë e frymëzuar për të qenë “më i pranishëm” në jetën e anëtarëve të lagjes.



8. Peshkopi uron të mund të bënte gjithçka për vathën e tij.


Në çdo kohë, ditë apo natë, qoftë një bekim priftërie, këshillim me një fëmijë të pabindur ose ngut për në një vendngjarje ku ka ndodhur një aksident, atij do t'i pëlqente të bënte çfarëdo gjëje që i nevojitet një anëtar/eje. Ai nuk mund të bëjë përherë gjithçka dhe mund të mos jetë personi i duhur në çdo situatë, por mos kini frikë që të kërkoni ndihmë kur ju nevojitet. Dijeni se peshkopi ju gjendet pranë për të shërbyer në ato raste dhe se të dy bekoheni së tepërmi ngaqë punoni së bashku.

Përulëm nga mundësia e shenjtë që pata për të shërbyer në këtë thirrje të shenjtë. Në shërbimin tim, kalova nga besimi te njohuria. Unë nuk e besoj më që ungjilli është i vërtetë; unë e di se ai është i vërtetë. Nuk e besoj më që Perëndia më njeh; e di se Perëndia është pafundësisht i vetëdijshëm për secilin prej nesh, për jetën tonë të përditshme dhe luftërat tona vetjake. Për më tepër, unë e di se Ai punon nëpërmjet shërbëtorëve të Tij, veçanërisht nëpërmjet atyre që mbajnë çelësat e priftërisë. E di se nuk do të mund të kisha shërbyer si peshkop pa ndërgjegjshmërinë e Perëndisë për këtë punë. Është vërtetësia e ungjillit dhe dashuria e Perëndisë për fëmijët e Tij që ia krijojnë mundësinë çdo peshkopi që të shërbejë. ■

Autori jeton në Jutë të SHBA-së.

SHËNIM

1. Thomas S. Monson, “Duty Calls”, *Ensign*, maj 1996, f. 44.







KAPITULLI 8

Ngritja e Kishës së Krishtit

Ky është kapitulli 8 i historisë së re të Kishës me tregime në katër vëllime të titulluar Shenjtorët: Historia e Kishës së Jezu Krishtit në Ditët e Mëvonshme. Libri është në dispozicion në 14 gjuhë, i shtypur, në pjesën Historia e Kishës të programit kompjuterik Gospel Library [Biblioteka e Ungjillit] dhe në internet te shenjtorë.lds.org. Kapitujt e mëparshëm u botuan në numrat e kaluar dhe janë në dispozicion në 47 gjuhë në programin kompjuterik Gospel Library [Biblioteka e Ungjillit] dhe te shenjtorë.lds.org.

Nga fillimi i korrikut 1829, me dorëshkrimin në dorë, Jozefi e dinte se Zoti dëshironte që ai ta botonte Librin e Mormonit dhe ta përhapte anekënd mesazhin e tij. Por ai dhe familja e tij nuk e njihnin biznesin e botimit. Ai duhej ta mbante të sigurt dorëshkrimin, të gjente një shtypshkronjë dhe ta shpërndante librin në njëfarë mënyre në duart e njerëzve të gatshëm që ta merrnin parasysht mundësinë e një shkrimi të ri të shenjtë.

Botimi i një libri aq të madh sa Libri i Mormonit gjithashtu nuk do të ishte i lirë në kosto. Gjendja financiare e Jozefit nuk ishte përmirësuar që kur ai e nisi përkthimin dhe të gjitha paratë që fitonte, shkonin për të mbajtur familjen e tij. E njëjta gjë ishte e vërtetë për prindërit e tij, të cilët ishin ende fermerë të varfër që punonin toka të cilat nuk i zotëronin. I vetmi mik i Jozefit që mund ta financonte projektin, ishte Martin Harris.

Jozefi iu fut punës me shpejtësi. Përpara se ta përfundonte përkthimin, ai kishte bërë kërkesë për të drejtën e autorit të librit për ta mbrojtur tekstin nga cilido që mund ta vidhte ose t'i bënte plagjiaturë.¹ Me ndihmën e Martinit, Jozefi filloi gjithashtu të kërkonte një tipograf, i cili do të binte dakord ta botonte librin.

Ata shkuan së pari tek Egbert Grandini, një tipograf në Palmira që kishte të njëjtën moshë me Jozefin. Grandini nuk e pranoi menjëherë propozimin, duke besuar se libri ishte një mashtrim. Të palëkundur, Jozefi dhe Martini vazhduan të kërkonin dhe gjetën një tipograf të gatshëm në një qytet aty pranë. Por, përpara se ta pranonin ofertën e tij, ata u kthyen në Palmira dhe e pyetën edhe një herë Grandinin a dëshironte ta botonte librin.²

Këtë herë, Grandini u duk më i gatshëm ta merrte përsipër projektin, por ai donte t'i paguheshin 3 000 dollarë për të shtypur dhe lidhur pesë mijë kopje, madje përpara se ta fillonte punën. Martini kishte premtuar tashmë që të ndihmonte për shtypjen por, që ta siguronte atë sasi të madhe parash, ai e kuptoi se mund t'i duhej ta hipotekonte fermën e tij. Kjo ishte një barrë e stërmadhe për Martinin, por ai e dinte se asnjë nga miqtë e tjerë të Jozefit nuk mund ta ndihmonte atë për paratë.

I shqetësuar, Martini filloi ta vinte në dyshim urtësinë e financimit të Librit të Mormonit. Ai kishte një nga feramat më të mira në zonë. Nëse do ta hipotekonte tokën e vet, ai kishte rrezik ta humbiste. Pasurinë, për të cilën kishte shpenzuar gjithë jetën që ta grumbullonte, mund ta humbte brenda një çasti nëse nuk do të siguroheshin mjaft të ardhura nga shitja e Librit të Mormonit.

Martini ia tregoi Jozefit shqetësimet e tij dhe iu lut të kërkonte një zbulësë për të. Si përgjigje, Shpëtimtari foli për sakrificën e Tij që të bënte vullnetin e Atit të Tij, pavarësisht nga kostoja. Ai përshkroi vuajtjen e Tij më të lartë ndërsa paguante çmimin për mëkatin, me qëllim që të gjithë të mund të pendohen dhe të marrin falje. Ai më pas e urdhëroi Martinin që t'i sakrifikoje vetë interesat e tij për t'u realizuar plani i Perëndisë.

"Ti s'duhet të lakmosh pronën tënde", tha Zoti, "por ta japësh atë lirisht për shtypjen e Librit të Mormonit." Libri përmbante fjalën e vërtetë të Perëndisë, e siguroi Zoti Martinin, dhe ai do t'i ndihmonte të tjerët ta besonin ungjillin.³

Edhe pse fqinjët nuk do t'ia kuptonin vendimin, Martini iu bind Zotit dhe e hipotekoi fermën e tij që të garantonte pagimin.⁴

Grandini nënshkroi një kontratë dhe filloi ta organizonte projektin e madh.⁵ Jozefi e kishte përkthyer tekstin e Librit të Mormonit brenda tre muajve, i ndihmuar vetëm nga një shkruar për çdo herë. Grandinit dhe një duzine burrash do t'u duheshin shtatë muaj që t'i shtypnin dhe t'i lidhnin kopjet e para të veprës 590-faqëshe.⁶

Pasi e pajtoi tipografin, Jozefi u kthye në Harmoni në tetor 1829 që të punonte në fermën e tij dhe të qëndronte

me Emën. Ndërkohë, Oliveri, Martini dhe Hajrëmi do ta mbikëqyrnin shtypjen dhe do ta mbanin rregullisht në dijeni Jozefin mbi përparimin e Grandinit.⁷

Duke sjellë ndër mend dëshpërimin që kishte ndier pasi i humbi faqet e para që përktheu, Jozefi i kërkoi Oliverit që ta kopjonte faqe për faqe dorëshkrimin e Librit të Mormonit, duke përgatitur një kopje të njëjtë për t'ia çuar tipografit që të mund të shtoheshin shenjat e pikësimit dhe të përgatitej boca.⁸

Oliveri u kënaq ndërsa kopjonte librin dhe letrat që i shkroi në atë kohë, ishin të mbushura me fjalë nga përkthimi. Duke i bërë jehonë Nefit, Jakobit dhe Amulekut nga Libri i Mormonit, Oliveri i shkroi Jozefit mbi mirënjohjen e tij për Shlyerjen e pafundme të Krishtit.

"Kur filloj të shkruaj për mëshirat e Perëndisë", i tha ai Jozefit, "nuk di se kur të ndalem, por koha dhe letra nuk mjaftojnë."⁹

Po i njëjti shpirt tërhoqi njerëz të tjerë te Libri i Mormonit teksa ai po shtypej. Tomas Marshi, një ish-stazhier tipograf, ishte përpjekur ta gjente vendin e tij në kisha të tjera, por asnjë prej tyre nuk dukej se predikonte ungjillin që ai e gjente në Bibël. Ai besonte se një kishë e re do të ngrihej së shpejti, e cila do të jepte mësim të vërtetë të rivendosur.

Atë verë, Tomasi u ndje i udhëhequr nga Shpirti që të udhëtonte qindra kilometra që nga shtëpia e tij në Boston deri në Nju-Jorkun perëndimor. Ai qëndroi në atë zonë për tre muaj përpara se të kthehej për në shtëpi, i pasigurt për arsyen pse kishte udhëtuar aq larg. Mirëpo, në një ndalesë përgjatë udhës së kthimit, bujtinarja e tij e pyeti a kishte dëgjuar për "librin e artë" të Jozef Smithit. Tomasi i tha gruas se nuk kishte dëgjuar dhe ndjeu detyrim të mësonte më shumë.

Ajo i tha se duhej të fliste me Martin Harrisin dhe e drejtoi për në Palmirë. Tomasi shkoi menjëherë atje dhe e gjeti Martinin te shtypshkronja e Grandinit. Tipografi i dha gjashtëmbëdhjetë faqe nga Libri i Mormonit dhe Tomasi i mori ato në Boston, i etur për t'ia dhënë shijen e parë të këtij besimi të ri bashkëshortes së tij, Elizabetës.

Elizabeta i lexoi faqet dhe ajo gjithashtu besoi se ato ishin vepra e Perëndisë.¹⁰

Atë vjeshtë, teksa tipografët bënë përparim të vazhdueshëm për Librin e Mormonit, një ish-gjykatës, i quajtur Ebnër Koul, filloi të botonte një gazetë në shtypshkronjën e Grandinit. Duke punuar natën në punishte, pasi personeli i Grandinit kishte shkuar në shtëpi, Ebnëri mund t'i shihte faqet e shtypura nga Libri i Mormonit, të cilat nuk ishin lidhur ende apo nuk ishin gati për shitje.

Ebnëri shpejt filloi të tallej me “Biblën e Artë” në gazetën e tij dhe, gjatë dimrit, ai botoi fragmente nga libri bashkë me komente plot sarkazëm.¹¹

Kur Hajrëmi dhe Oliveri e mësuan se çfarë po bënte Ebnëri, ata u përballën me të. “Çfarë të drejte keni ju që ta shtypni Librin e Mormonit në këtë mënyrë?” e pyeti Hajrëmi. “A nuk e dini se ne e kemi marrë të drejtën e autorit?”

“Nuk është aspak puna juaj”, tha Ebnëri. “E kam marrë me qira shtypshkronjën dhe do të shtyp çfarë të më pëlqejë.”

“Unë ju ndaloj të shtypni më nga ai libër në gazetën tuaj”, tha Hajrëmi.

“Nuk më bëhet vonë”, tha Ebnëri.

Të pasigurt rreth asaj që duhet të bënin, Hajrëmi dhe Oliveri i dërguan lajm Jozefit në Harmoni, i cili u kthye menjëherë në Palmirë. Ai e gjeti Ebnërin në shtypshkronjë, duke lexuar herë pas here gazetën e vet.

“Dukeni shumë i zënë me punë”, tha Jozefi.

“Ç’kemi z. Smith?” iu përgjigj Ebnëri me ironi.

“Z. Koul”, tha Jozefi, “Libri i Mormonit dhe të drejtat e botimit të tij më përkasin mua dhe unë ju ndaloj që të përziheni me të.”

Ebnëri e hoqi me vull pallton dhe përveshi mëngët. “A dëshiron të ndeshesh, zotëri?” ulëriu ai, duke i goditur grushtet e tij njëri me tjetrin. “Nëse do të ndeshesh, vetëm eja.”

Jozefi buzëqeshi. “Më mirë ta kishit mbajtur veshur pallton”, tha ai. “Është ftohtë dhe unë nuk do të ndeshem me ju.” Ai vazhdoi qetësisht: “Por ju duhet ta ndaloni shtypjen e librit tim”.

“Nëse mendon se je më i zoti”, tha Ebnëri, “thjesht hiqe pallton dhe provoje atë gjë.”

“Ka ligj”, u përgjigj Jozefi, “dhe ju do ta mësoni atë nëse nuk e dini më parë. Por nuk do të ndeshem me ju, sepse kjo nuk do të sjellë ndonjë të mirë.”

Ebnëri e dinte se po e shkelte ligjin. Ai u qetësua dhe e ndaloi shtypjen e fragmenteve nga Libri i Mormonit në gazetën e tij.¹²

Salomon Çambërleni, një predikues që po udhëtonte drejt Kanadasë, dëgjoi së pari për “Biblën e Artë” nga një familje ku po qëndronte, pranë Palmirës. Ashtu si Tomas Marshi, ai kishte shkuar nga kisha në kishë gjatë gjithë jetës së tij, por ishte ndier i pakënaqur nga ajo që kishte parë. Disa kisha predikonin parime të ungjillit dhe besonin te dhurata shpirtërore, por nuk kishin profetë të Perëndisë apo priftërinë e Tij. Salomoni e ndiente se po vinte koha kur Zoti do ta sillte kishën e Tij.

Teksa Salomoni po i dëgjonte pjesëtarët e familjes të flisnin për Jozef Smithin dhe fletët e arta, u ndje i elektrizuar nga koka te këmbët dhe vendosi ta gjente familjen Smith e të mësonte më shumë për librin.

Ai u nis për në shtëpinë e Smithëve dhe e takoi Hajrëmin te dera. “Paqja qoftë në këtë shtëpi”, tha Salomoni.

“Shpresoj që do të ketë paqe”, u përgjigj Hajrëmi.

“A ka ndonjë njeri këtu”, pyeti Salomoni, “që beson te vegimet ose zbulesat?”

“Po”, tha Hajrëmi, “të gjithë në këtë shtëpi besojnë te vegimet.”

Salomoni i tregoi Hajrëmit për një vegim që e kishte parë vite më parë. Në të, një engjëll kishte thënë se Perëndia nuk kishte kishë në tokë, por së shpejti do ta ngrinte një të tillë që do të kishte fuqi ashtu si kisha e apostujve në lashtësi. Hajrëmi dhe njerëzit e tjerë në shtëpi e kuptuan se çfarë tha Salomoni dhe i thanë se kishin të njëjtin besim.

“Dëshiroj që të m’i bësh të ditura disa nga zbulimet e tua”, tha Salomoni. “Mendoj se mund t’i pranoj ato.”

Hajrëmi e ftoi të qëndronte në fermën e familjes Smith si mysafir dhe ia tregoi dorëshkrimin e Librit të Mormonit. Salomoni e studioi atë për dy ditë dhe shkoi bashkë me Hajrëmin në shtypshkronjën e Grandinit, ku një tipograf i dha gjashtëdhjetë e katër faqe të shtypura. Me faqet e palidhura në dorë, Salomoni vazhdoi udhën për në Kanada, duke predikuar përgjatë rrugës gjithçka dinte për besimin e ri.¹³

Deri më 26 mars 1830, kopjet e para të Librit të Mormonit ishin lidhur dhe ishin gati për shitje në katin përdhes të shtypshkronjës së Grandinit. Ato ishin lidhur fort me kapakë lëkure viçi bojëkafë dhe kishin aromë lëkure e zamke,

letre dhe boje. Fjalët *Libri i Mormonit* shfaqeshin në shpinat e librave me germa të arta.¹⁴

Lusi Smithi e mbajti si thesar shkrimin e ri të shenjtë dhe e pa atë si shenjë që Perëndia do t'i mblidhte së shpejti fëmijët e Tij dhe do ta rivendoste besëlidhjen e Tij të lashtë. Faqja e titullit shpallte se qëllimi i librit ishte që të tregonte gjërat e mëdha që Perëndia i kishte bërë për popullin e Tij në të shkuarën, që t'ia shtrinte të njëjtat bekime popullit të Tij në të sotmen dhe ta bindte të gjithë botën se Jezu Krishti ishte Shpëtimtari i botës.¹⁵

Në pjesën e pasme të librit ishin dëshmitë e Tre Dëshmitarëve dhe të Tetë Dëshmitarëve që i tregonin botës se ata i kishin parë fletët dhe e dinin se përkthimi ishte i vërtetë.¹⁶

Megjithë këto dëshmi, Lusi e dinte se disa njerëz mendonin që libri ishte trillim. Shumë prej fqinjëve të saj besonin se Bibla ishte shkrim i shenjtë i mjaftueshëm për ta, pa e kuptuar se Perëndia kishte bekuar më shumë se një komb me fjalën e Tij. Ajo e dinte gjithashtu se disa njerëz nuk e pranuan mesazhin e tij, sepse besonin që Perëndia i kishte folur dikur botës dhe nuk do të fliste më.

Për këto arsye dhe të tjera, shumica e njerëzve në Palmirë nuk e blenë librin.¹⁷

Por disa njerëz i studiuuan faqet e tij, e ndien fuqinë e mësimëve të tij dhe ranë në gjunjë [në lutje] për ta pyetur Zotin nëse ishte i vërtetë. Lusi vetë e dinte që Libri i Mormonit ishte fjala e Perëndisë dhe dëshironte t'ua shpërndante atë të tjerëve.¹⁸

Pothuajse menjëherë pasi u botua Libri i Mormonit, Jozefi dhe Oliveri u përgatitën për ta organizuar kishën e Jezu Krishtit. Disa muaj më parë, apostujt e Zotit në lashtësi, Pjetri, Jakobi dhe Gjoni iu ishin shfaqur atyre dhe iu kishin dhënë Priftërinë Melkizedeke, ashtu siç kishte premtuar Gjon Pagëzori. Ky autoritet shtesë i lejoi Jozefin dhe Oliverin t'ua jepnin dhuratën e Frymës së Shenjtë atyre që pagëzonin. Pjetri, Jakobi dhe Gjoni i kishin shurguruar ata edhe për të qenë apostujt të Jezu Krishtit.¹⁹

Rreth asaj kohe, teksa qëndronin në shtëpinë e familjes Uitmer, Jozefi dhe Oliveri ishin lutur për më shumë njohuri rreth këtij autoriteti. Si përgjigje, zëri i Zotit i urdhëroi që

ta shuguronin njëri-tjetrin si pleq në kishë, por jo derisa besimtarët ta jepnin miratimin për t'i ndjekur ata si udhëheqës në kishën e Shpëtimtarit. Atyre iu tha gjithashtu që të shuguronin drejtues të tjerë të kishës dhe t'ua jepnin dhuratën e Frymës së Shenjtë atyre që ishin pagëzuar.²⁰

Më 6 prill 1830, Jozefi dhe Oliveri u takuan në shtëpinë e familjes Uitmer për të zbatuar urdhërimin e Zotit dhe për ta organizuar kishën e Tij. Për t'i përmbushur kërkesat e ligjit, ata zgjodhën gjashtë njerëz që të ishin anëtarët e parë të kishës së re. Rreth dyzet gra e burra u grumbulluan gjithashtu brenda dhe përreth shtëpisë së vogël për ta dëshmuar ngjarjen.²¹

Në bindje ndaj udhëzimeve më të hershme të Zotit,

Jozefi dhe Oliveri iu kërkuan pjesëmarrësve t'i mbështetnin ata si udhëheqës në mbretërinë e Perëndisë dhe të tregonin nëse besonin se ishte e drejtë për ta që të organizoheshin si kishë. Secili anëtar i bashkësisë dha pëlqimin dhe Jozefi i vuri duart mbi kokën e Oliverit dhe e shuguroi atë një plak në kishë. Pastaj ata këmbyen vendet dhe Oliveri e shuguroi Jozefin.

Më pas, ata administruan bukën dhe verën e sakramentit në kujtim të

Shlyerjes së Krishtit. Pastaj, ata i vendosën duart mbi ata që kishin pagëzuar, duke i konfirmuar anëtarë të kishës dhe duke ua dhënë dhuratën e Frymës së Shenjtë.²² Shpirti i Zotit u derdh mbi njerëzit në mbledhje dhe disa njerëz në bashkësi filluan të profetizonin. Të tjerë lëvduan Zotin dhe të gjithë u gëzuan së bashku.

Jozefi mori gjithashtu zbulesën e parë drejtuar gjithë trupës së kishës së re. "Vini re, do të ketë një anal të mbajtur mes jush", urdhëroi Zoti, duke ua kujtuar njerëzve të Tij se atyre u duhej ta shkruanin historinë e tyre të shenjtë, duke mbajtur një rrëfim të veprimeve të tyre dhe duke dëshmuar rolin e Jozefit si profet, shikues dhe zbulues.

"Atë e kam frymëzuar të nxitë kauzën e Sionit me fuqi të madhe për mirë", shpalli Zoti. "Fjalën e tij duhet ta merrni si nga goja ime, plot durim e besim. Pasi duke i bërë këto gjëra, portat e ferrit nuk do të hapen kundër jush."²³

Më vonë, Jozefi qëndroi pranë një rrëkeje dhe dëshmoi pagëzimet e nënës dhe babait të tij në kishë. Pas vitesh që kishin ecur në shtigje të ndryshme në kërkimin e tyre për të vërtetën, ata së fundi u bashkuan në besim. Teksa i ati po dilte nga uji, Jozefi e kapi për dore, e ndihmoi të dilte në breg dhe e përqafoi.

“Perëndia im”, thirri ai, duke e zhytur fytyrën në kraharorin e të atit, “jetova sa ta shoh atin tim të pagëzohet në kishën e vërtetë të Jezu Krishtit!”²⁴

Atë mbrëmje, Jozefi shkoi heshtazi në pyllin aty pranë, me zemrën që po i shpërthente nga emocioni. Ai dëshironte të ishte vetëm, larg vështrimeve të miqve dhe familjarëve. Në dhjetë vitet që nga Vegimi i Parë, ai kishte parë qiejt të hapeshin, kishte ndier Shpirtin e Perëndisë dhe kishte marrë mësim nga engjëjt. Ai gjithashtu kishte mëkatuar dhe e kishte humbur dhuntinë e tij, mirëpo u pendua, mori mëshirën e Perëndisë dhe e përktheu Librin e Mormonit me fuqinë dhe hirin e Tij.

Tashmë Jezu Krishti e kishte rivendosur kishën e Tij dhe i kishte dhënë autoritet Jozefit me të njëjtën priftëri që kishin mbajtur apostujt në lashtësi kur ata ia çuan ungjillin botës.²⁵ Lumturia që ndjeu ishte tepër e madhe që ta mbante përbrenda dhe, kur Xhozef Najti dhe Oliveri e gjetën më vonë atë natë, ai po qante.

Gëzimi i tij ishte i plotë. Vepra kishte filluar.²⁶ ■

Një listë e plotë e veprave të cituara gjendet në anglisht te saints.lds.org. Fjala *Tema* te shënimet tregon informacion shtesë në internet te shenjtore.lds.org.

SHËNIME

1. Copyright for Book of Mormon, 11 qershor 1829, në *JSP*, D1:76–81.
2. “Prospect of Peace with Utah”, *Albany Evening Journal*, 19 maj 1858, f. [2]; “From the Troy Times”, *Albany Evening Journal*, 21 maj 1858, f. [2]; John H. Gilbert, Memorandum, 8 shtator 1892, fotokopje, Church History Library.
3. Doktrina e Besëlidhje 19 (Revelation, circa Summer 1829, në josephsmithpapers.org); shih edhe Historical Introduction to Revelation, circa Summer 1829 [DC 19], në *JSP*, D1:85–89; dhe Knight, Reminiscences, f. 6–7.
4. McBride, “Contributions of Martin Harris”, 1–9; Joseph Smith History, 1838–1856, vëllimi A-1, f. 34, në *JSP*, H1:352 (boca 2).
5. John H. Gilbert, Statement, 23 tetor 1887, Church History Library; Indenture, Martin Harris to Egbert B. Grandin, Wayne County, NY, 25 gusht 1829, Wayne County, NY, Mortgage Records, vëllimi 3, f. 325–326, mikrofilm 479,556, U.S. and Canada Record Collection, Family History Library; Historical Introduction to Revelation, circa Summer 1829 [DC 19], në *JSP*, D1:85–89.
6. Copyright for Book of Mormon, 11 qershor 1829, në *JSP*, D1:76–81; John H. Gilbert, Memorandum, 8 shtator 1892, fotokopje, Church History Library; Porter, “The Book of Mormon”, f. 53–54.
7. John H. Gilbert, Memorandum, 8 shtator 1892, fotokopje, Church History Library; Lucy Mack Smith, History, 1844–1845, libri 9, f. [8]; Joseph Smith to Oliver Cowdery, 22 tetor 1829, në *JSP*, D1:94–97.
8. John H. Gilbert, Memorandum, 8 shtator 1892, fotokopje, Church History Library; Lucy Mack Smith, History, 1844–1845, libri 9, f. [2]; “Printer’s Manuscript of the Book of Mormon”, në *JSP*, R3, Pjesa 1:xxvi. **Tema:** Printing and Publishing the Book of Mormon [Shtypja dhe Botimi i Librit të Mormonit]
9. Oliver Cowdery to Joseph Smith, 6 nëntor 1829, në *JSP*, D1:100–101; Mosia 3:18–19; 5:5–7; 4 Nefi 1:17; shih edhe Oliver Cowdery to Joseph Smith, 28 dhjetor 1829, në *JSP*, D1:101–104.
10. Thomas B. Marsh, “History of Thomas Baldwin Marsh”, *LDS Millennial Star*, 4 qershor 1864, 26:359–360; 11 qershor 1864, 26:375–376.
11. Lucy Mack Smith, History, 1844–1845, libri 9, f. [9]. Për shembuj nga fragmentet e Librit të Mormonit të botuara nga Abner Cole, shihni “The Book of Mormon”, *Reflector*, 16 shtator 1829, f. 10; “Selected Items”, *Reflector*, 23 shtator 1829, f. 14; “The First Book of Nephi”, *Reflector*, 2 janar 1830, f. 1; dhe “The First Book of Nephi”, *Reflector*, 13 janar 1830, f. 1. **Tema:** Critics of the Book of Mormon [Kritika për Librin e Mormonit]
12. Lucy Mack Smith, History, 1844–1845, libri 9, f. [9]–[12]; Lucy Mack Smith, History, 1845, f. 166–168.
13. Chamberlin, Autobiography, f. 4–11.
14. Copyright for Book of Mormon, 11 qershor 1829, në *JSP*, D1:76–81; John H. Gilbert, Memorandum, 8 shtator 1892, fotokopje, Church History Library; “Book of Mormon”, *Wayne Sentinel*, 26 mars 1830, f. [3]. Disa libra i lidhën edhe me kapakë prej lëkure deleje.
15. Faqja e Titullit të Librit të Mormonit, rreth fillimit të qershorit 1829, në *JSP*, D1:63–65; shih edhe Lucy Mack Smith to Solomon Mack, 6 janar 1831, Church History Library.
16. Testimony of Three Witnesses, Late June 1829, në *JSP*, D1:378–382; Testimony of Eight Witnesses, Late June 1829, në *JSP*, D1:385–387.
17. Tucker, *Origin, Rise, and Progress of Mormonism*, f. 60–61.
18. Shih Lucy Mack Smith to Solomon Mack, 6 janar 1831, Church History Library.
19. Joseph Smith History, circa Summer 1832, f. 1, në *JSP*, H1:10; Doktrina e Besëlidhje 27:12–13 (Revelation, circa August 1830, në Doktrina e Besëlidhje 50:3, botimi i 1835–ës, në josephsmithpapers.org); Oliver Cowdery to Phineas Young, 23 mars 1846, Church History Library; “Joseph Smith Documents Dating through June 1831”, në *JSP*, D1:xxxvii–xxxix; shih edhe Cannon dhe të tjerë, “Priesthood Restoration Documents”, f. 163–207. **Tema:** Restoration of the Melchizedek Priesthood [Rivendosja e Priftërisë Melkizedeke]
20. Joseph Smith History, 1838–1856, vëllimi A-1, f. 27, në *JSP*, H1:326–328 (boca 2).
21. Joseph Smith History, 1838–1856, vëllimi A-1, f. 37, në *JSP*, H1:364 (boca 2); Stevenson, Journal, 22 dhjetor 1877; 2 janar 1887; An Act to Provide for the Incorporation of Religious Societies (5 prill 1813), *Laws of the State of New-York* (1813), 2:212–219. **Tema:** Founding Meeting of the Church of Christ [Mbledhja e Themelimit të Kishës së Krishtit]
22. Joseph Smith History, 1838–1856, vëllimi A-1, f. 37–38, në *JSP*, H1:364–371 (boca 2).
23. Joseph Smith History, 1838–1856, vëllimi A-1, f. 37, në *JSP*, H1:366; Doktrina e Besëlidhje 21 (Revelation, Apr. 6, 1830, në josephsmithpapers.org); “History of Joseph Smith”, *Times and Seasons*, 1 tetor 1842, 3:928–929.
24. Lucy Mack Smith, History, 1844–1845, libri 9, f. [12]; Knight, Reminiscences, f. 8; shih edhe Bushman, *Rough Stone Rolling*, f. 110.
25. Joseph Smith History, 1838–1856, vëllimi A-1, f. 38, në *JSP*, H1:372 (boca 2); Joseph Smith, “Latter Day Saints”, në Rupp, *He Pasa Ekklesia*, f. 404–405, në *JSP*, H1:506.
26. Knight, Reminiscences, f. 7.



**Nga Plaku
Kuentin L. Kuk,**

i Kuorumit të
Dymbëdhjetë
Apostujve

Sa i Mëshirshëm Ka Qenë Zoti

Historia e re e Kishës me shumë vëllime do të na ndihmojë t'i mbajmë besëlidhjet tona duke na e zgjeruar kujtesën për ato që Shpëtimtari ka bërë për ne.

Për herë të parë në afro njëqind vjet, po botohet një histori e re e Kishës me shumë vëllime nën drejtimin e Presidencës së Parë dhe Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve. Me titull *Shenjtoret: Historia e Kishës së Jezu Krishtit në Ditët e Mëvonshme*, kjo histori me tregime tregon historinë e vërtetë të njerëzve të zakonshëm që u bënë shenjtore nëpërmjet Shlyerjes së Jezu Krishtit (shih Mosia 3:19). Vëllimi i parë, *Standardi i së Vërtetës, 1815–1846*, tani ka përfunduar dhe është përkthyer në 14 gjuhë për shpërndarje në shumë zona të botës.

Shenjtoret është historia e mënyrës se si Perëndia e rivendosi besëlidhjen e Tij të përjetshme për shkak të dashurisë së Tij për fëmijët e Vet. Ajo dëfton mënyrën se si Zoti e rivendosi ungjillin e Tij për të siguruar shpresë e paqe në kohë trazirash, sprovash e vuajtjesh. Ajo gjithashtu dëfton se si besëlidhjet e rivendosura çojnë në ekzaltim nëpërmjet Jezu Krishtit.

Mund të prisni që historia të fillojë me Jozef Smithin, por historia *Shenjtoret* fillon në vitin 1815 me shpërthimin e një vullkani në Indonezi, i cili gjithandej shkaktoi



SANTOS

1815-1846

EL
ESTANDARTE
DE LA VERDAD

Nëpërmjet profetit të Tij, Perëndia i përtëriu besëlidhjet që nuk e zhdukin të keqen, pikëllimin, vuajtjen dhe ndarjen prej vdekjes, por vërtet premtojnë shërim nëpërmjet Shlyerjes së Shpëtimtarit dhe na sigurojnë se marrëdhëniet mund të zgjatin në përjetësi.

vdekje, sëmundje e shkatërrim. Kjo pikë fillimi u zgjodh, duke u nisur, nga ajo që Zoti zbuloi rreth mënyrës se si Ai i rivendosi besëlidhjet që na lidhin me Shpëtimtarin dhe na aftësojnë që t'i kapërcejmë të gjitha problemet e jetës:

“Unë, Zoti, duke e ditur fatkeqësinë që do të vinte mbi banorët e tokës, thirra shërbëtorin tim, Joseph Smith të Riun dhe i fola atij nga qielli e i dhashë urdhërime; . . .

Që besëlidhja ime e përjetshme të mund të themelohet” (DeB 1:17, 22).

Nga skena e parë deri te shpërndarja e saj në mbarë botën, historia *Shenjtoret* u jep fëmijëve të Perëndisë anembanë sinjalin se ajo është historia e besëlidhjes së tyre me Perëndinë, I Cili i di vështirësitë e tyre. Nëpërmjet profetit të Tij, Perëndia i përtëriu besëlidhjet që nuk e zhdukin të keqen, pikëllimin, vuajtjen dhe ndarjen prej vdekjes, por vërtet premtojnë shërim nëpërmjet Shlyerjes së Shpëtimtarit, na e shenjtërojnë jetën dhe i dhurojnë asaj kuptim më të lartë dhe na sigurojnë se marrëdhëniet që janë të shtrenjta për ne këtu në tokë mund të zgjatin në përjetësi, “do të jelnë me lavdi të përjetshme” (shih DeB 130:2).

Tetë kapitujt e parë të pjesës *Standardi i së Vërtetës* janë botuar në numrat e kësaj reviste gjatë gjithë vitit. Numri i këtij muaji e mbyll serinë e kapitujve të librit *Shenjtoret*, por



historia vazhdon te **shenjtore.lds.org**, në programin kompjuterik Gospel Library [Biblioteka e Ungjillit] dhe e shtypur si libër (porositeni në **store.lds.org**). Ju ftoj të vazhdoni ta lexoni atë në cilindo prej këtyre kanaleve.

Një Model dhe Plan Hyjnor

Libri *Shenjtoret* vazhdon një model hyjnor në të cilin profetët, si pjesë e shërbesës së tyre, e përdorin të shkurarën për të na ndihmuar të mësojmë cilët jemi dhe t'i shohim qëllimet e Perëndisë në jetën tonë. Në shkrimet e shenjta, shumë profetë e nisin mësimdhënien e tyre duke

treguar histori mbi mëshirën e Zotit për paraardhësit e tyre.¹ Moroni u bëri thirrje lexuesve të Librit të Mormonit që të “kujtojnë] sa i mëshirshëm ka qenë Zoti” gjatë gjithë historisë “dhe t’i meditojnë] në zemrat [e tyre]” (Moroni 10:3). Reflektimi mbi mirësinë e Perëndisë na përgatit të marrim dëshmimin nga Shpirti, i cili na mëson “për gjëra ashtu siç janë në të vërtetë dhe për gjëra ashtu siç do të jenë në të vërtetë” (Jakobi [LiM] 4:13; shih edhe Moroni 10:4–5).

Dijenja se Prindërit tanë Qiellorë bënë plane për lumturinë dhe ekzaltimin tonë përfundimtar na siguron perspektivë, na jep identitet si fëmijë të dashur të prindërve hyjnore dhe na e shton sigurinë që kemi te Zoti, madje edhe në kohë fatkeqësish. Kur e kujtojmë mirësinë e Zotit, mund të mbrohemi edhe nga krenaria dhe rreziqet e begatisë. Mormoni shkroi rreth një kohe kur nefitët “filluan të bëheshin jashtëzakonisht të pasur”. Por ndryshe nga periudha të tjera në Librin e Mormonit, kur njerëzit lejuan që krenaria dhe pasuria t’u sillnin shkatërrimin e vet, ata ndoqën një shteg të ndryshëm këtë herë: “Por, me gjithë pasuritë e tyre, ose fuqinë e tyre, ose begatinë e tyre, ata nuk u ngritën në krenarinë e syve të tyre; as nuk qenë të ngadalshëm, që të kujtonin Zotin, Perëndinë e tyre; por u përulën jashtëzakonisht para tij”. Ata i mbajtën besëlidhjet dhe mbetën të drejtë sepse “ata nuk harruan sesa gjëra të mëdha kishte bërë Zoti për ta” (shih Alma 62:48–50).

Libri *Shenjtoret* na jep mësim si këto e shumë të tjera. Ai do t’ju ndihmojë ta shihni dorën e Zotit në jetën tuaj teksa i përjetoni tërthorazi sprovat e besimit, brengat dhe gëzimet, zbulesat dhe vendosmërinë e njerëzve të papërsosur që e donin Zotin dhe e ndien dashurinë e Tij.

Teksa lexoni, do të zbuloni ide dhe domethënie të reja edhe në historitë që i keni dëgjuar më parë. Asnjë skenë në historinë e Kishës nuk është më e mirënjohur se Vegimi i Parë i Jozef Smithit, por libri *Shenjtoret* na ndihmon ta kuptojmë më mirë se çfarë hoqi Jozefi për ta përputhur atë që ndiente në zemër me atë që kishte në mendje.

Dëshira e tij e përzemërt për ta ndier faljen e Shpëtimtarit kishte mbetur e paplotësuar sepse ai vërejti se asnjëra nga kishat ekzistuese nuk e jepte

mësim “ungjillin e Jezu Krishtit si shënohej në Dhiatën e Re”². Në mendje, Jozefi përsiati se cila kishë ishte e drejtë ose a ishin të gjitha të gabuara. Në zemër, ai shpresonte dëshpërimisht që njëra prej tyre të ishte e drejtë që ai të mund ta gjente paqen që kërkonte. Me mendjen dhe zemrën që po përlesheshin, Jozefi zbuloi se mund të pyeste Perëndinë. Ai shkoi në pyll për t’u lutur. Atje pa Atin dhe Birin, Të Cilët e falën dhe e zgjidhën mëdyshjen e tij në një mënyrë që nuk e kishte përfituar kurrë.³

Jozefi, familja e tij dhe shumë njerëz të tjerë, që e përqaftuan besëlidhjen e rivendosur të Zotit dëshironin ta ndienin dashurinë e Perëndisë për ta, mësuan si të mund t’i afroreshin më shumë Atij dhe t’i shëronin marrëdhëniet



Libri Shenjtorët dëfton se dijenia për mënyrat e veprimit të Zotit na jep perspektivë përjetësie, na ndihmon t'i shohim gjërat ashtu siç janë dhe do të jenë në të vërtetë dhe na ndihmon të ushtrojmë besim që Zoti do të na shohë gjatë kohëve të vështira.

me njerëzit e tyre të dashur. Libri *Shenjtorët* tregon historitë e tyre.

Mirëbesimi te Zoti gjatë Sprovave

Vëllimi 1 i Librit *Shenjtorët* përfshin historinë zemërkëputëse të Amanda Barnes Smithit dhe familjes së saj, që iu bindën urdhërimeve të Zotit dhe po bënë vullnetin e Tij.⁴ Bashkëshorti i Amandës dhe një prej bijve të saj u vranë mizorisht së bashku me 15 shenjtorë të tjerë të ditëve të mëvonshme që kishin zënë vend në një koloni të vogël në Shoul-Krik të Misurit. Zoti e mbajti Amandën gjatë përvojës së tmerrshme, iu përgjigj lutjeve të saj, i dha zemër dhe i mundësoi që ta shëronte të birin e plagosur rëndë.⁵

Libri *Shenjtorët* dëfton se si Amanda mësoi të mirëbesonte te Zoti gjatë fatkeqësisë së skajshme. Ai tregon edhe ato që mësoi Jozef Smithi rreth mirësisë së Perëndisë madje edhe në kohë vuajtjeje. Ai dëfton se dijenia për mënyrat e veprimit të Zotit na jep perspektivë përjetësie, na ndihmon t'i shohim gjërat ashtu siç janë dhe do të jenë në të vërtetë dhe na ndihmon të ushtrojmë besim që Zoti do të na shohë gjatë kohëve të vështira.

Kur Profeti Jozef mësoi për atë që i kishte ndodhur familjes së Amandës dhe të tjerëve në Shoul-Krik, ai ndjeu se më mirë do të ishte të shkonte në burg ose t'i merrnin jetën sesa të lejonte që shenjtorët të masakroheshin. Të nesërmen ai u orvat të bënte marrëveshje për një zgjidhje paqësore me milicinë e Misurit, e cila qe bërë gati për të sulmuar vendosjen kryesore të shenjtorëve në Far



Uest. Në vend të sulmit, Jozefi u zu rob dhe u mbajt si i burgosur.

Rreth pesë muaj më vonë, Jozefi qëndroi i arrestuar, i mbyllur në një qeli të ftohtë e të ngushtë nëntokësore në Liberti të Misurit. Ai pyeste veten, ku po fshihej Perëndia, dhe sa kohë do të mund të duronte Ai duke dëgjuar britmat e të vejave dhe jetimëve. Ai u lut: “O Zot, për sa kohë do t'i vuajnë ata këto gabime dhe shtypje të paligjshme, përpara se zemra jote të zbutet ndaj tyre dhe brendësia jote të nxitet me pasion kundrejt tyre?” (DeB 121:3.)

Libri *Shenjtoret* na mëson se fatkeqësia nuk është provë për mosmiratim nga Zoti, as një tërheqje mbrapsht e beki-meve të Tij. Kundërshtimi është pjesë e planit të Perëndisë për të na përmirësuar e përgatitur për një vendmbërritje të përjetshme e çelestiale (shih 2 Nefi 2:11). Jozefi mësoi se vuajtja e pafundme e Shpëtimtarit i mundëson Atij të na vijë në ndihmë kur vuajmë dhe përfundimisht të na ekzaltojë (shih Alma 7:11–13). Si përgjigje ndaj thirrjes lënguese të Jozefit, Zoti i renditi të gjitha llojet e sfidave përpara se ta mbyllte duke thënë:

“Në qoftë se edhe grykat e ferrit do ta shqyejnë gojën për ty, dije, biri im, se gjithë këto gjëra do të të japin përvojë dhe do të jenë për të mirën tënde.

Biri i Njeriut ka zbritur nën këto të gjitha. A je ti më i madh se ai?” (DeB 122:7–8)

Përjetimi i *këtyre gjërave* vetë mund të na dhurojë mirë-kuptim të ngjashëm me të Krishtit për ata që kanë hidhë-rime. “[Z]emra ime do të jetë gjithmonë e më e butë pas kësaj”, kuptoi Jozefi ndërsa ishte në burg. Ai dëshironte të mund të ishte me shenjtoret për t’i qetësuar dhe ngushë-lluar. “Nuk do të mund të isha ndier kurrë siç ndihem tani”, shpjegoi ai, “nëse nuk do të kisha vuajtur padrejtësitë që kam vuajtur”⁶.

Një arsye pse Presidenca e Parë dhe Kuorumi i Dymbë-dhjetë Apostujve e autorizoi dhe e miratoi librin *Shenjtoret* është se ai mund ta ndihmojë secilin prej nesh t’i përje-tojë *këto gjëra* nëpërmjet historive të të tjerëve. Ne mund të mësojmë nga Amanda se edhe kur Perëndia e sheh të përshtatshme në urtësinë e Tij të pafundme që të mos e parandalojë të keqen ose vuajtjen, Ai na do dhe kujdeset për ne. Ai i dëgjon lutjet tona dhe është i mëshirshëm e dashamirës.

Bekimet e Rivendosura të Tempullit

Askund më mirë se në tempull nuk na shfaqet ajo më-shirë e dashamirësi. Në thelbin e vet, libri *Shenjtoret* është historia e bekimeve të rivendosura të tempullit. Vëllimi i parë mbaron kur mijëra shenjtore të ditëve të mëvonshme marrin ordinancat e shenjta në Tempullin e Navusë në vitin 1846. Vëllimi i dytë do të arrijë kulmin me përkushtimin e Tempullit të Solt-Lejkut dhe me shenjtoret që fillojnë t’i marrin ordinancat atje në vitin 1893. Vëllimi i tretë do të mbyllet me shenjtoret europianë që fillojnë të mblidhen

në tempullin e Zvicrës në vitin 1955. Vëllimi i katërt do ta sjellë historinë deri në të tashmen, kur tempujt e pikëzojnë tokën dhe shenjtoret nga i gjithë globi i marrin ordinancat e ekzaltimit, sikurse e parashikuan profetët kohë më parë.

Në shtëpinë e Zotit ne bëjmë besëlidhje dhe na dhurohet fuqia për t’i mposhtur pasojat e Rënies, përfshirë të keqen dhe vuajtjen në këtë botë. Ne marrim mbrojtje dhe përfundimisht fuqi për t’u ngritur në Ringjallje, të vulosur me njerëzit tanë të dashur përgjithmonë.

Libri *Shenjtoret* do të na ndihmojë t’i mbajmë besëlidhjet duke na e zgjeruar kujtesën në mënyra më të shenjta. Ai do të na ndihmojë ta kujtojmë gjithmonë atë që Shpëtimtari ka bërë për ne. Pa anale të veprimeve të Perëndisë në të kaluarën, ne nuk do të mund të “kujtoni[m] sa i mëshirshëm ka qenë Zoti ndaj fëmijëve të njerëzve” (Moroni 10:3). Për këto arsye, jemi në borxh me Zotin dhe me shenjtoret që i mbajtën shënim përvojat e tyre me dashurinë e Tij për ta. Zoti e urdhëroi Jozef Smithin që t’i mbante shënim përvojat e tij (shih DeB 21:1). Ai i urdhëroi një historiani të Kishës, që po punonte nën drejtimin e Jozefit, që të “mba[nte] analin dhe historinë e kishës vazhdimisht” (DeB 47:3). Ai urdhëroi që historia të përfshinte “të gjitha gjërat që do jenë për të mirën e kishës dhe për brezat në rritje” (DeB 69:8).

Me këto zbulesa dhe me premtimin besëlidhës për ta kujtuar gjithmonë Shpëtimtarin ndër mend, Presidenca e Parë dhe Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve filloi ta planifikonte librin *Shenjtoret* 10 vjet më parë. Tani ju nxitim që ta lexoni atë, duke mirëbesuar se do t’ju vijë në ndihmë për ta kuptuar planin e Perëndisë, për ta parë sa i mëshirshëm ka qenë Zoti, për të bërë durim me besnikëri në kohë të mira e të këqija, për të fituar me të tjerët aftësinë e mirëkuptimit të ngjashëm me të Krishtit dhe për t’i mbajtur besëlidhjet që ju udhëheqin drejt ekzaltimit. ■

SHËNIME


1. Shembujt përfshijnë Nefin (1 Nefi 17:23–43), Mbretin Beniamin (Mosia 1), Limhin (Mosia 7), një engjell të Zotit për Almën (Mosia 27), Almën (Alma 9:10), Mormonin (Mormoni 3:17–22) dhe Moisiun (Eksodi 13:3).
2. Joseph Smith, në “History, circa Summer 1832”, f. 2, josephsmithpapers.org.
3. Shih “History, 1838–1856, vëllimi A-1 [23 dhjetor 1805–30 gusht 1834]”, f. 3, josephsmithpapers.org.
4. Shih “Revelation, 12 January 1838–C”, [1], josephsmithpapers.org.
5. Shih *Shenjtoret*, vëllimi 1, kapitulli 30, “Fight Like Angels”.
6. “Letter to Presendia Huntington Buell, 15 March 1839”, [1], josephsmithpapers.org.

VEZËT, SIGURESA DHE BESIMI

Një prej synimeve tona si familje është të kursejmë mjaftueshëm para për t'i bërë [bankës] një pagesë për shtëpinë tonë. Pa atë synim, unë mund t'i kaloja fundjavat e mia duke parë televizor, duke pritur që të më vinin mundësi financiare.

Si shofer për një kompani miniere në veri të Kilit, unë punoj katër ditë larg shtëpisë në miniera dhe më pas bëj tri ditë pushim – nga e shtuna deri të hënën. Për t'i shtuar të ardhurat dhe për të kursyer për blerjen e një shtëpie, ne vendosëm të fillonim shitjen e vezëve. Plani ynë ishte që të merrnim porosi nga miqtë, fqinjët dhe anëtarët e Kishës; të blinim rreth 1000 vezë çdo javë nga një grosist; dhe më pas t'i merrnim dhe t'i shpërndanim vezët të shtunave dhe të hënave.

Bashkëshortja ime, Laura dhe unë, vendosëm t'i merrnim me vete dy fëmijët tanë gjatë shpërndarjes dhe ta shijonim kohën së bashku. Mirëpo, ndërsa ishim rrugës për të blerë kutitë e para me vezë, na ndodhi një ngatërresë. Një prej fëmijëve tanë, duke luajtur me një mprehëse të vogël metalike lapsash, e hodhi atë dhe ajo ra pikërisht te vendi i makinës për ndezjen e cigares. Pati shkëndijë elektrike dhe furgoni ynë humbi të gjithë energjinë, duke u fikur menjëherë



Kur një mprehëse të vogël metalike lapsash ra te vendi i makinës për ndezjen e cigares, furgoni ynë u fik papritmas. Kishim djegur një siguresë.

pikërisht në mes të autostradës. Kishim djegur një siguresë.

Ndërsa qëndruam atje duke penguar trafikun dhe duke vlarë mendjen se ç'të bënim, u shqetësuam kaq shumë sa që ishim gati të qanim. Por në atë çast, u kujtova se Zoti kishte premtuar se do të na ngrinte moralisht dhe do të na ndihmonte po ta vendosnim mirëbesimin tonë tek Ai. Një ndjenjë qetësie më

pushtoi të tërin. Kuptova se nuk mundesha thjesht të rrija ulur duke u ankuar. Ne kishim një problem, dhe me ndihmën e Perëndisë, do ta zgjidhnim atë.

Unë dhe Laura u kthyem nga njëri-tjetri dhe thamë: “Ne duhet të tregojmë besim”. Bëmë një lutje dhe i fshimë lotët. Më pas, me Laurën në timon, dola të shtyja makinën. Disa njerëz zbritën nga makinat e tyre dhe më ndihmuan.

E shtymë makinën rreth 200 metra përpara se të gjenim një vend të sigurt larg autostradës për të parkuar. Teksa makina u ndal në një vendqëndrim, unë vura re se kishim parkuar pikërisht përpara një dyqani kasetofonash.

E gjeta siguresën e djegur, hyra brenda në dyqan dhe e pyeta: “A keni një nga këto?”

Punonjësi u përgjigj: “Sigurisht”.

Bleva një siguresë dhe e vendosa në vendin e vet, makina u ndez menjëherë dhe u nisëm. Grosisti i vezëve ishte gati për ta mbyllur dyqanin kur hapëm krahun. I blemë vezët dhe i bëmë shpërndarjet tona.

Kur kemi sfida, ne duhet të kujtojmë t'i kërkojmë ndihmë Atit tonë Qiellor. Unë e di se Ai do të na përgjigjet ndërsa shkojmë përpara dhe e tregojmë besimin tonë tek Ai. ■
Alvaro Alkaino, Antofagasta, Kili

NJË BEKIM NË SHKRIMIN E DORËS TË NËNËS SIME

Një mbrëmje po përsiatsha për mesazhin që do të jepja në një konferencë të ardhshme lagjeje. I kisha studiuar shkrimet e shenjta gjatë gjithë javës, dhe ndonëse kisha marrë udhëzime dhe ide të shumta, prapëse-prapë nuk kisha një drejtim të qartë se çfarë Zoti donte që, si president kunji, t'u thosha anëtarëve të lagjes.

Me lutje të çiltër, kërkova udhërrëfim nga Shpirti që t'i drejtonte mendimet e mia. Më pas hapa shkrimet e shenjta dhe fillova të lexoja sërish. Mendja ime u kthye menjëherë të synimet e lagjes që kishim biseduar së fundi me peshkopin. Një nga këto synime ishte të përdornim manualin *Predikoni Ungjillin Tim* kur ta shpërndanim ungjillin me miqtë dhe fqinjët.

Ndjeva nxitjen që ta përfshija manualin *Predikoni Ungjillin Tim* në studimin tim vetjak atë mbrëmje. Nxora një kopje dhe e hapa në një faqe rastësore. Në atë faqe, unë gjeta dy referenca të shkrimeve të shenjta të shkruara me dorë – 1 Nefi 8:8–11 dhe 1 Nefi 11:21–22. Teksa i pashë më nga afër, unë kuptova që ato referenca kishin shkrimin e dorës të nënës sime. Nëna ime e ëmbël kishte ndërruar jetë disa vite më parë, dy muaj pas ditëlindjes së saj të 80. Ajo ishte një shembull guximi dhe vetëmohimi, e cila shihte gjithnjë

mirësinë të njerëzimit. Dhe ajo i pëlqente shumë shkrimet e shenjta.

I hapa shkrimet e shenjta tek ato vargje për të parë se ç'e shtyu atë që t'i hidhte në letër. Kur i lexova, mendja m'u hap menjëherë për mesazhin që duhet të jepja. Ishte një mesazh i thjeshtë që anëtarët e Kishës të cilët e kishin provuar frutën e shijshme të ungjillit, ndonjëherë mund ta harrojnë se edhe shumë të tjerë po e kërkojnë të njëjtën frutë. Ne duhet t'i afrohemi dhe t'u themi se ku ta gjejnë atë.

Unë mendova për nënën time të ëmbël teksa shihja pjesën tjetër të

manualit *Predikoni Ungjillin Tim*. Nuk kishte asnjë emër, asnjë shënim tjetër apo ndonjë gjë që të tregonte se libri kishte qenë ndonjëherë i saj. U ula i mahnitur teksa reflektova mbi zinxhirin e nxitjeve shpirtërore që çuan te ky çast. Shpirti më pohoi se mendimet e mia morën drejtimin, për të cilin isha lutur. Nëna ime as që e dinte, mirëpo shumë vite më parë ajo i shkroi këto referenca, që Zoti t'i përdorte ato si përgjigje ndaj lutjes së përlulur të birit të saj. ■

Daglas Hexher, Nevada, SHBA

Ndërsa po përgatitesha për konferencën e lagjes, unë e hapa manualin *Predikoni Ungjillin Tim* te një faqe me referenca të shkrimeve të shenjta të shkrimit e dorës të nënës sime.



NJË MREKULLI NË SHTËPINË E ZOTIT NË KIEV

Unë dhe familja ime ishim të entuziazmuar që do të udhëtonim me makinë nga Rumania për në Kiev të Ukrainës, për përkushtimin e tempullit në gusht të 2010-ës. Duke e ditur se ky do të ishte tempulli për shenjtoret në Misionin e Moldavisë në Rumani, ne udhëtuam 14 orë vetëm për të qenë atje. Kur mbërritëm, takuam një grup tjetër që kishte udhëtuar gjithashtu nga Rumania. Të gjithë ishim të gëzuar që ishim në Kiev për këtë ngjarje të shenjtë.

Në ditën e përkushtimit, grupi ynë nga Rumania u caktua ta shihte përkushtimin me anë të transmetimit satelitor në një dhomë në katin përdhës të tempullit. Disa filluan të shprehnin zhgënjimin e tyre. Ata kishin shpresuar të merrnin pjesë në përkushtim me profetin në dhomën çelestiale. Disa madje thanë që mund të kishin qëndruar në shtëpi e ta kishin parë transmetimin nga godina e tyre kishtare në Rumani.

Në zemrën time fillova të lutesha: “Atë Qiellor, si mund t’i ndihmojmë këta anëtarë nga Rumania që të kenë një përvojë të paharrueshme në shtëpinë Tënde?”

Nuk e kisha marrë ende një përgjigje kur filloi sesi i përkushtimit. Shpejt, morëm vesh se profeti, Presidenti Tomas S. Monson (1927–2018), do të zbriste poshtë dhe ta vendoste gurin e qoshes në vend. Ndoshta kjo ishte përgjigja jonë! U luta për një



mënyrë që profeti të vinte dhe t'i përshëndeste shenjtorët rumunë.

“Këtë nuk e kërkova për vete”, u luta, “por për vëllezërit dhe motrat e mia.”

Pas ceremonisë së gurit të qoshes, Presidenti Monson eci në drejtim të dhomës sonë kur po kthehej për në dhomën celestiale. Befas, në zemër ndjeva se duhet të ngrihesha dhe ta ftoja që të hynte në dhomën tonë.

Unë u ngrita dhe thashë: “Profeti ynë! Ejani e na vizitoni. Ne jemi nga Rumania.”

U duk sikur nuk më dëgjoi. Pastaj, pas një çasti, ai u kthye. “Rumania!” tha ai dhe hyri në dhomë.

Ai na përshëndeti të gjithëve dhe tha se na donte shumë. Zemra ime ishte plot ndërsa po i shihja fytyrat e gëzuara të anëtarëve tanë të dashur.

Në zemrën time u luta: “Atë Qiellor, si mund t'i ndihmojmë këta anëtarë nga Rumania që të kenë një përvojë të paharrueshme në shtëpinë Tënde?”

U luta: “Faleminderit, Atë i dashur për këtë mrekulli në shtëpinë Tënde”.

Kur profeti u largua nga dhoma, asnjëri nuk ishte më i trishtuar. Unë ndjeva se ishim në dhomën më të bekuar në tempull. Ishte një përvojë që nuk do ta harroj kurrë. ■
Doru Vasili, Bukuresht, Rumania

NJË BUZËQESHJE MIRATIMI

Një natë lagjja jonë zhvilloi një veprimtari për të cilën kishim shpenzuar orë të tëra për t'u përgatitur. Pas veprimtarisë, një kërkues i ri më tha mirupafshim, por pas disa minutash u kthye dhe më tha: “Peshkop, kur duhet të kthehem sërish?” Unë i thashë të die-lën dhe djaloshi tha me të shpejtë: “Jo, a nuk ka ndonjë veprimtari tjetër?” Ai ia kishte kaluar kaq mirë me të rinjtë e lagjes sonë sa që donte të kthehej prapë.

Unë bisedova gjithashtu me një çift vizitorësh që kishin marrë pjesë në veprimtari dhe i pyeta se ç'mendim kishin. Bashkëshorti tha: “Qëkurse kemi ardhur këtu, ne kemi ndier paqe dhe qetësi”, diçka të cilën bashkëshortja e tij e pohoi me një tundje koke. U befasona nga kjo gjë sepse kur ata mbërritën në fillim, kishte shumë njerëz që po bisedonin dhe po bënë shumë zhurmë. Por ai vazhdoi, më pa dhe pyeti: “Kjo është Fryma e Shenjtë, apo jo?” I shtangur, munda të thosha vetëm “po”.

Ka pasur shumë gjëra që duheshin bërë për t'u përgatitur për këtë veprimtari, prandaj atë mbrëmje kur përfundoi gjithçka, gjëja e vetme që doja, ishte të shkoja në shtëpi dhe të bija në shtrat. Për shkak se isha aq i lodhur, nuk isha në gjendje të mendoja për bisedat e mia me kërkuesit. Kur mbërrita në shtëpi, bëra lutjen dhe rashë në shtrat, por nuk munda të flija; në mendjen time përfytyrova Zotin që buzëqeshte. Ishte një buzëqeshje miratimi. Në atë çast fillova të kujtoj gjërat e mrekullueshme që kishin ndodhur në veprimtari.

Unë kuptova që zelli dhe dashuria e anëtarëve të lagjes, kishin bërë të mundur që zemrat e atyre kërkuesve të prekeshin. Unë kuptova se buzëqeshja miratuese ishte për atë që po bënim. Nuk munda ta shmangia dot të qarën dhe u ndjeva kaq mirënjohës për dhuratën që na dha Zoti. Ai na kishte dhënë një buzëqeshje miratimi. Unë dëshmoj se fjalët e Zotit janë të vërteta; se kur sjellim tek Ai qoftë edhe një shpirt të vetëm, i madh do të jetë gëzimi ynë në mbretërinë e Atit (shih DeB 18:15). ■

Frenklin Romero, Manabi, Ekuator

TREGOJENI HISTORINË TUAJ

Zëra të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme botojnë rrëfime të vërteta për çdo temë të ungjillit, por jemi duke kërkuar veçanërisht përvojat tuaja në dhënien e shërbesës ndaj të tjerëve dhe në shfaqjen e guximit për ta jetuar ungjillin. Dërgojeni artikullin tuaj në internet te **liahona.lds.org** (klikoni te “Submit an Article” [“Dorëzoni një Artikull”]).



Gjithnjë do të ketë të
“folur . . . [të] rëndë”.
Por gjithnjë do të
jetë mundësia për
të zgjedhur besimin
përpara çdo dyshimi
apo pasigurie.

Shtysa JONË PËR TA Jetuar Ungjillin

Nga Mindi Selu

Revistat e Kishës

Shtegu i dishepullimit është i mbushur me bekime – si me ato “që i vëmë re dhe [ato] që nuk i vëmë re”¹. Por ka raste kur shtegu, pavarësisht bekimeve, nuk është i lehtë apo i volitshëm. Bërja dishepull i Jezu Krishtit kërkon punë dhe sakrificë dhe ndonjëherë është e vështirë për ta gjetur shtysën për t’i jetuar urdhërimet dhe për t’i bërë ato sakrifica.

Si një e re apo i ri në moshë madhore, ndoshta jeni shumë i/e zënë duke u përpjekur për t’iu bërë ballë përgjegjësive të reja, për të marrë vendime serioze për jetën dhe për të kuptuar se si do të jetë shtegu juaj i dishepullimit gjatë pjesës tjetër të mbetur të jetës suaj. Mbi të gjitha, mund të ketë gjëra në rregulloren ose historinë e Kishës apo në doktrinën e ungjillit që nuk i kuptoni plotësisht dhe tundime me të cilat po luftoni, si dhe bekime që ende po i prisni dhe pyetje rreth planit të Perëndisë për ju.

Disa nga ne me raste mund ta pyetin veten a ia vlen ta jetosh ungjillin për bekimet që na janë premtuar. Ne mund të grindemi ngaqë nuk përshtatemi, se duhet shumë punë ose na duket sikur kemi më shumë pyetje se përgjigje. Por gjëja kryesore nga e cila kjo varet është shtysa. Përse e bëni atë që bëni dhe jetoni në atë mënyrë? Përse vazhdoni t’i zbatoni urdhërimet, edhe kur askush nuk është përreth për ta vënë re nëse i zbatoni?

Pavarësisht se kush jeni dhe në cilën fazë të jetës ndodheni, zgjedhja për të gjetur shtysën tuaj duke e kultivuar besimin tuaj te Shpëtimtari dhe tek ungjilli i Tij, varet prej jush.



Te Kush të Shkojmë?

Gjetja dhe pasja e vazhdueshme e shtysës për ta jetuar ungjillin është thujse një sfidë e pashoqe në kohën tonë. Edhe kur Shpëtimtari ishte në tokë, njerëzit prapëseprapë hasnin vështirësi për ta kuptuar dhe si rrjedhojë për t'iu bindur parimeve që Ai dha mësim. Disa nga dishepujt e Tij po dëgjonin teksa Ai shpjegonte një koncept që dukej sikur i fyente ata – roli i Tij si “buka e jetës” (shih Gjoni 6:35–58). Ata iu përgjigjën me dyshim, duke thënë: “Kjo e folur është e rëndë, kush mund ta kuptojë?” (Gjoni 6:60.)

Krishti, duke e kuptuar që ata e kishin të vështirë ta besonin ose ta pranonin këtë doktrinë, pyeti: “Kjo ju skandalizon?” (Gjoni 6:61.) Në vend që ta vendosnin besimin e tyre përpara dyshimeve, shumë nga dishepujt e Tij “u tërhoqën dhe nuk shkuan më me të” (Gjoni 6:66).

Por, kur Krishti e pyeti pjesën tjetër të dishepujve të Tij nëse edhe ata do të “largohe[shin]”, Pjetri dha të vetmen përgjigje që vërtet duhet të jepet: “Te kush të shkojmë? Ti ke fjalë jete të përjetshme” (Gjoni 6:67–68).

Burimi i Shtysës Sonë

Pjetri e dinte burimin e shtysës së vet. Atij i erdhi në zemër arsyeja se përse ne e bëjmë atë që bëjmë në ungjill – prej dëshmisë sonë për Jezu Krishtin

dhe prej besimit në Të. “Ne kemi besuar dhe kemi njohur”, shpalli Pjetri, “se ti je Krishti, Biri i Perëndisë të gjallë” (Gjoni 6:69; theksimi i shtuar). Duke e fituar atë bindje po aq të fortë për Jezun Krishtin, hyjninë e Tij dhe punën e Tij, edhe ne mund ta gjejmë shtysën që të vazhdojmë ta jetojmë ungjillin – edhe kur duket i vështirë, edhe kur askush tjetër nuk do ta vërejë, madje edhe kur nuk jemi të sigurt nëse duam.

Gjithnjë do të ketë të “folur . . . [të] rëndë”. Por gjithnjë do të jetë mundësia për të zgjedhur besimin përpara çdo dyshimi apo pasigurie. Ashtu sikurse tha Plaku L. Uitni Klejton, i Presidencës së Të Shtatëdhjetëve: “Vendimi për të besuar është zgjedhja më e rëndësishme që bëjmë ndonjëherë”².

Pra, çfarë do të bëjmë nëse e gjejmë veten në anën tjetër të një prej atyre me të “folur . . . [të] rëndë”?

1. Ndiqeni shembullin e Pjetrit dhe të dishepujve të tjerë, të cilët qëndruan besnikë edhe kur mund të “largohe[shin]” lehtësisht. Dëgjojeni këshillën e profetëve, apostujve dhe udhëheqësve të tjerë:

“Në çaste frike apo dyshimi, ose kohë shqetësimi, mos u largoni nga besimi që keni fituar tashmë. . . *Mbahuni fort tek ajo që tashmë e dini dhe qëndroni të paepur derisa vjen dija e mëtejshme.*”³

Hidh[ni] një hap të thjeshtë përpara me besim – dhe më pas një tjetër. . . Përqendroh[uni] tek të vërtetat që vërtet i beson[i] dhe . . . lejoj[ini] ato të vërteta t[ua] mbush[in] mendjen dhe zemrën. . .



. . . Fillo[ni] me të vërtetat bazë të ungjillit.”⁴

2. Mos iu ndani shkrimeve të shenjta dhe zbatojini mësimet e tyre:

“Me lutje ta studio[ni] dhe ta përsiat[ni] Librin e Mormonit çdo ditë”⁵.

“Në qoftë se dikush don të dijë vullnetin e tij, do ta njohë nëse kjo doktrinë vjen nga Perëndia apo unë flas nga vetja ime” (Gjoni 7:17).

“Dhe bëhuni bërës të fjalës dhe jo vetëm dëgjues” (Jakob [Bibla] 1:22).

3. Vazhdoni t’i zbatoni urdhërimet.

“Përgjigjet ndaj pyetjeve tona të sinqerta vijnë kur ne i kërkojmë me zell dhe kur ne i jetojmë urdhërimet. . . Besimi ynë mund të shkojë përtej kufijve të arsyes së tanishme.”⁶

“Kur vazhdoni të jeni të bindur, . . . juve do t’ju jepet dituria dhe kuptueshmëria që kërkonit.”⁷

Në fund, shtysa jonë thjesht varet nga ajo që tha Pjetri. A e besojmë ne se Jezusi është Krishti, se Ai e drejton Kishën e Tij dhe ka fjalë jete të përjetshme? A mbizotëron besimi ynë tek Ai kundrejt të “folur[it] . . . [të] rëndë” që nuk mund ta kuptojmë për momentin?

Shpërblimet e të Jetuarit të Ungjillit

Kur ne vërtet vendosim që ta duam dhe ta ndjekim Perëndinë e Jezun Krishtin dhe t’i zbatojmë urdhërimet edhe kur nuk i kuptojmë plotësisht ato, shpërblimet janë të pamatshme. Njeriu i natyrshëm pyet: “Ç’përfitoj unë nga kjo?” Mësimet e ungjillit japin përgjigjet: “Paqe në këtë botë dhe jetë të përjetshme në botën që vjen”; një vend të përgatitur për ju në pallatet e Perëndisë; gjithçka që Ati Qielor ka; “lumturi. . . të pafund” (shih DeB 59:23;

Ethëri 12:34; DeB 84:38; Mosia 2:41); dhe sikurse shpalli Plaku Diter F. Uhtdorf, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve: “Këtu [në Kishë] do të gjeni atë që është e çmuar sa s’ka të paguar. . . . Këtu ju do të gjeni fjalët e jetës së përjetshme, premtimin e shëlbimit të bekuar dhe shtegun drejt paqes e lumturisë.”⁸ Për të mos i përmendur të gjitha.

Kur ne ia përkushtojmë veten ndjekjes së Krishtit dhe zbatimit të urdhërimeve të Tij, neve na premtohen të gjitha këto gjëra dhe shumë të tjera. Kjo nuk do të thotë që shtegu do të jetë gjithnjë i lehtë ose i kuptueshëm, por bekimet që na janë premtuar ngaqë qëndruam të fortë do të vazhdojnë të na zbulohen gjatë gjithë jetës sonë, e madje dhe pas kësaj.

Megjithatë, sado të mrekullueshme të jenë këto bekime, ato nuk duhet të jenë shtysa jonë kryesore për ta jetuar ungjillin. Pavarësisht se çfarë pyetjesh keni, pavarësisht se cilën doktrinë nuk kuptoni, besimi juaj në Jezu Krisht dhe te Shlyerja e Tij do të jetë çelësi i shtysës për ta jetuar ungjillin e Tij, ashtu siç ishte për Pjetrin dhe për të tjerët.

“Motivet dhe mendimet tona në fund të fundit ndikojnë te veprimet tona” tha Plaku Uhtdorf. “Dëshmia e vërtetësisë së ungjillit të rivendosur të Jezu Krishtit është forca motivuese më e madhe në jetën tonë. Jezusi theksonte herë pas here fuqinë e mendimeve të mira dhe të motiveve të drejta: ‘Shihni tek unë në çdo mendim; mos dyshoni, mos kini frikë’ (DeB 6:36).

Dëshmia e Jezu Krishtit dhe ungjilli i rivendosur do të na ndihmojnë në jetën tonë të mësojmë nga plani i veçantë i Perëndisë për ne dhe pastaj të veprojmë në përputhje me të. Ajo na jep siguri mbi realitetin, të vërtetën dhe mirësinë e Perëndisë, mbi mësimet dhe Shlyerjen e Jezu Krishtit dhe për thirrjen e shenjtë të profetëve të ditëve të mëvonshme.”⁹

Sa për mua, unë do të vazhdoj të përpiqem, edhe kur duket e vështirë. Do të vazhdoj t’i bëj lutjet e mia dhe t’i studioj shkrimet e mia të shenjta. Do të vazhdoj të bëj një përpjekje për ta forcuar dëshminë time për Shpëtimtarin çdo ditë. Dhe do të vazhdoj të përpiqem të jetoj ashtu siç do të donte Ai që unë të jetoja dhe do të varem te fjalët e Tij dhe të profetëve e apostujve të Tij të gjallë për të mësuar mënyrën, duke u mbështetur te shtysa që rrjedh jo vetëm nga besimi im tek Ai dhe dashuria ime për Të, por edhe nga sakrificat e Tij e përjetshme dhe dashuria e Tij për mua. ■

SHËNIME

1. Diter F. Uhtdorf, “Udha e Dishepullit”, *Liahona*, maj 2009, f. 76.
2. L. Uitni Klejton, “Zgjidhni të Besoni”, *Liahona*, maj 2015, f. 38.
3. Xhefri R. Holland, “Unë Besoj, o Zot”, *Liahona*, maj 2013, f. 93–94; theksimi në origjinal.
4. Rozmari M. Uiksom, “Rikthimi në Besim”, *Liahona*, maj 2015, f. 94.
5. Tomas S. Monson, “Fuqia e Librit të Mormonit”, *Liahona*, maj 2017, f. 87.
6. Rozmari M. Uiksom, “Rikthimi në Besim”, f. 95.
7. Rasëll M. Nelson, “Zbulesë për Kishën, Zbulesë për Jetën Tonë”, *Liahona*, maj 2018, f. 95–96.
8. Diter F. Uhtdorf, “Ejani, Bashkohuni me Ne”, *Liahona*, nëntor 2013, f. 24.
9. Diter F. Uhtdorf, “Forca e Një Dëshmie Personale”, *Liahona*, nëntor 2006, f. 37, [Konferenca e Përgjithshme Tetor 2006, f. 53].



DY ZGJEDHJE

“Udha e Zotit nuk është e vështirë. Jeta është e vështirë, jo ungjilli. . . . Jeta është e vështirë për të gjithë ne, por jeta është gjithashtu e thjeshtë. Ne kemi vetëm dy zgjedhje. Ne ose mund të ndjekim Zotin dhe të [na dhurohet] fuqi[a] e Tij, dhe të kemi paqe, dritë, forcë, njohuri, vetëbesim, dashuri dhe gëzim, ose mund të shkojmë në ndonjë udhë tjetër, cilado udhë tjetër, çfarëdo udhë tjetër dhe ta jetojmë jetën vetëm – pa mbështetjen e Tij, pa fuqinë e Tij, pa udhëheqje, në errësi, trazirë, dyshim, hidhërim dhe dëshpërim. Dhe unë pyes, cila udhë është më e thjeshta?”

Plaku Lorens E Korbrixi, i Të Shtatëdhjetëve, “Udha”, *Liahona*, nëntor 2008, f. 36.

**Ndjeva që
errësira që
ngulur në jetën
time. Dhe
atëherë kuptova
se më duhej
të flisja me
peshkopin tim.**

Hapi i Parë Drejt Pendimit

Nga Aurilas Peterson

Kujtoj caktimin e datës së pagëzimit tim me misionarët. Ata më pyetën nëse isha gati ta bëja këtë besëlidhje me Atin tonë Qiellor. Pa u menduar fare rreth saj dhe me një zemër plot gëzim, thashë: “Po!” Doja ta pranoja dhuratën e veçantë që Ati im i dashur më pati dhënë dhe e dija se nuk do të isha aq i lumtur pa Shpëtimtarin në jetën time. Por vërtet nuk isha i sigurt për atë që do të më sillte e ardhmja.

Më në fund, dita e madhe erdhi. Ishte e paharrueshme dhe isha aq i lumtur.

Ditë të Errëta

Pas pagëzimit dhe konfirmimit tim, befas ditët dukeshin të errëta. Po merresha me probleme familjare dhe po luftoja që t’u bindesha të gjitha ligjeve të Perëndisë. Nuk dija çfarë të bëja dhe doja të hiqja dorë nga gjithçka. Dukej sikur askush nuk më kuptonte.

Mua gjithmonë më pëlqente leximi i Librit të Mormonit, por gjatë asaj kohe e lashë mënjanë. Një ditë, ndërsa isha vetëm në shtëpi, ndjeva

ëmbëlsinë e Shpirtit që më nxiti të lexoja Librin e Mormonit. U luta paraprakisht, duke dashur të gjej një përgjigje që mund t’i sillte lehtësim vuajtjes sime. E hapa menjëherë tek Alma kapitulli 5. Vargu 27 thotë: “A keni ecur, duke e mbajtur veten të pafajshëm para Perëndisë? A mund të thonit, në veten tuaj, po të thirrshnit që të vdisni në këtë çast, se keni qenë aq sa duhet të përulur? Se rrobat tuaja janë pastruar dhe bërë të bardha nëpërmjet gjakut të Krishtit, i cili do të vijë për të shëlbuar popullin e tij nga mëkatet e tyre?”

Më në fund, u ndjeva i prekur nga këto fjalë. E dija se duhej të pendohesha, ndaj lashë një takim me peshkopin tim. Nuk e mohoj që isha i trembur, por e detyrova veten të shkoj dhe të flas me të.

Të Kuptuarit e Premtimit të Perëndisë

Kur arrita në zyrën e peshkopit, u ndjeva aq fajtor sa që doja thjesht të kthehesha mbrapsht. Por u luta për të pasur guximin që të thoja gjithçka që doja të thosha. Peshkopi më mirëpriti në zyrën e tij dhe mandej ai bëri

një lutje për të marrë ndihmë nga Perëndia. Ai më foli sikur të isha biri i tij dhe e tregoi dashurinë e tij për mua me fjalët që tha. Ai më këshilloi dhe më kërkoi të bëja disa gjëra me qëllim që të merrja faljen e Perëndisë dhe më pas të rikthehesha për t'u takuar me të.

Isha aq i gëzuar për këtë mundësi. E ndoqa këshillën e tij dhe përfundimisht arrita ta kuptoj premtimin e Perëndisë për faljen e Almës: "Në qoftë se i rrëfen mëkatet e tij para teje dhe meje dhe pendohet me çiltërsinë e zemrës së tij, atë do ta falësh; dhe

unë do ta fal atë gjithashtu" (Mosisa 26:29). Pas pendimit të sinqertë, e dija se Perëndia më kishte falur. Unë isha më në fund në gjendje ta ndieja dashurinë e Atit Qiellor në zemrën time dhe errësira u largua. Isha i lumtur dhe krenar për veten.

Peshkopi Është Atje për të Ndhimuar

Peshkopi është përfaqësuesi i Zotit për lagjen. Dijeni se ai është atje për t'ju ndihmuar të gjeni lumturinë e vërtetë që Perëndia ka rezervuar për ju. Mirëbesojini atij.

Nëse keni probleme apo duhet të pendoheni, shkoni dhe gjejeni. Ai do t'ju ndihmojë.

E di se nuk është gjë e lehtë të shkosh tek ai ndonjëherë. Por sikurse Presidenti Lorenzo Snou (1814–1901) shpjegoi rreth planit të përjetshëm të Atit tonë Qiellor: "Unë besoj se në botën [paratokësore] të shpirtave, kur na u propozua që . . . të kalonim nëpër përvojën që po kalojmë tani, nuk qe krejtësisht e pëlqyeshme dhe e pranueshme; . . . Përsëri nuk ka dyshim se ne e pamë dhe e kuptuam qartë në botën e shpirtave se, me qëllim që të përmbushnim ekzaltimin dhe lavdinë tonë, kjo ishte një përvojë e nevojshme." Ai vazhdoi duke thënë: "Ne ishim të gatshëm të pajtoheshim me vullnetin e Perëndisë dhe si pasojë ne jemi këtu" (*Mësime të Presidentëve të Kishës: Lorenzo Snou* [2012], f. 113).

Pendimi është pjesë e asaj që të pajtohesh me vullnetin e Perëndisë. Pra, në vend që t'i trembeni peshkopit, bëjeni mikun tuaj. Ai u zgjodh nga Perëndia dhe ai mund t'ju ndihmojë të pendoheni dhe ta shëroni shpirtin tuaj duke ardhur te Jezu Krishti. Zoti dëshiron të na ndihmojë, por ne duhet ta ndërmarrim atë hap të parë drejt pendimit. Kështu ne mund ta shohim premtimin te Isaia 1:18 të plotësuar: "Edhe sikur mëkatet tuaja të ishin të kuqe flakë, do të bëhen të bardha si bora." Dhe për këtë peshkopi është atje për të ndihmuar.

Unë dëshmoj se Perëndia jeton dhe se Jezusi është Shpëtimtari ynë. Ata të dy na duan shumë! ■

Autori jeton në Ouest, Haiti.



TË MËSOJTMË SIPAS MËNRYRËS SË ZOTIT



**Nga Plaku
Dejvid A. Bednar,**

i Kuorumit të
Dymbëdhjetë
Apostujve

Përshpejtimi që dëshiron Zoti për punën e Tij kërkon prej nesh që të mësojmë, të ndryshojmë dhe të bëjmë përpara me besim te Shpëtimtari vazhdimisht.

Një Model në Gjithçka

Në një zbulues të dhënë nëpërmjet Profetit Jozef Smith në qershor të vitit 1831, Zoti shpalli: “Unë do t’ju jap një model në gjithçka, që ju të mos mashtroheni; sepse Satani është përhapur në tokë dhe ai shkon duke i mashtruar kombet” (DeB 52:14).

Çuditërisht, Zoti na dha “një” model dhe jo “modelin” për gjithçka. Unë nuk besoj se me shprehjen “një model në gjithçka” Zoti po sugjeron se Ai ka vetëm një model për t’u përdorur në çdo situatë. Përkundrazi, mënyra e Zotit përfshin një sërë modelesh që mund

të përdoren për të arritur pikësynime të ndryshme shpirtërore.

Synimi ynë kryesor në çdo përvojë të të nxënimit dhe të mësimdhënies duhet të jetë për të përcaktuar dhe përdorur modelin ose modelet që i përmbushin më mirë nevojat tona dhe për t’i arritur rezultatet e dëshiruara të të mësuarit.

Fryma e Shenjtë Është Mësuesi

Fryma e Shenjtë është anëtar i tretë i Kreut-Perëndi dhe një Zbulues, një Mësues, një Ngushëllues, një Shenjtëruer dhe Ai na i kujton të gjitha gjërat (shih Gjoni 14:16–17, 26; 3 Nefi 27:20). Plaku Xhejms E. Talmixh (1862–1933), i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, shpjegoi: “Detyra e Frymës së Shenjtë për shërbesat e Tij mes njerëzve përshkruhet në shkrimet e shenjtja. Ai është një

Ftesa që i bëjmë Frymës së Shenjtë për të qenë mësuesi, është një qëllim kryesor në të gjitha modelet e Zotit për të mësuarin.



TË NXËNIT ME ANË TË BESIMIT KËRKON SI ZEMRËN, ASHTU EDHE NJË MENDJE TË GATSHME.



mësues i dërguar nga Ati; dhe atyre që e kanë të drejtën për udhëzimin e Tij, Ai do t'iu zbulojë të gjitha gjërat e nevojshme për përparimin e shpirtit.”¹ Ftesa që i bëjmë Frymës së Shenjtë për të qenë *mësuesi*, është një qëllim kryesor në të gjitha modelet e Zotit për të nxënëin dhe mësimdhënien.

Një nxënës që e ushtron lirinë morale të zgjedhjes dhe vepron sipas parimeve të drejta, ia hap zemrën e tij ose të saj Frymës së Shenjtë – dhe në këtë mënyrë fton fuqinë e Tij mësimdhënëse, dëshmuere dhe dëshmimin e Tij pohues. Mësimi me besim dhe me anë të tij kërkon ushtrim shpirtëror, mendor dhe fizik dhe jo thjesht pranim pa përpjekje. Me sinqeritetin dhe vendosmërinë e veprimit tonë të frymëzuar nga besimi, ne i tregojmë Atit tonë Qiellor dhe Birit të Tij, Jezu Krishtit, gatishmërinë tonë për të mësuar e për të marrë udhëzim nga Fryma e Shenjtë.

Shqyrtojini mënyrat se si misionarët i ndihmojnë kërkuesit për të mësuar me anë të besimit. Bërja dhe mbajtja e zotimeve shpirtërore, të tilla si studimi dhe lutja për Librin e Mormonit, zbatimimi i urdhërimeve dhe pjesëmarrja në

mbledhjet e Kishës, kërkojnë që një kërkues të ushtrojë besim dhe të veprojë. Ky parim gjithashtu gjen zbatim tek të gjithë anëtarët, duke përfshirë prindërit, mësuesit dhe udhëheqësit.

Mësimdhënia, këshillimi dhe shpjegimi – sado të rëndësishme që janë – nuk mund ta përçojnë kurrë te një kërkues/e, një fëmijë, një student/e apo një anëtar/e dëshminë për vërtetësinë e ungjillit të rivendosur. Vetëm atëherë kur besimi i tyre fillon të veprojë dhe hap shtegun e zemrës, Fryma e Shenjtë mund të japë dëshmi pohuese. Misionarët, prindërit, mësuesit dhe udhëheqësit patjetër duhet të mësojnë të japin mësim me anë të Shpirtit. Sidoqoftë, po aq e rëndësishme është edhe përgjegjësia që ata kanë për t'i ndihmuar të tjerët që të mësojnë për veten e tyre me anë të besimit.

Mënyra e të nxënëit që unë po përshkruaj shkon përtej kuptueshmërisë së thjeshtë mendore dhe ruajtjes dhe kujtimit të informacionit. Lloji i të nxënëit për të cilin po flas bën që ne të zgjohemi përpara Perëndisë (shih Alma 5:7), ta zhveshim njeriun e natyrshëm (shih Mosia 3:19), ta ndryshojmë

zemrën tonë (shih Mosia 5:2) dhe të kthehemi në besim te Zoti dhe të mos heqim dorë kurrë (shih Alma 23:6). Të mësuarit me anë të besimit kërkon si zemrën ashtu edhe një mendje të gatshme (shih DeB 64:34) dhe është merita e Frymës së Shenjtë që e përçon fuqinë e fjalës së Perëndisë drejt zemrës edhe brenda saj. Të nxënëit me anë të besimit nuk mund të kalohet nga një mësues te një student, nga një misionar te një kërkues, nëpërmjet një leksioni, një paraqitjeje me fakte apo një ushtrimi eksperimental; përkundrazi, një student/e duhet të ushtrojë besim dhe të veprojë me qëllim që të sigurojë njohuri për veten e tij ose të saj.

Një Model për Të Nxënëin dhe Mësimdhënien

1. Përgatituni të mësoni. Nëse merrni pjesë në orën mësimore të Shkollës të së Dielës dhe dëgjoni mësuesin tuaj të shpjegojë një temë, kjo është diçka e mirë. Por nëse keni punuar dhe jeni përgatitur, nëse po mendoni për gjërat që mësuesi juaj ju ka ftuar t'i lexoni, përsiatni dhe të luteni përpara orës mësimore, mund të ketë një derdhje të fuqishme të

Shpirtit dhe Fryma e Shenjtë bëhet mësuesi juaj. Përgatitja fton zbuluesën.

2. Ndërveproni që të lartësoheni. Dua t'jua tërheq vëmendjen te ky varg. "Caktoni mes jush një mësues dhe mos jini të gjithë zëdhënës në të njëjtën kohë; por njëri duhet të flasë në një kohë dhe të gjithë të dëgjojnë thëniet e tij, që kur të gjithë të kenë folur, të gjithë të jenë lartësuar prej gjithçkaje dhe që cilido të ketë një privilegj të barabartë" (DeB 88:122).

Ky është njëri nga modelet e fuqishme të Zotit për të nxënëin dhe mësimdhënien. Lejomëni t'ju sugjeroj një mënyrë tjetër këndvështrimi për këtë varg: "Caktoni mes jush një mësues". Kush është mësuesi? Fryma e Shenjtë. Nëse dëshironi që Fryma e Shenjtë të jetë mësuesi, atëherë a mund të ndodhë që "mos . . . të [flasin] të gjithë . . . në të njëjtën kohë; por njëri duhet të flasë në një kohë dhe të gjithë të dëgjojnë thëniet e tij, që kur të gjithë të kenë folur, të gjithë të jenë lartësuar prej gjithçkaje"? I vetmi që mund ta sigurojë atë lartësim është Fryma e Shenjtë.

Ndërveprimi për të lartësuar e fton zbuluesën. Tani në Kishë ne po mësojmë dhe zbatojmë modele gjithnjë e më shpirtërore, më të ndjeshme, më të rrepta dhe më kërkuese të të nxënëit dhe të mësimdhënies. A do të bëjmë gjithnjë atë që kemi bërë dhe të marrim të njëjtat rezultate që i kemi marrë gjithmonë apo do të pendohe mi, do të mësojmë, do të ndryshojmë e të japim mësim gjithnjë e më shumë sipas mënyrës së Zotit?

3. Ftojini që të veprojnë. Vetëm një pyetje e thjeshtë ndihmon që të arrihet ky synim. Çfarë do të bëni me

atë që keni mësuar? Të veprosh sipas zbuluesës, sjell më shumë zbuluesë.

Unë lutem që ta mbajmë të njëjtin ritëm me përsheptimin e Zotit, në mënyrë që të mos bëjmë vetëm atë që kemi bërë gjithnjë sipas mënyrës që e kemi bërë gjithmonë.

Unë shpall dëshminë time për vërtetësinë e gjallë të Zotit Jezu Krisht. Unë dëshmoj se Ai jeton. Ai është ringjallur. Ai qëndron në krye të kësaj Kisha dhe Ai i drejton çështjet e saj.

Ai po na kërkon të gjithëve që ta mbajmë ritmin njësoj me përsheptimin e Tij dhe t'i ndjekim modelet që Ai ka përgatitur për rritjen dhe të mësuarin tonë. ■

Nga një bisedë e dhënë në seminarin për presidentët e rinj të misioneve më 25 qershor 2014.

SHËNIM

1. James E. Talmage, *Articles of Faith*, bot. i 12-të (1924), f. 162.



PËRGATITJA FTON ZBULESËN.

5

MËNYRA PËR TË MËSUAR NGA KONFERENCA E PËRGJITHSHME

KONFERENCA E PËRGJITHSHME ËSHTË NJË MUNDËSI E SHKËLQYER PËR T'U


bashkuar me anëtarë të Kishës anembanë botës për të dëgjuar udhëheqësit e Kishës dhe për të marrë drejtim nga Zoti. Shikimi, dëgjimi dhe studimi i mesazheve të konferencës së përgjithshme do t'ju sjellë Shpirtin në jetën tuaj dhe do t'ju ndihmojë ta ndërtoni dëshminë tuaj. Kjo është një mundësi për ju që të merrni zbuluesë vetjake dhe të veproni sipas saj.

Ja tek janë pesë mënyra se si mund të mësoni nga konferenca e përgjithshme.

DETAJ NGA KRISHTI DHE SUNDËSITRI E IPASUR, NGA HEINRICH HOFMANN

1 SHKRUAJINI PYETJET TUAJA PËRPARA SE TË FILLOJË KONFERENCA E PËRGJITHSHME

Shpenzoni kohë për t'i shkruar pyetjet tuaja përpara se të fillojë konferenca dhe më pas kushtojuni vëmendje përgjigjeve që iu vijnë gjatë konferencës. Lutjet dhe pyetjet tuaja mund të marrin përgjigje ndërkohë që merrni pjesë dhe e dëgjoni Shpirtin.



2 KËRKONI TË MËSONI NGA KRISHTI

Profetët dëshmojnë dhe japin mësim rreth Shpëtimtarit (shih Veprat e Apostujve 10:43). Ndërsa i dëgjoni mesazhet e konferencave, ju mund të mendoni rreth asaj që po japin mësim folësit për Jezu Krishtin. Ju madje mund të bëni edhe një listë të shënimit tuaja.



Ju e keni aftësinë të merrni zbulësë dhe të veproni sipas saj pa frikë.

Presidenti Henri B. Ajring, "Zoti e Udhëheq Kishën e Tij", konferenca e përgjithshme e tetorit 2017

3

DËGJOJINI ME KUJDES TEMAT

Pasi të keni parë një pjesë të konferencës së përgjithshme, ju mund të vëreni se keni dëgjuar një tematikë ose temë që është përmendur më shumë se një herë. Modelet që vëreni mund të jenë një mënyrë se si ju ndihmon Shpirti të kuptoni diçka që ju duhet ta mësoni.



4

MBANI SHËNIME PËR LIBRIN E MORMONIT

Ju mund të mësoni shumë duke u kushtuar vëmendje shkrimeve të shenjta që përmenden nga udhëheqësit e Kishës, veçanërisht Librit të Mormonit, i cili është "gurthemeli i besimit tonë" (parathënia e Librit të Mormonit). Shihni nëse mund të arrini ta dëgjoni çdo herë që ai përmendet në konferencën e përgjithshme. Ju do të habiteni nga ajo që do të zbuloni!

5

KINI SHTYSA DHE JINI TË FRYMËZUAR PËR TË VEPRUAR

Shkruani mesazhe dhe citate që ju frymëzojnë ose ju ftojnë të veproni. Kjo mund t'ju ndihmojë ta zbatoni atë që mësoni – dhe ju ndihmon të mbani mend se çfarë mendimesh kishit, kur do t'ju duhet të kujtoheni më vonë! ■



Mësimi me besim dhe me anë të tij kërkon ushtrim shpirtëror, mendor dhe fizik dhe jo thjesht pranim pa përpjekje.

Plaku Dejvid A. Bednar, "Të Mësojmë Sipas Mënyrës së Zotit", në faqen 50 të këtij botimi

MORËM MËSIM NGA FRYMA E SHENJTË

Kjo rini u përgatit që të mësohej nga Shpirti përpara konferencës së përgjithshme. Ja se çfarë mësuan ata nga një konferencë e kaluar dhe çfarë po bëjnë ndryshe për shkak të saj.



Udhëzim i Frymëzuar

U frymëzova nga konferenca e përgjithshme. Ndërkohë që po i dëgjoja udhëzimet nga udhëheqësit tanë për t'u shërbyer të tjerëve, për t'i mirëbesuar Krishtit dhe për t'u mbajtur fort në shufrën e hekurit, e ndjeva Frymën e Shenjtë që më dëshmoi se ky ungjill është i vërtetë dhe se ne mund të marrim jetë të përvetshme duke i mbajtur urdhërimet dhe duke e ndjekur fjalën e Perëndisë. Unë kam vendosur synime për të qenë më shumë në shërbim të komunitetit tim dhe për ta forcuar dëshminë time nëpërmjet lutjes së përditshme dhe studimit të shkrimeve të shenjta. E di se jam një bijë e Atit Qiellor. Ai jeton dhe më do gjithmonë e përgjithmonë.

Medlin B., moshë 16 vjeçe, Delauer, SHBA

Rreth saj: Më e madhja nga tre vëllezërit e motrat; i bie vendit kryq e tërthor; i pëlqen të lexojë dhe të këndojë; i pëlqen shumë spanjishtja dhe shpreson ta japë mësim anglishten si gjuhë të dytë




Përgjigje për Pyetjet

Përpara konferencës së përgjithshme unë kisha dy pyetje: 1) Si mund të mbaj një qëndrim të mirë dhe si t'i ndihmoj shokët e mi kur marrin vendime të këqija? dhe 2) Si mund të dëshmoj për Kishën pa u tallur të tjerët me mua? Gjatë konferencës, Shpirti më dëshmoi se nuk jam vetëm. Tani e di se duke i studiuar shkrimet e shenjta me gjithë zemër, unë do të marr përgjigje për pyetjet e mia rreth shokëve të mi. Unë e di se Ati im i dëgjon lutjet e mia dhe do të përpiqem të jem më i mirë çdo ditë.

Isak R., moshë 13 vjeç, Piçinka, Ekuator

Rreth tij: Fëmijë i vetëm; i pëlqen të luajë piano, të rrëshqasë me patina, të luajë futboll, të merret me xhudo, të notojë, të këndojë dhe të përgatitë karamelle; dëshiron të bëhet doktor; ngjyra e parapëlqyer është e gjelbërta






Ftesa për t'u Rritur

Konferenca e përgjithshme më forcoi me dëshirën për ta ndjekur shtegun e ungjillit të Jezu Krishtit. Më ndihmoi të di dhe të kuptoj se kjo është Kisha e vërtetë, e cila na sjell dritë dhe lumturi. E ndjeva Shpirtin të më ftonte për t'u rritur çdo ditë dhe për të lexuar Librin e Mormonit për të marrë një dëshmi të fortë për ungjillin. Unë e besoj se Ati im Qiellor dëshironte që unë t'i dëgjoja këto mesazhe të frymëzuara.

Visente A., moshë 16 vjeç, Rajoni Metropolitan, Kili



Rreth tij: Më i madhi nga katër vëllezërit e motrat; i pëlqen shumë të luajë lojëra në kompjuter, të dëgjojë muzikë dhe të luajë futboll; merr pjesë në teatër; dëshiron të shërbejë në një mision




Të Përgatitur për të Mësuar

Unë e ndiej Shpirtin kaq fort në konferencën e përgjithshme. Qëkurse kam filluar të përgatit pyetje dhe ta përgatit veten shpirtërisht për konferencë, ka sjellë një kuptim krejt tjetër në jetën time dhe kam qenë në gjendje të mësoj shumë më tepër nga çdo bisedë. Jam shumë mirënjohës për profetin dhe apostujt dhe e di se ata janë dërguar nga Ati Qiellor për të na drejtuar dhe udhërrëfyer në jetën tonë!

Beni H., moshë 17 vjeç, Kentaki, SHBA

Rreth tij: I pëlqejnë shumë sportet; luan basketboll dhe tenis në shkollë; i pëlqen shumë të bëjë ski, të rrëshqasë me dërrasë në dëborë, të udhëtojë dhe të bëjë alpinizëm



Kërkimi i Dritës

Vit sfidues për mua ishte ai i para dy viteve. Im atë po luftonte me kancerin dhe pati sulme terroriste në qytetin tonë. Po mundohesha nga ankthi, duke vrarë mendjen se si mund të ndieja paqe kur kisha frikë për sigurinë time shpirtërore dhe fizike. Nga konferenca e përgjithshme mësova se ne mund të gjejmë paqe ndërsa jetojmë në mënyrë të virtytshme, e mbushim zemrën me besim dhe mbajmë një këndvështrim të përjetshëm. U frymëzova që të kthehesha te Krishti në kohë vështirësie, në vend që të varesha te kuptueshmëria ime vetjake. Unë e di se mund t'i mposht ndikimet e errësirës duke kërkuar ndriçimin e dritës së Krishtit.

Olivia H., moshë 17 vjeçe, Belgjikë

Rreth saj: Notare; i pëlqen shërbimi, përfshirë edhe shërbimin vullnetar në një mensë për të varfrit, në një shtëpi birësimi dhe në programin e shkollës së saj për edukimin e fëmijëve me nevojë të veçanta

“ANËTARË TË RINJ NË
MOSHË TË KISHËS,

JU PREMTOJ

SE, NËSE DO TA

DËGJONI

[KONFERENCËN E PËRGJITHSHME],

JU DO TA NDIENI SHPIRTIN TË
RRITET BRENDA JUSH. ZOTI DO T’JU
TREGOJË SE ÇFARË DËSHIRON AI
QË JU TË BËNI ME JETËN TUAJ.”

Plaku Robert D. Hejls, (1932–2017)
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve,
“Konferenca e Përgjithshme: Forcimi i Besimit dhe i Dëshmisë”,
konferenca e përgjithshme e tetorit 2013

Fakte rreth KONFERENCËS SË PËRGJITHSHME

Organoja e Qendrës së Konferencave ka

7 667

gypa – por vetëm rreth 170 gypa mund të shihen nga salla

Presidenti Rasëll M. Nelson ka dhënë

84

biseda konference të përgjithshme në 34 vitet e tij si Autoriteti i Përgjithshëm

Njerëz në

221

vende dhe territore ndjekin konferencën e përgjithshme




Bisedat përkthehen në

94

gjuhë



Foltorja e Qendrës së Konferencave është bërë prej drurit të arrës së vjetër **TË PRESIDENTIT GORDON B. HINKLI** (1910–2008).



Mbi


100 000

njerëz marrin pjesë në pesë sesione në Qendrën e Konferencave në Solt-Lejksiti, Juta, SHBA

Salla e Qendrës së Konferencave mund të nxërë një

AEROPLAN BOEING 747

– me gjatësi rreth 70.5 m



Në çdo konferencë jepen rreth

35

biseda



NJOFTIME TË RËNDËSISHME TË BËRA GJATË KONFERENCAVE TË PËRGJITHSHME:


SHTATOR 1995:
“Familja: Një Proklamata drejtuar Botës”

PRILL 1998:
Ndërtimi i tempujve më të vegjël

PRILL 2001:
Filloi Fondi i Qarkullueshëm Arsimor

TETOR 2012:
U ul mosha e misionarëve

PRILL 2018:
Dhënia e shërbesës zëvendëson vizitat e shtëpisë dhe vizitat mësimore



“Si mund ta ftoj Shpirtin në shtëpinë time kur njerëzit janë duke u grindur apo debatuar?”

JINI PAQEBËRËS

“Kur nuk jemi në gjendje ta ndryshojmë sjelljen e të tjerëve, ne do të vazhdojmë me detyrën e vetëqeverisjes në mënyrën e duhur...”

Në vende ku ka debate dhe mosmarrëveshje ndërmyjet pjesëtarëve të familjes, detyra jonë është të ndërtojmë, të dëgjojmë dhe të arsyetojmë së bashku.”

Plaku Marvin J. Ashton, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve (1915-1994), “No Time for Contention”, konferenca e përgjithshme e prillit 1978.



Thoni Më Vjen Keq

Kur kam debatuar me dikë, kam kuptuar se të thuash më vjen keq dhe ta pranosh se e ke gabim, edhe kur mendoni

apo e dini se keni të drejtë, ndihmon për të sjellë sërish paqe në dhomë. Më pas largohuni, heshtni, ndërroni temë ose gjeni diçka për të cilën bini dakord. Nuk zgjat shumë që Shpirti të kthehet sërish.

Dilan M., moshë 15 vjeç, Kaliforni, SHBA

Veçse Dashuri

Unë kam zbuluar se shfaqja e dashurisë së pastër familjes sime, e fton Shpirtin të banojë në shtëpinë tonë. Profeti foli për dashurinë si katalizatori që sjell ndryshimin dhe balsami që i sjell shërim shpirtit. Një shpirt dashurie sjell siguri dhe paqe në shtëpi.

Jozef C., moshë 18 vjeç, Arizona, SHBA

Flisni me Familjen Tuaj

Nëse familja juaj nuk është anëtare e Kishës, tregojuni atyre se sa keq ndiheni kur ata grinden dhe kërkojuni që të përmirësohen. Nëse kjo nuk funksionon, lutuni dhe provojeni sërish. Nëse ata janë anëtarë, kujtojuni atyre se janë fëmijë të Perëndisë dhe se ata duhet t'i shmangin zënkat.

Karolina S., moshë 19 vjeçe, Goja, Brazil



Lutuni që të Keni Shpirtin

Sa herë që familjarët përreth debatojnë, është e vështirë ta ndieni praninë e Shpirtit, por kjo nuk do të thotë që nuk do të jeni në gjendje ta ndieni nëse jeni i denjë. Bëni një lutje në zemër për një masë të shtuar të Shpirtit të Zotit dhe kush-tojuni vëmendje të veçantë nxitjeve që iu vijnë. Ati Qiellor mund t'ju ndihmojë të ndieni paqe dhe të dini se si t'i ndihmoni më mirë për ta sjellë atë paqe në shtëpinë tuaj.

Kejti G., moshë 17 vjeçe, Juta, SHBA

Përpiqu të Merresh Vesh

Bisedoni me familjen tuaj për ta zgjidhur problemin në një mënyrë që çdokush mund të përfitojë ose thoni një shkrim të shenjtë apo këndonin një himn. Ju mund t'i kërkoni gjithashtu Atit Qiellor ndihmë që ta zgjidhni problemin. Në këtë mënyrë, çdokush do të qetësohet dhe të jetë në gjendje ta zgjidhë problemin pa qenë nevoja për britma apo dhunë. Pa dyshim, Shpirti i Shenjtë do t'ju mbushë të gjithëve me paqe dhe do t'i japë gjithkujt dëshirën për të mos u grindur prapë.

Luis F., moshë 14 vjeç, Plaja del Karmen, Meksikë

Përgjigjet synojnë të japin ndihmë dhe këndvështrim, jo që të jenë deklarata zyrtare për doktrinën e Kishës.



A është një dëshmi më shumë se thjesht ndjenja?

Një dëshmi është ajo për të cilën po fliste Shpëtimtari kur i tha Pjetrit: “Këtë nuk ta zbuloi as mishi as gjaku, por Ati im që është në qiej” (Mateu 16:17). Ajo është njohuri nga Perëndia që zbulohet nëpërmjet Frymës së Shenjtë.

Fryma e Shenjtë flet me një zë të cilin më shumë e ndiejmë sesa e dëgjojmë, por ai vjen si “në mendjen tënde dhe në zemrën tënde” (DeB 8:2; theksimi i shtuar) - te mendimet tona si dhe te ndjenjat tona.

Profeti Jozef Smith e përshkroi shpirtin e zbulesës si një ndjenjë e “inteligjencë[s së] pastër [q]ë rrjedhë tek ju, [duke ju dhënë] befas ide” (Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith [2009], f. 136).

Kur ne i drejtojmë mendjen dhe zemrën tonë - mendimet, ndjenjat dhe dëshirat tona - te Perëndia, Ai mund t'i flasë mendjes dhe zemrës sonë me zërin e vogël e të qetë të Frymës së Shenjtë. Ndërsa Ai e kaplon shpirtin tonë, duket se vërshojnë në mendjen tonë disa ndjenja dhe mendime të caktuara. Kjo është dëshmia që Ai na jep.

Çfarë Mendon Ti?

“Si të gjej miq me standarde të mira?”

Dërgojeni përgjigjen tuaj dhe, nëse dëshironi, një fotografi me rezolucion të lartë deri më 15 nëntor 2018 te liahona.lds.org (klikoni te “Submit an Article” [“Dorëzoni një Artikull”]).

Përgjigjet mund të redaktohen në varësi të gjatësisë apo qartësisë.

Shtigje Që Ju Përgatitin për të Ardhmen Tuaj

Nga **Lea Barton**

Revistat e Kishës

Nuk mendoj se është ëndrra e ndonjë vajze 14-vjeçare të jetë në një stallë me pluhur, të ngrëjë një lopatë të ndryshkur, të pastrojë një stallë kuajsh që kundërmon. Por unë shkova atje pas shkollë çdo ditë derisa qeshë mjaft e rritur për të pasur një punë tjetër.

Sigurisht që nuk ishte situata ime ideale të punoja gjatë shkollës së mesme, por e kuptova atëherë se po të doja ndonjëherë një punë që vërtet më pëlqente – një që nuk përfshinte pastrimin e jashtëqitjes së kafshëve – më duhej kolegji e që të shkoja në kolegji, më duheshin para. E dija se për mua, arsimi ishte hapi i duhur drejt (me shpresë) një karriere përmbushëse.

E bukura është se shtegu që zgjodha është vetëm një prej shtigjeve që mund t'ju ndihmojnë të mësoni të punoni e të siguronin për nevojat tuaja. Kjo quhet të bëheni materialisht dhe shpirtërisht të mbështetur te vetja. Kur i shqyrtoni mundësitë që keni, përpiquini të zgjidhni shtegun që ndieni se do t'ju përgatitë më mirë.

Këto histori janë nga njerëz që ishin në moshën tuaj vetëm disa vite më parë. Duke ndjekur shembujt e këtyre të rinjve në moshë madhore, ju mund të gjeni shtegun drejt një mbështetjeje të suksesshme te vetja.

SHQYRTOJINI NEVOJAT PËRRETH JUSH

Nga **Oudom Piseth, Kamboxhia**

Me qëllim që t'i arrij synimet e mia, gjithmonë i them vetes se puna e palodhur ka shumë rëndësi, por një mënyrë tjetër për të shkëlqyer është puna me zgjuarsin.

Pas misionit tim në Angli, unë u ktheva në Kamboxhia dhe i hodha një sy tregut të punës. Pashë gjëra të tilla si kohëzgjatja e trajnimit për marrjen e secilës punë dhe kostoja e trajnimit.

Mësova se programi i trajnimit për tregtar veshjesh ishte i shkurtër, por sfidues dhe nuk po e bënin shumë njerëz. Pashë se ishte një mundësi e mirë dhe vendosa ta bëj. Unë e kam mbaruar programin tani dhe po punoj si tregtar për një kompani veshjesh.

Gjetja e karrierës së duhur mund të jetë shumë e vështirë, por kam Shpëtimtarin që më ndihmon e më ngre moralisht.



Nëse shkoni në kolegji, kërkoni punësim apo mësoni një zana, ju po zhvilloni një cilësi që është thelbësore për ndërtimin e mbretërisë së Perëndisë.

PËRDORENI ARSIMIN PËR TË HAPUR DYER

Nga Iolanda Teisheira, Kepi i Gjelbër, Afrikë

Mami im gjithmonë më ka nxitur me fjalët: “Arsimi është çelësi drejt suksesit”. Unë doja një të ardhme më të mirë për veten dhe veçanërisht për familjen time dhe, për ta bërë këtë, duhej të vazhdoja shkollimin. Pa para për të shkuar në kolegji në atë kohë, bërë kërkesë për bursë që të futesha në një shkollë profesionale për studimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve kompjuterike.

Gjatë gjithë studimeve të mia u përballa me sfida të ndryshme, por kjo nuk më ndaloi nga ecja përpara me sytë e ngulur drejt ditëve më të mira. Lutja më ndihmoi shumë; unë gjithmonë kërkoj këshillë nga Zoti. Kam qenë gjithmonë i përkushtuar ndaj studimeve të mia, dhe sot unë qëndroj i përkushtuar ndaj punës sime, duke dhënë më të mirën si teknik kompjuteri dhe ndihmës marketingu.



PUNO TANI PËR TË ARDHMEN QË DO

Nga Ana-Sofia dhe Lorenc Kavin, Skoci, Mbretëri e Bashkuar

Ana-Sofia: Unë gjithmonë doja të studioja në universitet, por planet se për çfarë do të studioja ndryshuan shumë në vitet e adoleshencës sime. Pasi mbarova shkollën e mesme, shkova vullnetare për gjashtë muaj në një spital. Qysh atëherë më pëlqente ideja e të qenit infermiere, por nuk mendoja se do të isha në gjendje ta bëja.

Në klasën e mbështetjes te vetja në lagjen time, neve na u kërkua të zgjidhnim një punë që do të na pëlqente ta kishim edhe pse mund të mos i kishim kualifikimet. Unë u luta se çfarë të bëja dhe infermieria vijonte të më vinte në mendje. Vendosa të ndjek nxitjet nga Zoti.

Ndjekja e këtij shtegu nuk ka qenë i lehtë. Për të filluar, unë shqyrtova programin e infermierisë dhe çfarë do të më duhej të studioja. Fola me njerëz që kishin kaluar në një proces të ngjashëm. Herën e parë që bëra kërkesë për programin e infermierisë, më vunë në listën e pritjes. Por



nuk hoqa dorë; bëra kërkesë përsëri e përfundimisht hyra. Ndonjëherë duhet të jesh i durueshëm dhe t'i mirëbesosh Zotit pasi Ai ka planin e Tij për ty.



Lorenci: Kur isha më i ri, vura si qëllim që të isha më i miri që mund të isha pavarësisht nga lënda që studioja apo puna që kisha. Gjithnjë mundohesha të mësoja e të përmirësohesha për t'i dhënë vetes mundësinë më të mirë për sukses.

Aktualisht unë punoj si administrator për një kompani veshjesh, por dua t'i bashkohem forcave të policisë. Në Skoci, duhet të jetosh në vend për tre vite radhazi përpara se të bësh kërkesë për të hyrë në polici. Ngaqë isha jashtë vendit për dy vjet duke shërbyer një mision, më duhet të pres edhe disa muaj para se të hyj.

Edhe pse kjo ka qenë një pengesë e madhe, nuk jam dorëzuar. Kam një punë të mirë për të mbajtur familjen time dhe kam punuar fort për t'u siguruar se do të marr një rekomandim të mirë për punë të ardhshme.



ZBULIMI I SHTEGUT TUAJ

Si këta të rinj të moshave madhore, ju do të shihni se udhë të ndryshme mund t'ju përgatitin për t'u kujdesur për veten dhe familjen tuaj të ardhme. Me atë qëllim në mendje ju mund të planifikoni për sukses. Plaku Diter F. Uhtdorf i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve dha mësim: "Le të bëjmë më të mirën që mundemi dhe të rritim një nam për cilësi të shkëlqyera në çdo gjë që bëjmë. Le t'i kthejmë mendjet dhe trupat tanë tek mundësia e lavdishme për punë që paraqet çdo ditë e re" ("Dy Parime për Cilëndo Ekonomi", konferenca e përgjithshme e tetorit 2009). Ndërsa përqendrohemi tani tek të nxënit e të punuarit, ju do të krijoni zakone që do t'ju ndihmojnë të ndiheni më të sigurt rreth së ardhmes. ■

Shënim i redaktorit: Merrni parasysh t'i kërkoni peshkopit tuaj t'ju njohë me specialistët e mbështetjes te vetja në kunjin tuaj. Ata mund t'ju ndihmojnë të zbuloni mundësi për arsimin dhe punën tuaj të ardhshme.

1.

NJIHANI VETEN TUAJ

Për çfarë jeni i zotë? Çfarë ju pëlqen të bëni? Përgjigjja e këtyre pyetjeve mund t'ju ndihmojë të gjeni një karrierë të mundshme që përshtatet me çfarëdo zotësish, interesash dhe talentesh që i keni tashmë.

SUGJERIM: Merrni parasysh t'i pyetni prindërit, mësuesit dhe miqtë tuaj se çfarë talentesh shohin te ju. Ju mund të befasoheni nga ajo që thonë ata!

2.

NJIHANI BOTËN PËRRETH JUSH

Çfarë punësh kërkohen atje ku jetoni ju? Cilat kompani po marrin njerëz në punë? Është gjë e mençur të zgjedhësh një udhë karriere në një sektor që po zhvillohet e me gjasa do të ketë mundësi në të ardhmen.

SUGJERIM: Kolegjet, universitetet apo shkollat profesionale shpesh e dinë çfarë zotësish kërkohen dhe cilat industri po rriten.

3.

DIJENI ATË ÇKA DUHET TË BËNI MË PAS

Çfarë përgatitjeje kërkohet për punën që doni ju? Ku do ta merrni trajnimin dhe arsimin që ju nevojitet? Si do të paguani për të? Për të arritur një synim afatgjatë karriere do t'ju duhet të dini se si të arrini atje.

SUGJERIM: Merrni parasysh të flisni me dikë që po bën tashmë atë që doni të bëni ju. Bëjuni pyetje atyre. Shumicës së njerëzve u pëlqen të japin këshilla e sugjerime.

Përcilleni Dashurinë e Perëndisë

All Files were inaccessibile.



Nga Elli B., 12 vjeçe, Kentaki, SHBA

Pak më parë, unë dhe familja ime u shpërngulëm në Kentaki. Isha vërtet e mërzhitur sepse po lija pas të gjithë miqtë dhe të afërmit e mi.

Kentaki ishte shumë ndryshe nga ajo me të cilën isha mësuar. Herën e parë që shkova në kishë pashë se nuk kishte shumë njerëz. Kur kuptova sa e vogël ishte dega ime, vendosa se në vend që të mendoja keq rreth saj, do të bëja diçka rreth saj.


Të nesërmen, unë dhe mami shkuam në dyqan. Përpara se të dilnim nga shtëpia, mora një tufë kartash për shpërndarje. Kur shkuam në dyqan, unë mora një shufër me karamelë dhe vajta të paguaja. Arkëtarja e kaloi karamelen në pajisjen e verifikimit, pastaj ma dha. Unë ia riktheva. Ajo vështroi e hutuar dhe tha: “Ti sapo pagove për këtë, zonjushë.”

Unë thashë: “E di, por po jua jap si dhuratë.” Pastaj vura edhe një kartë për shpërndarje me karamelen. Ajo buzëqeshi dhe më falënderoi. Ajo vështroi prapa kartës për shpërndarje, ku pata shkruar: “Gjithkush është një fëmijë i Perëndisë”. Unë u largova e lumtur, duke ditur që edhe nëse ajo nuk do t’i bashkohej Kishës, unë prapëseprapë bëra diçka të mirë.

Më vonë atë ditë, u kujtova që e lashë pjesën tjetër të kartave për shpërndarje pranë arkës! Herën tjetër që shkuam në dyqan, vajta për të pyetur nëse ato ishin ende atje. Pastaj pashë diçka dhe ndala hapat. Gati pesë prej arkave kishin karta për shpërndarje që thoshin: “Gjithkush është një fëmijë i Perëndisë”. Arkëtarja i kishte shpërndarë ato! U ndjeva aq e lumtur për atë që bëra. ■



Lutje në Kanion



Nga Karsen K., moshë 11 vjeç, Juta, SHBA

Vitin e kaluar bëra një ecje në natyrë me babanë dhe vëllanë tim. Ecëm thellë nëpër kanion. Shpejt filluam të eksploronim një shteg anësor. Gjetëm shpella të mëdha dhe pika vrojtimi të shkëlqyera. U ngjitëm lart e më lart mbi gurë të lëvizshëm dhe kodra të pjerrëta.

Pas njëfarë kohe kishim humbur tërësisht. Nuk dinim nga cila udhë të shkonim për të vajtur në shtratin e kanionit. Ngecëm në një shkurnajë duke humbur nga sytë si majën edhe shtratin e kanionit. Fillova të acarohesha me të vërtetë. Nuk e dija ku të shkoja; as babai im s'e dinte!

Po bëhej errësirë dhe ftohtë dhe ne ishim larg daljes

nga kanioni. E dija që Ati Qiellor e dinte se cilën udhë të merrnim.

Thashë: "Nëse duam të dalim prej këtej, ne duhet të lutemi!" Kështu që të tre u gjuhëzuam në lutje, duke i kërkuar Atit Qiellor të na udhëhiqte për të dalë nga kanioni.

Kur filluam të ecnim, një ndjesi më tha që kur të shihja një pemë të drejtë të lartë, duhej të kthehesha majtas. Pasi u ktheva majtas, unë pashë makinën tonë. Unë e dija se Ati Qiellor na ndihmoi të dilnim nga kanioni. Ati Qiellor iu përgjigj lutjes sonë, dhe ne ia dolëm mbanë të sigurt – pikërisht kur dielli po perëndonte.

Sa mirënjohës jam për fuqinë e lutjes dhe për Atin Qiellor që dëgjon. ■

Të Shndritësh Fort në Republikën Çeke

Përpiluar nga Sheron Gudriçi, Revistat e Kishës

Ne jemi fëmijë të Fillores në Republikën Çeke. Ja se si shkëlqejmë ne fort në vendin tonë.

Një herë më humbi dorashka e parapëlqyer. U trishtova shumë. Unë dhe nëna ime u lutëm, por nuk e gjetëm. U përpoqa të kisha besim. Një javë më vonë, vëllai im i vogël e gjeti dorashkën time në rrugë! Perëndia u përgjigjet lutjeve tona. Unë e dua Atë dhe e di se Ai jeton.

Andre W., moshë 9 vjeç



Unë kam shokë në shkollë që nuk janë anëtarë të Kishës, por që prapëseprapë i respektojnë standardet e mia. Një herë thashë se duhej të luteshim, ata ranë dakord! U gëzova shumë.

Ivana A., moshë 11 vjeçe



Unë dhe shokët e mi po zbritnim shkallët. Kur mbërritëm tek ashensori, unë pata një ndjenjë shqetësuese dhe i kërkova shokëve që të mos e përdornin. Gjithsesi, ata vendosën të hipnin. Unë zbrita nga shkallët. Kur mbërrita poshtë, shokët e mi



nuk ishin aty. Ashensori kishte ngecur! Iu desh pak kohë që të dilnin jashtë. U gëzova që nuk ndodhi asgjë e rëndë. Gjithashtu, u ndjeva mirë që e ndoqa Frymën e Shenjtë.

Amali N., moshë 10 vjeçe

Në plazh, qielli filloi të errësohej. Fryu erë dhe krijoi dallgë gjigante! Pati gjëmime, vetëtima dhe breshër. Gjithkush vrapoi për të gjetur një strehë. Ne nuk u dëmtuam nga stuhia. Gjatë rrugës për në shtëpi, ne pamë tri ylberë. Ne e dimë se Perëndia na ndihmoi dhe na mbrojti.

Xhekub B., mosha 10 vjeç



Në shkollë kam një shoqe me të cilën askush tjetër nuk do që të shoqërohet. Fëmijët e tjerë filluan t'i thonin asaj gjëra të pahijshme që e bënë atë të ndihej e

shëmтуar. I tregova mësueses sime dhe e ftova shoqen time të luante me mua. Kjo gjë e gëzoi shoqen time!

Ludmilla V., mosha 8 vjeçe



Unë u zemërova me mamën tim ngaqë nuk doja të lahesha dhe të shkoja në shtrat. Ditën tjetër isha e trishtuar për shkak të zgjedhjes sime të keqe. Mami im tha se mund të luteshim dhe t'i kërkonim Atit Qiellor që të na falte. Ne u gjuhëzuam dhe u lutëm. U ndjeva më mirë. Unë mësova se ne mund të pendohejmë dhe për shkak të Jezut Krishtit, të falemi.

Samuel H., mosha 5 vjeç



Unë dhashë dëshminë time në kishë. U desh guxim! Që nga ajo kohë, unë e kam ndier Shpirtin.

Eliska K., mosha 11 vjeçe



Kur kavia ime u sëmur, unë u luta për të. Jam mirënjohëse ndaj Atit Qiellor që na ndihmoi.

Aneta P., mosha 10 vjeçe



NA DËRGO NJË YLL!



Pothuajse po ia dalim t'i mbledhim yjet! Nëse nuk e keni dërguar ende një yll, nxitoni dhe na e dërgoni me mesazh elektronik një fotografi të yllit tuaj me historinë, fotografinë tuaj dhe lejen e prindërve në liahona@ldschurch.org.



“Unë dëshmoj për Të, Shëlbuesin e botës dhe Mësuesin e të gjithëve ne. Ai është Biri i Vetëmlinduri i Perëndisë së gjallë.”



Nga Plaku Xhefri R. Holland,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve
“Miracles of the Restoration”, Ensign, nëntor 1994, f. 34.

Faqja Jonë



Kur shkoj në kishë, unë ndiej Shpirtin e Perëndisë dhe dashurinë që kam për Të dhe për Shpëtimtarin tim, Jezu Krishtin. E dua Shëlbuesin tim.

Ajana B., 7 vjeçe, Francë




Më pëlqen shumë të shkoj në tempull me familjen time. Është një vend i bukur, ku do të mund të shkoj kur të jem 12 vjeçe. Është shtëpia e Zotit.

Aldo C., 10 vjeç, Meksikë



"Presidenti Monson dhe këshilltarët e tij"
Omar A., 9 vjeç, Peru



Mua më pëlqen ta ndaj ungjillin në shkollë me miqtë e mi, sidomos me një djalë që ka vështirësi në të folur, në shkrim dhe lexim. Një mënyrë për ta ndarë ungjillin sikurse na mësoi Jezu Krishti, është duke i ndihmuar e duke u shërbyer të tjerëve. Kurdo që mësuesi na jep një detyrë në librin e detyrave të shtëpisë, unë jam gjithmonë gati ta ndihmoj këtë djalë. Më pëlqen shumë t'u shërbej të tjerëve sepse kjo më ndihmon të ndiej dashurinë e Atit tim Qiellor.

Alison M., 10 vjeçe, El Salvador

Shpresë në Holandë

Nga Megan Armkneht

Bazuar në një ngjarje të vërtetë

Grejsi është një vajzë 15-vjeçare që jetonte në Holandë gjatë Luftës II Botërore. Lufta vazhdoi për një kohë të gjatë. Njerëzit në Holandë po vuani urie dhe shpresonin që lufta do të mbaronte shpejt.

Viti i fundit i Luftës II Botërore ishte më i keq për Holandën. Nazistët morën absolutisht çdo gjë. Grejsi nuk mund të shkonte në shkollë. Nuk kishte qymyr për të ngrohur shtëpinë.

Grejsi dhe familja e saj duhej të hanin gonxhe tulipani për t'i shpëtuar vdekjes. Ato kishin një shije të *tmerrshme!* Më e keqja, babai ishte ende rob lufte.

Por kishte shpresë. Njerëzit thoshin se nazistët po e humbnin luftën. Dhe në maj të vitit 1945, nazistët u dorëzuan. Holanda më në fund ishte përsëri e lirë! Njerëzit festonin nëpër rrugë. Tani Grejsi mund të shkonte përsëri në shkollë. Nuk kishte ushtarë nga të cilët të trembej.

Dhe gjëja më e bukur, një ditë kur Grejsi dhe vëllezërit e saj po ktheheshin nga shkolla, panë se flamuri i Holandës po valëvitej përpara shtëpisë së tyre. Ata e dinin se kjo mund të tregonte vetëm një gjë.

“Babi është në shtëpi!”, bërtiti Heberi.

Grejsi dhe vëllezërit e saj u futën brenda me vrap. Grejsi i hodhi krahët babit në qafë dhe e përqafoi fort. Ai ia ktheu duke e shtrënguar në kraharor. Ishte e mrekullueshme ta kishte babanë në shtëpi.

Shpejt pas kësaj, në Holandë filluan të mbërrinin pako me ushqime, veshje dhe ilaçe. Udhëheqësit e Kishës në



Solt-Lejk-Siti dërguan plot furnizime për t'i ndihmuar njerëzit pas luftës.

Grejsi mori madje një fustan të ri! Asaj i ishte dashur të vishte të njëjtin fustan për pesë vite, prandaj ishte shumë e lumtur që kishte një të ri.

Për herë të parë ndër vite, Grejsi kishte mjaft për të ngrënë. Presidenca e misionit dhe qeveria e Holandës vendosën të fillonin një projekt patatesh për të prodhuar më shumë ushqim. Anëtarët e Kishës mbollën mjaft patate në fushat pranë. Nga vjeshta ata do të kishin mijëra patate për të ngrënë.

“Shiko!”, i tha Grejsi babit, duke treguar me gisht një bimë patatesh në rritje. “Nuk do të jemi kurrë më të uritur!”

Babi tundi kokën, por nuk buzëqeshi. Ai tha: “Po flisja me Presidentin Zapej. Më tha se shenjtorët e ditëve të mëvonshme në Gjermani ende po vuajnë urie, njësoj siç vuanim ne. Ata nuk po marrin ndihmë si ne nga qeveria.” Babi hodhi krahun rreth shpatullave të Grejsit. “Presidenti Zapej ka pyetur a do t’ua jepnim patatet tona shenjtorëve gjermanë.”

“T’i japim patatet tona!”, thirri Grejsi. Por *nazistët* ishin nga Gjermania! Ata mund të jenë shenjtorë të ditëve të mëvonshme, babi, por ata prapë gjermanë janë.”

“E di, nuk është e lehtë”, tha babi. “Por edhe ata janë fëmijë të Perëndisë. Ai i do edhe ata. Unë i fala ata që më mbajtën rob lufte. Zoti mund të na ndihmojë të gjithë që të falim.”



Grejsi ngriti sytë nga babi. Ai ishte personi më i guximshëm që njihje, por nuk e dinte nëse ajo vetë e kishte guximin për të falur si ai. Atëherë ajo solli ndër mend një nga mësuesit e saj në shkollë gjatë luftës. Mësuesi i saj pati thënë se jo të gjithë gjermanët qenë nazistë, dhe jo të gjithë ushtarët nazistë ishin të këqij. Dhe tani vajzat dhe djemtë në Gjermani po vuanin urie, ashtu siç kishte vuajtur Grejsi.

Grejsi mori frymë thellë. “E kuptoj”, tha ajo. “Le t’ua japim atyre patatet tona.”

Babi e përqafoi dhe buzëqeshi. “Ti je një vajzë kaq trime. Kjo është diçka e vështirë për t’u bërë. Por ne jemi dishepuj të Jezu Krishtit dhe po kështu janë vëllezërit e motrat tona gjermane.”

Grejsi buzëqeshi. Ndjenjat e zemërimit në zemrën e saj u fashitën dhe ajo ndjeu qetësi dhe ngrohtësi. Ajo mund t’i falte gjermanët. Dhe Jezusi mund ta ndihmonte që edhe t’i donte ata. ■

Autorja jeton në Nju-Xhersi, SHBA.

Shenjtorët e ditëve të mëvonshme në Holandë u dhanë 70 tonë patate dhe 90 tonë harenjë shenjtorëve të ditëve të mëvonshme gjermanë. Më vonë, në vitin 1953, shenjtorët gjermanë u dërguan furnizime anëtarëve të Kishës në Holandë pas një përmbytjeje të madhe.

Klubi i Leximit

të Librit të Mormonit

BASHKOHU DHE TI DUKE E LEXUAR LIBRIN E MORMONIT!

Ti mund ta lexosh vetë, me familjen tënde ose me një mik. Pastaj na dërgo një fotografi tënden duke e lexuar Librin e Mormonit dhe na trego për diçka që ke lexuar ose historinë që parapëlqen nga Libri i Mormonit. Dërgoje te liahona.lds.org (klikoni te "Submit an Article" ["Dorëzoni një Artikull"]).



Shkrimi i shenjtë i këtij muaji: Moroni 10:4


“. . . Në qoftë se ju do të kërkonit me një zemër të singertë, me qëllim të vërtetë duke pasur besim në Krisht, ai do t'ju tregojë të vërtetën, nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë”.



Historia ime e parapëlqyer nga Libri i Mormonit gjendet te 3 Nefi 17 dhe flet për Jezusin që bekon fëmijët. Më pëlqen historia sepse na tregon se sa shumë

na do Jezusi dhe Ati Qjellor. Unë mund ta gjej veten tek ata fëmijë dhe e përfytyroj veten duke qëndruar atje.

Barbora J., moshë 11 vjeçe, Republika Çeke



Mua më pëlqen shumë Librin e Mormonit sepse është një libër i vërtetë. Ai është i shkruar nga profetët. Ai më ndihmon të zgjedh të drejtën, dhe kur kam probleme më ndihmon. Unë e besoj atë.

Xhejzon S., moshë 10 vjeçe, Maharashtra, Indi


Esteri ishte Guximtare

Esteri ishte mbretëresha e Persisë. Mbreti nuk e dinte se Esteri ishte judease. Mbreti kishte një mik të lig që i urrente judenjtë. Ai e mashtroi mbretin duke i thënë se të gjithë judenjtë në tokë duhet të vriteshin. Esteri vendosi t'i kërkonte mbretit që ta shpëtonte popullin e saj. Por ajo mund të vritej për arsye se shkoi në fronin e mbretit. Esteri i kërkoj judenjve të agjëronin për të. Kur Esteri shkoi në fronin e bashkëshortit të saj, ai e mirëpriti atë. Ajo e ftoi atë dhe mikun e tij për një darkë. Atje, ajo u tha atyre se ishte judease. Mbreti nuk mund ta ndryshonte ligjin, por ai i lejoj judenjtë ta mbronin veten e tyre. Me ndihmën e Perëndisë, Esteri e shpëtoi popullin e saj!



"Mbretëresha Ester", Rebeka C., moshë 8 vjeçe, Aragua, Venezuelë

Lexoni rreth Esterit tek Esteri 2–8.



ESTERI

**Esteri ishte trimëreshë dhe besonte në Perëndi.
Unë mund të jem e guximshme dhe të luftoj për
atë që është e drejtë!**

- Mësoje përmendsh pjesën e fundit të Esterit 4:14.
- Shikoje kapitullin 45 në historitë e Dhiatës së Vjetër te scripturestories.lds.org.
- Nëse prindërit tuaj thonë që je i rritur mjaftueshëm, agjëro për dikë që e ke përzemër.
- Unë mund të jem guximtar/e duke ...

Mbretëresha Ester

Nga Kim Ueb Ridi



Esteri ishte një mbretëreshë. Ajo ishte martuar me mbretin e Persisë.




Mbreti kishte një mik, i cili ishte një burrë i keq. Ai e mashtroi mbretin për të bërë një ligj që të gjithë judenjtë duhet të vriteshin! Mbreti nuk e dinte që gruaja e tij, Esteri, ishte judease.

Esteri vendosi t'i kërkonte bashkëshortit të saj, mbretit, që ta shpëtonte popullin e saj. Por ajo ishte e shqetësuar se ai mund të zemërohej. Esteri u kërkoi të gjithë judenjve të agjëronin dhe të luteshin për të. Pastaj Esteri shkoi te mbreti. Ai nuk u zemërua!




Esteri e ftoi mbretin dhe mikun e tij për një darkë. Te darka, Esteri i tha mbretit se *ajo* ishte judease. Mbreti ishte i zemëruar që mikun e tij e kishte mashtruar. Ai do t'u thoshte judenjve që ata të mund ta mbronin veten. Esteri e ndihmoi popullin e saj që të shpëtonte!



Ne mund të lutemi që t'i kërkojmë Atit Qiellor ndihmë.
Ne mund të jemi trima dhe guximtarë, si Esteri. ■

Nga Esteri 2-8.

Unë Mund t'i Ndhimoj të Tjerët të Ndiejnë se Njerëz të Tjerë i Duan





**Nga Presidenti
Xhejms E. Faust
(1920–2007),**

Këshilltar i Dytë në
Presidencën e Parë

PËRKRAHJA JONË MBËSHTETËSE

*Udhëheqja shpirtërore [në përmasë të gjerë]
varet [nga] të qenit në harmoni me . . .
profetët, shikuesit dhe zbuluesit.*

Dëshiroj të flas mbi detyrat e shenjta të atyre udhëheqësve të priftërisë që janë “thirrur e zgjedhur” (DeB 55:1) për të udhëhequr Kishën në këtë kohë. . . .

. . . Vëllezërit e mi [në Kuorumin e Dymbëdhjetë Apostujve], janë pa përjashtim burra të mirë, të ndershëm dhe të besueshëm. E njoh zemrën e tyre. Ata janë shërbëtorët e Zotit. Dëshira e tyre e vetme është të punojnë në thirrjet e tyre të rëndësishme dhe të ngrenë mbretërinë e Perëndisë në tokë. Vëllezërit tanë që po shërbejnë në këtë kohë janë të vërtetuar, të provuar dhe të vërtetë. . . . Zemra e tyre është aq e pastër, përvoja e tyre aq e madhe, mendja e tyre aq e mprehtë dhe urtësia e tyre shpirtërore aq e thellë saqë ndien ngrohtësi thjesht duke qëndruar pranë tyre.

. . . [Kur u thirra, më këshilluan] se gjëja më e rëndësishme që duhej të bëja ishte të isha gjithmonë në harmoni me Vëllezërit e mi. . . . [Kjo gjë



më kumboi në vesh] si diçka që doja ta bëja me gjithë zemrën time.

. . . Kam arritur në përfundimin se udhëheqja shpirtërore [në përmasë të gjerë] varet [nga] të qenit në harmoni me Presidentin e Kishës, Presidencën e Parë dhe Kuorumin e Të Dymbëdhjetëve – të cilët [të gjithë mbështeten] . . . si profetë, shikues dhe zbulues. Nuk e di se si mund të presim që të jemi në harmoni të plotë me Shpirtin e Zotit, në qoftë se nuk jemi në harmoni me Presidentin e Kishës dhe profetët, shikuesit dhe zbuluesit e tjerë. . . .

Këshilla ime për anëtarët e Kishës është [që] ta mbështetim Presidentin e

Kishës, Presidencën e Parë, Kuorumin e Të Dymbëdhjetëve dhe Autoritetet e tjera të Përgjithshme me gjithë mendjen dhe shpirtin tonë. Nëse do të veprojmë kështu do të jemi të sigurt. . . .

Nevojitet gjithashtu t[’i] mbështetim dhe t[’i] përkrahim udhëheqësit tanë [vendorë], pasi edhe ata janë [të] “thirrur dhe [të] zgjedhur”. Çdo anëtar i kësaj Kise mund të këshillohet nga një peshkop apo president dege, nga një president kunji ose misioni dhe nga Presidenti i Kishës dhe shokët e tij. Asnjëri prej këtyre vëllezërve nuk e kërkoi thirrjen e tij. Asnjëri nuk është i përsosur. E megjithatë, ata janë shërbëtorët e Zotit, të thirrur prej Tij nëpërmjet atyre që kanë të drejtën e frymëzimit. Ata që janë thirrur, mbështetur dhe veçuar kanë të drejtën e përkrahjes sonë mbështetëse. ■

Nga një bisedë në konferencën e përgjithshme të tetorit 2005.



EDMUND BLAIR LEIGHTON (1852-1922). I VERBRI NË PELLGUN E SILOAMIT, 1879. PIKTURË NË TELLAQ, 40 X 50 1/4 INÇ. MUZEU I ARTIT NË UNIVERSITETIN "BRIGAM JANG", BLERË ME FONDET E SIGURUARË NGA JACK R. WHEATLEY, 2014.

**I VERBRI NË PELLGUN
E SILOAMIT, NGA
EDMUND BLAIR
LEIGHTON**

"Ai u përgjigj dhe tha: 'Një njeri, që quhet Jezus, ka bërë baltë, ka bërë baltë, m'i leu sytë dhe më tha: "Shko te pellgu i Siloamit dhe lahu"'. Dhe unë shkova atje, u lava dhe m'u kthye drita e syve' . . ."

Po të mos ishte ky nga Perëndia, nuk do të bënte asgjë" (Gjoni 9:11, 33).

TË RINJTË NË MOSHË MADHORE

**SHQYRTOJENI PYETJEN
TUAJ "PËRSE"**

*Cila është shtysa juaj
për ta jetuar ungjillin?*

44



TË RINJTË
**SI MUND T'JU
MËSOJË FRYMA
E SHENJTË**

50, 56

**PUNONI TANI
PËR TË ARDHMEN
QË DËSHIRONI**

62

KONFERENCA E
PËRGJITHSHME
**PESË MËNYRA
PËR TË MËSUAR NGA
KONFERENCA**

50, 54,
58

KISHA E
JEZU KRISHTIT
E SHENJTORËVE TË
DITËVE TË MËVONSHME



4

02147 54101 7

7